Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të neneve 5, 44 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 13 e 17, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Rehabilitimi i Amfiteatrit të Durrësit", faza 2, miratuar me vendimin nr. 112/2014, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "truall" dhe "ndërtim", me një vlerë të përgjithshme prej 25 379 999 (njëzet e pesë milionë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 25 379 999 (njëzet e pesë milionë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet, përkatësisht:

a) nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015, në shumën 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë.

b) nga fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2015, të Ministrisë së Kulturës, në shumën 11 379 999 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

5. Shpronësimi të fillojë në datën 27.5.2015.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Kulturës.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Sipas kartelës së pasurisë", do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

9. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministra e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK , TË CILAT PREKEN NGA "PROJEKTI PËR REHABILITIMIN E HAPËSIRËS SË AMFITEATRIT TË DURRËSIT "

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe (m^2)		Çmimi Leke/m^2		Vlera Leke		SHËNIME
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truallit	Banesë	
1	Skënder MYSHKETA	8512	24/619	56.133	51.03	17,898	70,093	1,004,674	3,576,845.79	sipas kartelës së pasurisë
2	Naxhie BYLYKBASHI	8512	24/619	56.133	51.03	17,898	70,093	1,004,674	3,576,845.79	sipas kartelës së pasurisë
3	Lutfie QOSJA	8512	24/619	56.133	51.03	17,898	70,093	1,004,674	3,576,845.79	sipas kartelës së pasurisë
4	Myrteza ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	sipas kartelës së pasurisë
5	Zyra BLLACA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	sipas kartelës së pasurisë
6	Besnik ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	sipas kartelës së pasurisë
7	Shekibe ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	sipas kartelës së pasurisë
8	Fatmir ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	sipas kartelës së pasurisë
9	Shpresa BASHA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	sipas kartelës së pasurisë
10	Abdulla ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	sipas kartelës së pasurisë
				336.40	**319.1**			**3,014,023**	**22,365,975**	**25,379,999**
	TOTALI : 25,379,999 Lekë									

VENDIM
Nr. 459, datë 27.5.2015

PËR MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR HARTIMIN E POLITIKËS DHE MASAVE PËR NJË MJEDIS MUNDËSUES PËR SHOQËRINË CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit, ministrit të Integrimit Evropian dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e udhërrëfyesit për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kryeministria është përgjegjëse për bashkëveprimin dhe monitorimin për zbatimin e udhërrëfyesit.
3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në shtojcën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËRRËFYESI
PËR HARTIMIN E POLITIKËS DHE MASAVE PËR NJË MJEDIS MUNDËSUES PËR SHOQËRINË CIVILE

HYRJE

Shoqëria civile aktive dhe aktive është komponent kyç i demokracisë pluraliste. Bashkëpunimi dhe partneriteti ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile në formësimin dhe zbatimin e politikave publike janë veçori thelbësore të një shteti modern që është në shërbim të qytetarit. Forcimi i dialogut me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHQ) në procesin e hartimit të politikave publike sjell një sërë dobish. I mundëson qeverisë të përftojë burime informacioni dhe ekspertizë të gjerë, gjë që përmirëson cilësinë e politikave të reja dhe ofrimin e shërbimeve publike, por edhe kontribuon në monitorimin dhe vlerësimin eficient të politikave ekzistuese, si edhe në përcaktimin e ndryshimeve të nevojshme.

Qeveria e ka bërë të qartë angazhimin e saj për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm që inkurajon pavarësinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile, duke kontribuar në tejkalimin e hendekut mes qytetarëve dhe institucioneve. Për këtë qëllim, programi i qeverisë 2013-2017 thekson nevojën e reformave në lidhje me: i) përmirësimin e kuadrit ligjor dhe fiskal për veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse (OJF) që do të siguronte më shumë mbështetje për sektorin përmes filantropisë korporative dhe individuale dhe përfshirjes së vullnetarëve; ii) rritjen e transparencës së punës së institucioneve publike nëpërmjet publikimit të mundësive për bashkëpunim, si edhe

të rregullave dhe procedurave për aplikim për financim publik të projekteve të organizatave jofitimprurëse; iii) konsultimin e gjerë të nismave të reja ligjore me shoqërinë civile, në mënyrë që të merret *feedback*-u dhe vlerësimi i OSHC-ve; dhe iv) forcimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për të ofruar shërbime të cilat shteti nuk është ende në gjendje t'i ofrojë.

Këto angazhime të qeverisë janë në përputhje me udhëzimet për mbështetjen nga Bashkimi Evropian i shoqërisë civile në vendet e zgjerimit për periudhën 2014-202, të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit e Komisionit Evropian me qëllimin për të garantuar një kuadër solid për matjen e procesit në zhvillimin e një demokracie dinamike, stimuluese dhe pjesëmarrëse në vendet që synojnë aderimin në BE. Udhëzimet fokusohen në një numër objektivash, rezultatesh dhe indikatorësh që vlerësojnë performancën e vendeve në krijimin e një mjedisi të favorshëm për veprimtarinë e shoqërisë civile dhe në konsolidimin e kapaciteteve të OSHC-ve për të qenë aktorë të pavarur efektivë dhe llogaridhënës.

Aktualisht, për vitin 2014, nga të dhënat zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, numri i organizatave jofitimprurëse aktive rezulton 2427, ndërsa të punësuarit në sektorin e OJF-ve rezulton të jetë 7505. Shumica e OSHC-ve janë të përqendruara në Shqipërinë qendrore, sidomos në Tiranë. Organizatat e tjera janë të përhapura kryesisht në Veri (Shkodër) dhe në Jug (Korçë, Fier dhe Vlorë). Sektori i shoqërisë civile në zonat e largëta dhe sidomos në zonat rurale vazhdon të jetë shumë i dobët. Edhe numri i grupeve informale aktive me bazë komunitare është relativisht i ulët.

Progres-raporti 2014 i Komisioni Evropian shprehet se sektori i shoqërisë civile në Shqipëri mbetet i copëzuar dhe tejet i varur nga financimet e donatorëve. Komisioni konstatoi përmirësimet në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile. Është e vërtetë që shoqëria civile është konsultuar rregullisht mbi nismat e politikave dhe ato ligjore, por konsultimet me OSHC-të duhet të bëhen më sistematike dhe transparente, përfshi këtu edhe reflektimin e rekomandimeve që ato japin. Gjithashtu, komisionet parlamentare kanë qenë proaktive në mbajtjen e konsultimeve me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, por vazhdon problematika e njoftimeve në momentin e fundit dhe mungesa e rregullave të qarta mbi konsultimet publike. Po kështu, bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore mbetet shumë i dobët, për shkak se mungojnë kapacitetet adekuate që garantojnë bashkëpunimin dhe financimin e duhur për OSHC-të.

Vlerësimi i Reformës në Administratën Publike të kryer nga SIGNMA në 2014-ën thekson se qeveria ka ndërmarrë ndryshime për të eliminuar mangësitë në procesin e planifikimit dhe të monitorimit, si edhe ka forcuar angazhimin me shoqërinë civile. Në përgjithësi, SIGMA vlerëson përfshirjen e ministrave dhe të nëpunësve civilë të rangut të lartë në nismat konsultuese, por njeh nevojën për bazë ligjore më të qartë dhe më të saktë për procedurat e konsultimit.

Raporti 2014 për Shqipërinë "Matrica monitoruese mbi mjedisin mundësues për zhvillim të shoqërisë civile" thekson se legjislacioni fiskal mbetet sfida kryesore për OSHC-të, pasi krijon barriera administrative të panevojshme ndaj veprimtarisë së OSHC-ve dhe pengon rolin e tyre në ofrimin e shërbimeve sociale. I njëjti raport sjell vëmendjen në mungesën e një dokumenti strategjik kombëtar kushtuar zhvillimit të shoqërisë civile, mungesën e strukturave institucionale adekuate dhe të mekanizmave lehtësues për marrëdhëniet shtet-OSHC; në veçanti, thekson mungesën e rregullave dhe të procedurave të qarta (dhe të kapaciteteve brenda organeve shtetërore) për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm.

Gjatë vitit të fundit, Kryeministria ka punuar me OSHC-të për të kuptuar nevojat kyçe dhe trendet e fundit në mbështetjen e zhvillimit të shoqërisë civile, veprimtaritë e mundshme që mund të zhvillohen në vitet në vijim, si edhe barrierat që duhen kapërcyer për të mundësuar zbatimin me sukses dhe kosto-efektiv të reformave kryesore.

Nevojitet një përqasje më e strukturuar për të krijuar një mjedis favorizues për zhvillimin e shoqërisë civile, sepse vetëm kështu sigurohet progres i qëndrueshëm në zbatimin e angazhimeve të qeverisë dhe adresohen thirrjet e shoqërisë civile për reforma më thelbësore, si edhe përmbushen kërkesat e aderimit në BE.

Ky udhërrëfyes paraqet një program me fusha prioritare veprimi ku qeveria po merr masa për të përmirësuar mjedisin e bashkëpunimit me shoqërinë civile. Dokumenti identifikon fusha të

mundshme të tjera ku mund të ketë nevojë për asistencë teknike në të ardhmen. Pritet që ky dokument të kontribuojë në zhbllokimin e potencialit që mbruhet nga përmirësimi i bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile, si një parakusht për zbatim të qëndrueshëm dhe të pakthyeshëm të reformave të ndërmarra në kuadrin e procesit të anëtarësimit në BE.

FUSHAT PRIORITARE TË VEPRIMIT

Udhërrëfyesi fokusohet në nëntë fusha prioritare të identifikuara përmes takimeve të hapura konsultative me OSHC-të dhe diskutimeve mes përfaqësuesve të qeverisë dhe donatorëve gjatë muajit korrik 2014, si edhe bazuar në analizën e raporteve, studimeve dhe vlerësimeve të sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri. Më konkretisht, nëntë fushat prioritare mishërojnë parimet dhe objektivat e përcaktuara në udhëzimet mbi mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile 2014-2020, të cilat janë konceptuar si kuadër për vendet aspirante si një rajon më vete dhe shtrojnë themelet për një përqasje në nivel kombëtar sipas kontekstit të vendit. Këto udhëzime mundësojnë matjen e procesit të secilit vend, si edhe të rajonit të vendeve aspirante.

Fushat prioritare:

1. Mjedisi kombëtar i politikave strategjike për zhvillimin e shoqërisë civile
2. Institucionet që mbështetin bashkëpunimin qeveri-OSHC
3. Përfshirja e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes
4. Kuadri i financimit publik për programet e OSHC-ve
5. Kuadri legjislativ për regjistrimin dhe punën e OSHC-ve
6. Raportimi/kontabiliteti financiar dhe trajtimi tatimor i OSHC-ve
7. Mbledhja e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile
8. Zhvillimi i vullnetarizmit
9. Kontributi i OSHC-ve në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë.

Për çdo fushë prioritare, prezantohet analiza bazë dhe argumentimi, bashkë me një grup masash të propozuara për reformën. Masat janë numërtuar për ta bërë më të lehtë monitorimin dhe rishikimin e tyre. Përveç kësaj, janë identifikuar disa fusha të mundshme për asistencë teknike në të ardhmen, me fokus ngritjen e kapaciteteve të organeve të pushtetit për të zbatuar reforma të vështira që mundësojnë një mjedis më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile.

1. MJEDISI KOMBËTAR I POLITIKAVE STRATEGJIKE PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Për krijimin e një mjedisi më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile, qeveria duhet të marrë masa konkrete në fusha me ndërlidhje dhe komplimentaritet mes tyre (kuadri ligjor dhe institucional për punën e OSHC-ve, financimi publik për programet e OSHC-ve, standardet e ofrimit të shërbimeve sociale, konsultimet mes OSHC-ve në hartimin e ligjeve të reja, vullnetarizmi, filantropi, politika tatimore për OSHC-të etj). Projektstrategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim konsideron shoqërinë civile si sektor që kërkon formulimin e objektivave të qartë dhe marrjen e aksioneve nga qeveria deri në 2020-ën. Edhe pse janë bërë përmirësime të vyera vitet e fundit, qeveria duhet të tregojë koherencë më të madhe në adresimin e sfidave të shumta në fushën komplekse të zhvillimit të shoqërisë civile si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë vendor.

Për të siguruar angazhim afatgjatë dhe përqasje sistematike të qeverisë në zbatimin e reformave të nevojshme, si dhe krijimin e platformës për konsensus me OSHC-të dhe aktorët e tjerë për të gjitha masat e nevojshme, Këshilli i Ministrave duhet të konsiderojë mundësinë e miratimit të një strategjie për krijimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri, si edhe të planit të veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, me indikatorë specifikë dhe të matshëm, shoqëruar me vlerësim preciz të efekteve financiare të të gjitha veprimtarive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e koordinimit të politikave në këtë fushë shumë komplekse, ku përfshihen aktivitetet e një sërë ministrish dhe agjencish shtetërore. Strategjia dhe plani i veprimit duhet të hartohen në bashkëpunim të ngushtë me OSHC-të, përmes një procesi pjesëmarrës dhe përfshirës. Ky dokument do të jetë bazë solide për programimin e buxhetit të shtetit dhe fondeve të BE-së për sektorin e shoqërisë civile, si edhe mund të forcojë zotërimin vendor të reformave në këtë fushë të rëndësishme.

Aksione të propozuara:

1.1 Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për krijimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e

shoqërisë civile në Shqipëri deri në 2020-ën, si edhe i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë, me indikatorë të matshëm, me vlerësim konkret efektesh financiare dhe me procedurë të qartë raportimi, monitorimi dhe vlerësimi për të gjitha masat;

1.2 Mundësimi i pjesëmarrjes së OSHC-ve në të gjitha fazat e përgatitjes së strategjisë dhe planit të veprimit, si edhe zhvillimi i një procesi konsultimi gjithëpërfshirës dhe të plotë me palët e interesuara për draftin e Strategjisë Kombëtare dhe planit të veprimit;

1.3 Përgatitja e raportit mbi rezultatet e konsultimeve publike për draftin e Strategjisë/planit kombëtar dhe qarkullimi i gjerë i tij, para dërgimit të draftit për procedurë miratimi;

1.4 Ngritja, pas miratimit të Strategjisë dhe të planit të veprimit, e një sistemi të hapur dhe transparent për gjurmimin e progresit të bërë në zbatimin e të gjitha masave përmes një portali *web*, ku hidhet i gjithë informacioni i përditësuar mbi zbatimin e Strategjisë dhe të planit të veprimit;

1.5 Kryerja e vlerësimit të jashtëm të zbatimit të planit të veprimit.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Asistimi i qeverisë në realizimin e procesit të hapur dhe pjesëmarrës të hartimit të Strategjisë Kombëtare dhe planit të veprimit, përfshi organizimin e diskutimeve rajonale dhe lehtësimin e *workshop*-eve tematike për të gjitha nënfushat e Strategjisë Kombëtare, si edhe përgatitjen e raportit mbi rezultatet e konsultimeve publike;

- Mbështetja e organizimit të seminareve trajnuese për organet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e masave të planit të veprimit;

- Asistimi i qeverisë në ngritjen e një sistemi solid raportimi, monitorimi dhe vlerësimi në lidhje me zbatimin e planit të veprimit, përfshi ngritjen e një portali *web* dhe instrumenteve të tjera për informimin dhe komunikimin;

- Zhvillimi i fushatave sensibilizuese ndër qytetarët dhe OSHC-të mbi objektivat dhe masat e prioriteteve të strategjisë.

Institucionet përgjegjëse: KM, MIE, AMSHC

2. Institucionet që mbështetin bashkëpunimin qeveri-OSHC

Krijimi i mjedisit favorizues për bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile nënkupton ngritjen e mekanizmave dhe strukturave institucionale cilësore, si edhe konsolidimin e kapaciteteve për realizimin efektiv të detyrave kyçe, konkretisht:

- Dialog i strukturuar ndër organet shtetërore relevante dhe përfaqësuesve të OSHC-ve mbi të gjitha politikat që prekin shoqërinë civile;

- Financim publik të qëndrueshëm për programet e OSHC-ve dhe përgatitjen e partneriteteve strategjike me OSHC-të që synojnë dhënien e shërbimeve sociale me interes të përgjithshëm;

- Koordinim qendror solid i zhvillimit dhe zbatimit të politikave të qeverisë për shoqërinë civile, përfshi mbështetjen për programin strategjik eficient të mbështetjes shtetërore për OSHC-të;

- Mbështetja e përfshirjes së qenësishme / kuptimplote të OSHC-ve në procesin e politikëbërjes në të gjithë sektorët.

Për të realizuar detyrat dhe konsolidimin e përpjekjeve të mëparshme në këtë fushë, nevojitet rishikim dhe përmirësim i arkitekturës institucionale që mbështet shoqërinë civile, e cila mund të mbështetet në këta mekanizma institucionalë:

- Këshilli Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile;

- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC);

- Njësia e Koordinimit të Politikave të Shoqërisë Civile në Kryeministri;

- Njësitë/personat e kontaktit për bashkëpunimin me OSHC-të në ministritë/organet publike përkatëse.

Më poshtë përshkruhet secili mekanizëm institucional me informacion bazë mbi potencialin, vizionin, misionin dhe objektivat, lidhjet institucionale me strukturat e tjera të propozuara, si edhe masat kyçe që duhet të çojnë në përmbushjen e objektivave, shoqëruar me fushat e mundshme për asistencë teknike në të ardhmen.

Këshilli Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Krijimi i besimit dhe mirëkuptimit reciprok midis qeverisë dhe OSHC-ve kërkon krijimin e mundësive të rregullta për dialog dhe shkëmbim pikëpamjesh mbi sfidat kryesore me të cilat përballen të dy palët, në përpjekjet e tyre për përmirësimin e mjedisit për zhvillimin e shoqërisë civile. Megjithëse ekzistojnë disa organe këshillimtare sektoriale, nga takimet e hapura konsultuese me OSHC-të rezultoi nevoja për ngritjen e një organi këshillimor shtetëror ndërsektorial, që do të mundësonte ndërveprim të

vazhdueshëm mes aktorëve kyç mbi të gjitha çështjet e politikës së zhvillimit të shoqërisë civile. Bazuar nga takimet e zhvilluara, draftligji është duke u përgatitur për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Vizioni i Këshillit Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile është që të bëhet një forum kombëtar i njohur gjerësisht për adresimin e çështjeve strategjike kyçe, duke i paraprirë trendeve dhe duke përcaktuar agjendën e ardhshme për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Këshillit Kombëtar është të mundësojë dialog të rregullt dhe të strukturuar kuptimplotë të organeve shtetërore me përfaqësuesit e OSHC-ve mbi çështjet kyçe të zhvillimit të shoqërisë civile në Shqipëri.

Objektivat kryesorë të Këshillit duhet të fokusohen në këto drejtime:

-T'i japë këshilla strategjikë Këshillit të Ministrave mbi hartimin e politikave shtetërore që synojnë arritjen e mjedisit mundësues për shoqërinë civile;

-Të garantojë pjesëmarrje në planifikimin e modeleve të mbështetjes shtetërore për shoqërinë civile;

-Të rekomandojë përmirësime në kuadrin legjislativ për punën e OSHC-ve;

-Të zbatojë në praktikë parimin e partneritetit gjatë programimit të asistencës së para-anëtarësimit të BE-së për sektorin e shoqërisë civile;

-Të garantojë monitorim të pavarur dhe objektiv të të gjithë financimit publik që jepet për programet e OSHC-ve, bazuar në raportet e përgatitura nga ministritë, organet publike dhe agjenci, përfshi AMSHC-në;

-Të gjurmojë progresin e bërë në zbatimin e standardeve të konsultimeve publike me OSHC-të, në lidhje me hartimin e legjislacionit të ri.

Aksione të propozuara:

2.1 Miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për ngritjen e Këshillit Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, si organ këshillimor ndërsektorial i qeverisë, ku marrin pjesë përfaqësues të ministrive dhe agjencive shtetërore përgjegjëse për fushat kryesore që prekin OSHC-të, si edhe përfaqësues të OSHC-ve të përzgjedhur mbi bazën e kritereve dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim;

2.2 Organizimi i procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të OSHC-ve në Këshill, pas një ftese publike dhe duke respektuar parimet e transparencës dhe gjithëpërfshirjes;

2.3 Sigurimi i mbështetjes efikase administrative dhe profesionale për Këshillin (duke përfshirë përgatitjen e materialeve për të gjitha sesionet dhe duke siguruar ndjekjen e të gjitha konkluzioneve të Këshillit), duke caktuar numër të mjaftueshëm të personelit kompetent nga institucioni përkatës që do të mandatohet për të vepruar si sekretariat për Këshillin.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Organizimi i workshopit mbi planifikimin strategjik, për anëtarët e rinj të Këshillit, që të krijohet platformë e përbashkët për punën e përbashkët në periudhën në vijim;

- Realizimi i një programi trajnues për anëtarët e Këshillit që të njihen me praktikat më të mira të organeve ndërsektoriale të ngjashme, si edhe me përqasjet metodologjike për monitorimin e politikave shtetërore që synojnë zhvillimin e shoqërisë civile;

- Zhvillimi i aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve të sekretariatit të Këshillit, veçanërisht në lidhje me përgatitjen efikase të materialeve për seancat e Këshillit, analiza solide dhe aftësi raportimi etj.;

- Nxitja e krijimit të organeve këshillimore ndërsektoriale të ngjashme, në nivel njësie të qeverisjes vendore, si shtysë e vyer në krijimin e besimit dhe sensibilizimin e mbi rolin e OSHC-ve në zhvillimin e komunitetit vendor.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) u ngrit në 2009, në zbatim të ligjit për organizimin dhe funksionimin e AMSHC-së. Vizioni i AMSHC-së mund të përmblidhet si vijon: qytetari aktive dhe shoqëri civile aktive në Shqipëri. Misioni i AMSHC-së, sipas ligjit, është nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimi i kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut. Për realizimin e misionit, AMSHC-ja ofron asistencë financiare për programet që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë, si dhe programe të tjera që lehtësojë përmbushjen e misionit të saj. Ligji përcakton se,

në ushtrimin e veprimtarisë së saj, AMSHC-ja udhëhiqet nga prioritetet strategjike të qeverisë për zhvillimin e shoqërisë civile.

Objektivat e AMSHC-së janë:

- nxitja e zhvillimit të vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në zhvillimin e komunitetit;
- promovimi dhe forcimi i kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së OJF-ve;
- zhvillimi i bashkëpunimit dhe partneritetit ndërsektorial ndërmjet OSHC-ve;
- rritja e vizibilitetit dhe ndikimit publik në OSHC-të;
- zhvillimi i sipërmarrjes sociale dhe punësimit në OJF-të;
- rritja e ndikimit të shoqërisë civile në politikëbërje dhe vendimmarrje;
- nxitja e bashkëpunimit me OJF-të që kanë rol në luftën kundër korrupsionit, trafikimit të qenieve njerëzore dhe trajtimit të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj fëmijëve.

Konsultimet e hapura me OSHC-të konfirmuan shpresën e madhe te Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) si mekanizëm qendror për financimin publik të programeve të OSHC-ve në Shqipëri, sidomos për ripërcaktimin e rolit dhe punës së saj që të jetë më proaktive dhe afër OSHC-ve në nivel vendor, programimin më transparent të prioriteteve të financimit, mbledhjen e të dhënave të besueshme mbi OSHC-të dhe mbështetjen e zhvillimit të balancuar të shoqërisë civile në të gjithë vendin. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përgatitjes së kritereve dhe procedurave të qarta për alokimin e granteve institucionale për OSHC-të, pasi ato janë shtysa kryesore për qëndrueshmërinë e OSHC-ve të udhëhequra drejt misionit.

Nevojitet forcim i mëtejshëm i kapaciteteve të stafit të Agjencisë, në mënyrë që të fitojë besimin e shoqërisë civile dhe të publikut të gjerë në integritetin dhe ndershmërinë e saj. Edhe pse AMSHC-ja aktualisht ka 13 punonjës, mbeten të ulëta kapacitetet e tyre për menaxhimin e procedurave komplekse të dhënies së granteve, për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të shpallura fituese, si edhe për dhënien e mbështetjes për OSHC-të. Vëmendja e duhur i duhet kushtuar edhe transparencës së procedurës së punësimit të stafit të Agjencisë, me qëllim që të forcohet imazhi institucional i saj. Gjithashtu, AMSHC-ja ka nevojë për asistsencë shtesë që të forcohet vizibiliteti dhe pesha e saj.

Për monitorim shtesë të efektivitetit të punës së AMSHC-së dhe sinkronizimin e prioriteteve për financim si me planet strategjike kombëtare, ashtu edhe me nevojat e OSHC-ve, AMSHC-ja duhet të marrë pjesë aktive në punën e Këshillit Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe të dorëzojë raportet vjetore të financimit publik të OSHC-ve pranë Këshillit Kombëtar për diskutim dhe vlerësim. Draftligji për Këshillin Kombëtar parashikon mundësinë e AMSHC-së për të luajtur rolin e sekretariatit të Këshillit, e cila do të saktësohet gjatë konsultimeve publike, duke marrë në konsideratë misionin dhe kapacitetet e AMSHC-së.

Aksione të propozuara:

2.4 Përgatitja e një strategjie afatgjatë të AMSHC-së për arritjen e objektivave kryesorë të parashikuar në statutin e saj;

2.5 Hartimi i planit të komunikimit, informimit dhe angazhimit që t'i përgjigjet kërkesave në rritje për informim dhe mbështetje nga OSHC-të vendore;

2.6 Organizimi i asistencës teknike të BE-së për AMSHC-në që të ndërtojë kapacitetet për menaxhimin e fondeve të BE-së për shoqërinë civile në të ardhmen.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Përgatitja e manualit dhe zhvillimi i programit trajnues për stafin e AMSHC-së mbi procedurat transparente dhe efektive të dhënies së granteve, në përputhje me standardet e BE-së (sidomos në kontekstin e decentralizimit të menaxhimit të fondeve të BE-së për sektorin e shoqërisë civile në të ardhmen);
- Organizimi i *workshop*-eve trajnuese për AMSHC-në mbi konsultimet efektive me OSHC-të në programimin e prioriteteve për financim për periudhën buxhetore në vazhdim;
- Asistemi i AMSCH-së në diversifikimin e modeleve të mbështetjes së OSHC-ve (përfshi ngritjen e fundit për bashkëfinancimin e projekteve të BE-së dhe përgatitjen e sistemit për alokimin e granteve institucionale OSHC-ve;
- Rikonceptimi i faqes së internetit të AMSHC-së dhe përgatitja e strategjisë së re të komunikimit që do të përmirësonte vizibilitetin e punës së AMSHC-së;

- Ngritjen e një databaze publike të OSHC-ve që ndihmon në zbatimin e strategjisë së komunikimit të AMSHC-së, por edhe rrit vizibilitetin e projekteve të financuara nga buxheti i shtetit;

- Organizimi i *workshop*-eve rajonale për ftesat për propozime të AMSHC-së, me qëllim që të informohen aplikantët potencialë mbi kërkesat e skemës së grantit;

- Implementimi i aktiviteteve për forcim kapacitetesh për OSHC-të lokale, veçanërisht nga pikëpamja e decentralizimit të shërbimeve sociale, në linjë me planet e administratës dhe reformës territoriale.

Njësia e Koordinimit të Politikave të Shoqërisë Civile në Kryeministri

Politikat e shoqërisë civile prekin një sërë fushash nën kompetencën e një sërë ministrish, organesh shtetërore dhe agjencish. Arritja e progresit drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile kërkon koordinim solid vertikal dhe horizontal të politikave. Kjo mund të arrihet duke ngritur një njësi për koordinimin e politikave të shoqërisë civile pranë Departamentit të Zhvillimit të Programimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj.

Vizioni i njësisë është partneriteti i fortë ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave publike.

Misioni i njësisë është t'ua lehtësojë OSHC-ve punën me shtetin dhe krijimi i mjedisit ligjor, financiar dhe institucional mundësues për OSHC-të, me qëllim që të rritet impakti i tyre në shoqëri.

Për këtë qëllim, njësia duhet të kryejë shërbime eksperte, analitike dhe administrative për forcimin e bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile, si dhe në veçanti duhet të kryejë këto detyra:

- Koordinimin, formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve strategjike që prekin mjedisin për zhvillimin e shoqërisë civile;

- Propozimin e përmirësimeve në kuadrin legjislativ për punën e OSHC-ve;

- Harmonizimin e kritereve, standardeve dhe prioriteteve për financimin e projekteve dhe programeve të OSHC-ve nga organet shtetërore dhe institucione publike të tjera;

- Koordinimin e punës së organeve të administratës publike në konsultimin dhe përfshirjen e OSHC-ve në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit të ri dhe politikave publike me interes të përgjithshëm;

-Koordinimin e zhvillimit të programeve trajnuese për nëpunësit civilë mbi bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile;

-Koordinimin e programimit të projekteve dhe programeve të paraanëtarësimit në BE dhe i fondeve strukturore në mbështetje të zhvillimit të shoqërisë civile;

-Garantimin e mbështetjes administrative dhe eksperte për Këshillin Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe organeve të tjera këshillimore sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;

-Në kontekstin e decentralizimit të fondeve të BE-së për shoqërinë civile në Shqipëri në të ardhmen e afërt, duhet të mbahet parasysh nevoja për ndarjen institucionale të përgjegjësive në lidhje me programimin (Njësia për shoqërinë civile në Kryeministri), kontraktimin dhe financimin (Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile).

Aksione të propozuara:

2.7 Ndryshimi i rregullores për strukturën organizative të Kryeministrisë për të mundësuar ngritjen e një njësie për koordinimin e politikave të shoqërisë civile brenda Departamentit të Zhvillimit të Programimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj;

2.8 Sigurimi i burimeve financiare dhe njerëzore të mjaftueshme për punën efektive të njësisë.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Mbështetje për hartimin e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave mbi financimet publike të OSHC-ve, analizën, interpretimin dhe paraqitjen e tyre për qëllime të raportimit cilësor pranë qeverisë dhe për të përmirësuar programimin e prioriteteve për investime me fonde të brendshme publike apo të BE-së/ndërkombëtare;

- Asistim në zhvillimin dhe menaxhimin e një databaze publike me të gjitha grantet e dhëna për projektet dhe programet e OSHC-ve nga fondet publike, përfshi financimet e BE-së;

- Mbështetje në zbatimin e programeve trajnuese për nëpunësit civilë mbi zhvillimin e bashkëpunimit me OSHC-të në formësimin e politikave publike.

Njësitë/personat e kontaktit për bashkëpunimin me OSHC-të në ministritë dhe organet e tjera shtetërore dhe institucionet publike

Ngritja e Agjencisë, Këshilli Kombëtar apo

Njësitë për bashkëpunimin me OSHC-të nuk duhet të zëvendësojë dialogun e rregullt dhe të hapur të të gjitha organeve publike me OSHC-të dhe qytetarët në kryerjen e detyrave të përditshme në përmbushje të qëllimeve strategjike brenda fushave të tyre të veprimit. Veçanërisht, kjo nuk duhet të konsiderohet si justifikim për mungesën e komunikimit të mirëfilltë mes ministrive/agjencive shtetërore dhe shoqërisë civile. Përfshirja e OSHC-ve në procesin e vendimmarrjes në të gjithë sektorët është mjet i shkëlqyer për transformim gradual të stileve të qeverisjes dhe përqasjet e menaxhimit të politikave publike.

Prandaj, është e rëndësishme që çdo organ publik të emërojë një person kontakti apo edhe të krijojë njësi të posaçme për bashkëpunimin me OSHC-të, me fushë të gjerë veprimi për komunikimin dhe bashkëpunimin në zbatimin e politikave specifike apo në ofrimin e shërbimeve sociale. Hap mjaft pozitiv në këtë drejtim ka qenë krijimi i Sektorit të Shoqërisë Civile dhe Strategjisë pranë Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve dhe Sekretariatit Evropian në Ministrinë e Integrimit Evropian.

Procesi i emërimit të koordinatorëve për konsultime publike në çdo organ publik është parashikuar nga projektligji për njoftimin dhe konsultimin publik. Kjo shërben si shtysë për të planifikuar masa më sistematike të forcimit të bashkëpunimit mes të gjitha institucioneve publike dhe aktorëve të shoqërisë civile të organizuar.

Aksione të propozuara:

2.9 Emërimi i personave të kontaktit dhe, sipas nevojës, ngritja e njësive të posaçme për bashkëpunimin me OSHC-të në ministri dhe organe shtetërore të tjera;

2.10 Publikimi i listës së personave të kontaktit me hollësi relevante, në faqet e internetit të të gjitha ministrive/organeve publike;

2.11 Organizimi i takimeve periodike koordinuese me personat e kontaktit (detyrë e mundshme e njësisë për shoqërinë civile në Kryeministri).

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Organizimi i programeve trajnuese për të gjitha pikat e kontaktit mbi bashkëpunimin me OSHC-të dhe/ose punonjësit e njësive të bashkëpunimit me OSHC-të.

Institucionet përgjegjëse: KM, MIE, MF, AMSHC

3. PËRFSHIRJA OSHC-ve NË PROCESIN E POLITIKËBËRJES

Është fakt se komunikimi i qenësishëm dhe efektiv me publikun e interesuar është thelbësor për procesin e rritjes së nivelit të besimit të publikut, si edhe i mundëson qeverisë të përmirësojë llogaridhënien e organeve publike. Megjithatë, në praktikën e përditshme, organet shtetërore të të gjitha niveleve shpesh përballen me sfida në përgatitjen dhe mbajtjen e konsultimeve mbi politikat, sidomos në dhënien e *feedback*-ut të duhur pjesëmarrësve në lidhje me rezultatet e konsultimeve publike.

Shpesh iu është kujtuar OSHC-ve rëndësia e procedurave të qarta dhe rregullave detyruese për përfshirjen e publikut të interesuar në procesin e vendimmarrjes, por edhe nevoja për ndërtimin e kapaciteteve të nëpunësve civilë për përfshirje efektive të aktorëve joshtetërorë në përgatitjen e politikave publike të reja.

Siç konstaton raporti i SIGMA 2014, detyrimi për t'u konsultuar me shoqërinë civile është parashikuar në legjislacion, por ende mungojnë procedurat formale precize. Rregullat e procedurës përcaktojnë se konsultimet duhet të jenë pjesë integrale e procesit të përgatitjes së politikave. Manuali për hartimin e legjislacionit u jep ministrive orientimet në lidhje me zhvillimin e konsultimeve. Megjithatë, përqasja aktuale ndaj konsultimeve nuk ndjek gjithmonë disa parametra të paracaktuar cilësie. Për të adresuar këto mangësi, dhe në kontekstin e angazhimeve të qeverisë në kuadrin e Nismës së Partneritetit për Shoqëri të Hapur, qeveria bashkë me organizatat e shoqërisë civile përgatiti projektligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, që synon të vendosë një kuadër të qartë për konsultimet. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe konsultimit publik për projektligjet, projektdokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, si edhe politikat me interes publik të lartë. Pritet që ky ligj të përcaktojë rregullat procedurale përmes të cilave garantohet transparenca dhe pjesëmarrja e publikut në politikëbërje. Qeveria ka zhvilluar një konsultim publik mbi këtë projektligj dhe ka marrë një numër të madh sugjerimesh që prekin një gamë të gjerë çështjesh.

Për t'iu përgjigjur kërkesave për konsultime më të qenësishme me komunitetin e biznesit dhe partnerët socialë, qeveria ngriti Këshillin Kombëtar Ekonomik (KKE) që ka filluar punën në vitin

2014. KKE-ja do të këshillojë qeverinë mbi çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik dhe pritet të rritë transparencën në vendimmarrjen publike dhe përfaqësimin e sektorit privat në këtë proces.

Aksione të propozuara:

3.1 Miratimi i projektligjit për njoftimin dhe konsultimin publik në Kuvend, si edhe i akteve nënligjore;

3.2 Krijimi i regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike;

3.3 Përgatitja e manualit me udhëzime hap pas hapi për nëpunësit civilë mbi zhvillimin e konsultimeve publike efektive;

3.4 Përgatitja e metodologjisë për raportimin vjetor të rezultateve të konsultimeve publike dhe rritja e transparencës së procesit të vendimmarrjes, me informimin e duhur mbi numrin e akteve të miratuara nga organi publik gjatë vitit të caktuar, numrin e rekomandimeve që u kanë shkuar aktorëve, numrin e rekomandimeve dhe komenteve të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes dhe numrin e takimeve publike të organizuara;

3.5 Dhënia e çmimit kombëtar vjetor për praktikat më të mira në lidhje me transparencën dhe gjithëpërfshirjen e procesit të vendimmarrjes në organet publike;

3.6 Krijimi i një programi trajnues për nëpunësit civilë, i drejtuar nga Shkolla Shqiptare për Administratën Publike, fokusuar në bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile në politikëbërjen publike.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

-Mbështetje e organizimit të trajnimeve sistematike për koordinatorët e emëruar mbi njoftimin dhe konsultimin publik në të gjitha organet publike, si edhe për nëpunësit civilë të tjerë (që punojnë në departamentet ligjore apo të burimeve njerëzore);

-Organizimi i fushatave të sensibilizimit publik për të paraqitur mundësi të reja për përfshirjen e qytetarëve, OSHC-ve dhe publikut të interesuar në konsultimet mbi politikat publike të reja;

-Organizimi i çmimit kombëtar vjetor për praktikat më të mira për transparencën dhe gjithëpërfshirjen e procesit të vendimmarrjes në organet publike.

Institucionet përgjegjëse: MIE, AMSHC

4. KUADRI I FINANCIMIT PUBLIK PËR PROGRAMET E OSHC-ve

OSHC-të shqiptare mbeten shumë të varura nga financimi i huaj, që për momentin nuk i plotëson nevojat e sektorit të OSHC-ve dhe për më tepër është duke u pakësuar. Mundësitë e brendshme të financimit janë të pakta, ndërsa financimi i shtetit për OSHC-të përfshin kontraktimin për ofrimin e shërbimeve dhe dhënien e granteve për projekte përmes ministrive të linjës dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (ASCS). ASCS ofron grante për OSC-të për të financuar projekte që fokusohen në luftën kundër korrupsionit, pjesëmarrjen e qytetarëve, iniciativat advokuese, dhuna në familje, punësimi, etj. Tre vitet e fundit, ASCS-ja ka kryer katër raunde të skemave të granteve. Janë dhënë grante të vogla deri në 1.000.000 lekë për 213 OSHC. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka kontraktuar OSHC-të për të drejtuar një numër shërbimesh si qendrat e kujdesit, qendrat e trajnimit dhe arsimit, si dhe ato të formimit profesional. Gjithashtu, një numër projektesh të OSHC-ve janë financuar nga ministritë e tjera, veçanërisht në fushat e kulturës, artit, sportit, trashëgimisë kulturore dhe rinisë.

Një nga rreziqet më të mëdha për qëndrueshmërinë e punës së OSHC-ve është mungesa e rregullave dhe procedurave të qarta për financimin publik të programeve të OSHC-ve dhe kontraktimi i OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale. Në këtë moment, procedurat për shpërndarjen e fondeve publike janë përshkruar vetëm në ligjin për Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (ASCS) dhe rregulloret e tjera të brendshme të ASCS-së. Meqenëse ekzistenca e vetë ASCS-së nuk është e mjaftueshme për të përmbushur të gjitha nevojat për financimin e programeve të OSHC-ve dhe ofrimin e shërbimeve sociale, është e nevojshme të investohet në vendosjen e rregullave, standardeve dhe procedurave të qarta për alokimin e fondeve publike për OSHC-të në të gjitha nivelet, veçanërisht njësitë e qeverisjes vendore. Prandaj, është e nevojshme të miratohet një rregullore e re që do të mundësonte vendosjen e sistemit të qartë të financimit publik, me rregulla të sakta për çdo fazë të procesit të marrjes së grantit, përfshi monitorimin dhe vlerësimin. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh pengesat e shumta me të cilat OSHC-të po përballen për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit të zyrtarëve publikë për instrumentet ligjore ekzistuese për

sigurimin e shërbimeve nëpërmjet sektorit jofitimprurës dhe të gjitha përfitimeve që rrjedhin nga kontraktimi i OSHC-ve. Ndërgjegjësimi i ulët i organeve të administratës publike për avantazhet e partneritetit me OSHC-të për zgjidhjen e problemeve të komunitetit vendor është ndër pengesat më të mëdha për diversifikimin e burimeve të financimit dhe modelet e mbështetjes për OSHC-të. Nevojiten rregulla të qarta për alokimin e fondeve publike dhe kontraktimin e OSHC-ve për të kapërcyer paragjykimet dhe shumë sfida të tjera ekzistuese në këtë fushë.

Me perspektivat për decentralizimin e shërbimeve sociale, në linjat me planet e reformave administrative dhe territoriale është e nevojshme për të forcuar kapacitetet e njësive të qeverisjes vendore për partneritet me OSHC-të si aktorë të pashmangshëm në sigurimin me cilësi të lartë të shërbimeve të përgjegjshme sociale të arritshme. Sipas praktikave më të mira të BE-së të gjithë ofruesit e shërbimeve sociale, OSHC-të duhet të jenë të licencuar, me përvojë, të vlerësuar dhe të rregulluar me një sistem të standardizuar kombëtar dhe të monitoruar nga institucionet përgjegjëse të shërbimit social të standardeve të ofrimit të inspektimeve. Kjo do të kërkojë ndryshimet e nevojshme ligjore që do të lejojë që ofrimi i shërbimeve nga OSHC-të të jetë i integruar plotësisht në sistemin e qeverisjes lokale të ofrimit të shërbimeve dhe në të njëjtën kohë i politikës së përfshirjes sociale dhe strategjisë së mbrojtjes sociale.

Aksione të propozuara:

4.1 Ndryshimi i ligjit për organizatat jofitimprurëse me nene të reja për mbështetjen shtetërore të OJF-ve, që siguron bazën ligjore për miratimin e akteve nënligjore (rregullore), për përcaktimin e standardeve, parametrave dhe kritereve të qarta për alokimin e fondeve publike për programet e OSHC-ve, përfshin kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale si në nivel kombëtar dhe vendor të qeverisjes, por edhe për përcaktimin e bazës për përparimin domethënës në transparencën e procedurave të alokimit të fondeve dhe disponueshmërinë e të dhënave të hollësishme mbi rezultatet e thirrjeve për propozime.

4.2 Krijimi i një databaze publike me informacion të detajuar rreth të gjitha granteve nga buxheti i shtetit për OSHC-të, ku organizatat dhe ministritë/ institucionet publike mund të gjejnë informacion.

4.3 Përgatitja e raporteve vjetore për financimin e përgjithshëm publik për programet e OSHC-ve me analizë të detajuar të fushave kryesore dhe të përfituesve të granteve, si dhe të dhëna të sakta mbi punën e të gjitha organeve publike që ofrojnë financim për programet e OSHC-ve, në drejtim të respektimit të standardeve, parimeve dhe procedurave të vendosura nga rregullorja.

4.4 Krijimi i një sistemi të përbashkët informativ mbi financimin publik të OSHC-ve për të mundësuar koordinim dhe shkëmbim informacioni në kohë reale dhe efektiv ndërmjet të gjitha organeve publike që financojnë programet e OSHC-ve.

4.5 Amendimi ose miratimi i akteve të reja ligjore në fushën e prokurimit publik, standardizimit dhe licencimit të shërbimeve sociale, në mënyrë që të mundësojë kontraktimin efektiv të OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Hartimi dhe zbatimi i programit trajnues për nëpunësit civilë në të gjitha nivelet për të siguruar zbatimin normal të rregullave të reja të financimit publik dhe procedurave të OSHC-ve, me theks të veçantë në standardet e ofrimit të shërbimeve sociale dhe nëpunësve civilë që kanë të bëjnë me prokurimin.

-Përgatitja e një manuali për nëpunësit civilë për financimin publik të programeve të OSHC-ve, përfshi bashkëpunimin në ofrimin e shërbimeve sociale.

- Mbështetje për zhvillimin e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave dhe asistimi për përgatitjen e raporteve vjetore mbi financimin e përgjithshëm publik për programet e OSHC-ve.

Institucionet përgjegjëse: MIE, AMSHC, MF

5. KUADRI LEGJISLATIV PËR REGJISTRIMIN DHE PUNËN E OSHC-ve

Aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile (OSHC-të) rregullohen kryesisht me ligjin për shoqëritë jofitimprurëse dhe ligjin mbi regjistrimin e organizatave jofitimprurëse. Themelimi, regjistrimi, funksionimi, organizimi dhe veprimtaria e OSHC-ve rregullohet me ligjin për organizatat jofitimprurëse (nr. 8788, 2001/07/05). OJF-të përfshijnë: 1. organizatat e anëtarësimit me të paktën pesë persona ose dy entitete ligjore si anëtarë themelues dhe asamblenë e përgjithshme si

organin më të lartë vendimmarrës; dhe 2. fondacionet dhe qendrat që mund të krijohen nga një ose më shumë persona ose me testament dhe të kenë bordin e drejtorëve si organin më të lartë vendimmarrës.

Ligji aktual për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse (OJF-ve) parashikon sistem të centralizuar të regjistrimit të OJF-ve vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Vendimi për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo vendim tjetër në lidhje me veprimet që lidhen me regjistrimin e tyre, merret nga një gjyqtar i vetëm i seksionit tregtar të gjykatës pas aplikimit të subjektit të interesuar. Rregullat e tanishme të regjistrimit konsiderohen mjaft diskriminuese ndaj organizatave me bazë jashtë Tiranës. Veçanërisht, centralizimi i sistemit të regjistrimit të organizatave jofitimprurëse vetëm në Gjykatën e Tiranës nënkupton shpenzime shtesë për OJF-të jashtë kryeqytetit, të gatshme për të regjistruar një organizatë jofitimprurëse. Kjo mund të konsiderohet si faktor demotivues dhe rëndues për zhvillimin e balancuar rajonal të shoqërisë civile në Shqipëri. Sipas raportit të vlerësimit të nevojave nga zyra TACSO Shqipëri në vitin 2013, shumica e OSHC-ve janë të përqendruara në Shqipërinë qendrore, veçanërisht në Tiranë. OSHC-të e tjera janë nga qytetet e mëdha në veri (Shkodër) dhe në jug (Korçë, Fier dhe Vlorë). Sektori i shoqërisë civile është i dobët në rrethet e largëta dhe veçanërisht në zonat rurale, ndërsa numri i grupeve aktive joformale me bazë komuniteti është shumë i ulët.

Decentralizimi i procesit të regjistrimit të organizatave jofitimprurëse do të lejojë akses më të mirë në organet e regjistrimit në nivel vendor. Kjo kërkon ndryshime në ligjin aktual për regjistrimin e OJF-ve, që do të thotë, rregullimi i gjithë procedurës së regjistrimit të organizatave jofitimprurëse në organet kompetente (gjykatat).

Aksione të propozuara:

5.1 Ndryshimi i ligjit aktual për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse për të mundësuar decentralizimin e procesit të regjistrimit të OJF-ve;

5.2 Përgatitja e udhëzimeve të hollësishme për organet kompetente të regjistrimit në nivel vendor për të siguruar zbatimin e harmonizuar të ligjit;

5.3 Hartimi i programit trajnues për organet kompetente (gjykatat) për regjistrimin e OJF-ve;

5.4 Krijimi i sistemit të përbashkët informativ elektronik që lidh të gjitha organet e regjistrimit në nivel vendor dhe që mundëson përditësimin automatik të informacionit për të gjitha OJF-të e regjistruara.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Përgatitja e udhëzimeve dhe ofrimi i programit trajnues për organet e regjistrimit për të siguruar zbatimin e harmonizuar të ligjit.
- Përgatitja dhe vënia në funksion e sistemit të përbashkët informativ elektronik për organet e regjistrimit.
- Zbatimi i programit trajnues për organet e regjistrimit.

Institucionet përgjegjëse: Ministria e Financave, MIE, AMSHC

6. KONTABILITETI/RAPORTIMI FINANCIAR DHE TRAJTIMI TATIMOR I OSHC-ve

Tatimet aktuale, raportimi financiar dhe rregullat e kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse konsiderohen të rënda nga shumica e OSHC-ve. Shumë OSHC, veçanërisht ato të sapokrijuarat, shoqatat rinore, grupet e cenueshme dhe ato të margjinalizuara, si dhe OSHC-të që veprojnë në zonat e largëta vështirë se përputhen me rregulloret për tatimet dhe menaxhimin financiar. Sipas ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe ligjin për inspektimin financiar publik dhe raportimin, OSHC-të kanë kontabilitet disproporcional dhe detyrime raportimi, edhe nëse nuk angazhohen në aktivitete ekonomike. Pritet gjithashtu që OSHC-të (sipas legjislacionit të sigurimeve shoqërore) të kenë të paktën një staf me kohë të plotë dhe të paguajnë të gjitha taksat, me qëllimin për të mbajtur OSHC-të funksionale. Ky lloj detyrimi e ka ulur ndjeshëm numrin e organizatave aktive në Shqipëri meqë shumë prej tyre nuk mund të përballojnë përmbushjen e këtyre kritereve. Përveç kësaj, legjislacioni në fuqi nuk parashikon diferencim të qartë ndërmjet aktiviteteve ekonomike dhe atyre jofitimprurëse, si dhe mungojnë udhëzimet e sakta nga organizatat tatimore për OSHC-të për aktivitetet ekonomike të lejuara. Ligji i ri për tatimin mbi vlerën e shtuar (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 128, 13 gusht 2014), i cili hyn në fuqi më 1 janar 2015, përpiqet të sjellë më shumë qartësi në këtë fushë.

Kërkesat e raportimit ekzistues, përveç të qenit të papërshtatshme dhe të rënda, nuk mundësojnë kryerjen e statistikave të rregullta dhe të besueshme për sektorin jofitimprurës. Me futjen e rregullave të

veçanta të kontabilitetit dhe të raportimit financiar për sektorin jofitimprurës, mund të merren parasysh specifikat e menaxhimit të organizatave jofitimprurëse, gjithashtu duke marrë parasysh parimin e proporcionalitetit, veçanërisht për organizatat më të vogla dhe ato që nuk angazhohen në aktivitete ekonomike. Rregullat më të hollësishme dhe specifike për OJF-të do të mundësojnë kryerjen e statistikave më të avancuara për zhvillimin e sektorit jofitimprurës (d.m.th. të ardhurat e përgjithshme, burimet e financimit, asetet, numri i të punësuarve, numri i vullnetarëve etj.) që janë të rëndësishme për programimin, monitorimin dhe vlerësimin e financimit të programeve të OSHC-ve.

Përjashtimi në mënyrë të qartë dhe eksplicite nga taksat për grantet duhet të përfshihet në ligj (dhe jo udhëzimet e Ministrisë së Financave ose aktet e tjera nënligjore) për të parandaluar ndonjë keqinterpretim mbi këtë çështje nga autoritetet tatimore vendore.

Në lidhje me trajtimin tatimor/fiskal të donatorëve të OSHC-ve, aktualisht nuk ekzistojnë incentiva për personat që dëshirojnë të japin donacione për programet e OSHC-ve. Njohja në legjislacionin tatimor të donacioneve për OSHC-të si shpenzime të zbritshme do të nxiste filantropinë individuale dhe do të kontribuonte në qëndrueshmërinë e përpjekjeve për zhvillimin e shoqërisë civile. Kur është fjala për bizneset që paguajnë tatimin standard mbi fitimin, ata mund të pretendojnë shpenzime të zbritshme nga donacionet (klasifikuar si "sponsorizim" biznesi) për OSHC-të deri në 4% të të ardhurave të tatueshme. Për sipërmarrësit që paguajnë "taksën e biznesit të vogël", tatimi mbi donacionet mund të zbritet deri në 1% të të ardhurave të tatueshme. Megjithatë, bizneset vetëm rrallë e shfrytëzojnë atë, kryesisht për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit dhe njohjes publike të këtyre investimeve sociale.

Ky është parakusht për ndërtimin e besimit të publikut në punën e OSHC-ve dhe forcimin e besueshmërisë së përpjekjeve të OSHC-ve për avokimin publik në të gjitha fushat e politikave.

Aksione të propozuara:

6.1 Hartimi i një projektakti të veçantë për operacionet financiare dhe kontabilitetin e OJF-ve që merr parasysh specifikat e menaxhimit të tyre;

6.2 Hapja e debatit publik për rishikimin e modeleve të raportimit financiar për OJF-të për të mundësuar mbledhjen/grumbullimin e të dhënave cilësore për sektorin jofitimprurës;

6.3 Ndryshimi i legjislacionit fiskal aktual për të njohur donacionet për OSHC-të si shpenzime të zbritshme, me qëllim që të nxitet filantropia individuale dhe të kontribuohet në qëndrueshmërinë e përpjekjeve të shoqërisë civile;

6.4 Analizimi i impaktit të kërkesës aktuale ligjore që e detyron çdo OSHC të regjistruar që të ketë të paktën një punonjës për të cilin është paguar sigurimi shëndetësor dhe social;

6.5 Krijimi i një databaze qendrore on-line me të gjitha raportet financiare të organizatave jofitimprurëse që mund të bëhen publike, me synimin për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e organizatave jofitimprurëse.

Fushat e mundshme për asistence teknike:

- Përgatitja e manualit për autoritetet tatimore dhe OSHC-të për trajtimin tatimor dhe aktivitetet ekonomike që mund të ndërmerren nga sektori jofitimprurës;
- Kryerja e programeve trajnuese për administratën tatimore mbi trajtimin e tatimeve / TVSH të organizatave jofitimprurëse për të siguruar zbatimin e harmonizuar të rregullave në të gjitha nivelet e administratës tatimore;
- Krijimi i modeleve të reja të raportimit financiar që do të mundësojnë përgatitjen e statistikave më të avancuara për OSHC-të;
- Nisja e fushatës së ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e zhvillimit të filantropisë individuale dhe të përbashkët si parakushte thelbësore për qëndrueshmërinë e programeve të përfitimit publik të OSHC-ve.

Institucionet përgjegjëse: MF, AMSHC.

7. MBLEDHJA DHE DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Disponueshmëria dhe cilësia e të dhënave për tendencat e zhvillimit të shoqërisë civile është me rëndësi strategjike për vlerësimin më cilësor të nevojave dhe programimin e ardhshëm të modeleve, si dhe rritja e mbështetjes ndaj shoqërisë civile nga burimet financiare të brendshme dhe ato ndërkombëtare, publike dhe private. Aktualisht, nuk ka ende të dhëna të besueshme zyrtare në dispozicion për numrin e përgjithshëm të OSHC-ve të regjistruara në vend.

Sipas të dhënave të Njësisë së Inteligjencës Financiare të mbledhura për qëllime të indeksit të

qëndrueshmërisë së OSHC-ve USAID 2012, ekzistojnë 1651 OSHC të regjistruara nga organet tatimore në Ministrinë e Financave të Shqipërisë. Raporti i fundit i vlerësimit të nevojave TACSO 2013 përmend rreth 3000 OSHC të regjistruara (2,231 shoqata, 311 fondacione dhe 552 qendra). Megjithatë, këto nuk janë të dhëna zyrtare, meqenëse Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, si organi i vetëm qendror për regjistrimin e OSHC-ve në Shqipëri, nuk mban të dhëna elektronike dhe për këtë arsye nuk është në gjendje të sigurojë një numër të saktë të OSHC-ve të regjistruara ose t'i bëjë ato të disponueshme nëpërmjet internetit përmes një databaze të aksesueshme. Për këtë arsye, nuk është e mundur të ndiqen trendet e regjistrimit të OSHC-ve në pjesë të ndryshme të vendit dhe në sektorë të ndryshëm të aktiviteteve. Mungesa e databazës në faqen zyrtare dhe publike të OSHC-ve gjithashtu mund të konsiderohet si pengesë e rëndësishme për ndërtimin e besimit të publikut në punën e OSHC-ve.

Përveç të dhënave themelore për numrin dhe profilin e OSHC-ve, është e nevojshme të ndiqen edhe të dhënat e tjera që mund të japin ndikimin social të programeve dhe vlerësimin e kontributeve të OSHC-ve në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik, si: numri i të punësuarve, të ardhurat e përgjithshme, burimet e financimit, pasuritë, numri i punonjësve, numri i vullnetarëve etj. Kjo do të kërkojë ndryshime në legjislacionin aktual për regjistrimin dhe raportimin e OSHC-ve.

Aksione të propozuara:

7.1 Ndryshimi i ligjit aktual për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse që është rregullimi i procedurave për regjistrimin e OJF-ve, si dhe për mirëmbajtjen e regjistrit – kapitulli përkatës i ligjit (veçanërisht kapitulli III mbi formën dhe përmbajtjen e regjistrit) duhet të ndryshohet në mënyrë që të lejojë krijimin e regjistrit elektronik.

7.2 Për të lejuar publikun e interesuar që të ketë akses në të dhënat themelore të OSHC-ve të regjistruara, duhet të krijohet një databazë e aksesueshme publike që do të përditësohet rregullisht me të gjithë informacionin relevant për OSHC-të (data e regjistrimit, detaje për adresat/kontaktin, sektorin(t) e aktiviteteve, emri i presidentit/ personave të tjerë të autorizuar për të përfaqësuar OSHC-në etj.) dhe të kërkueshme sipas kritereve të ndryshme (emër, grup/ nëngrup i aktiviteteve, qyteti/rajoni i selisë së OSHC-së, etj.).

7.3 Ndryshimi i legjislacionit aktual ose hartimi i legjislacionit të ri që rregullon raportimin financiar të OJF-ve, me qëllim që të përgatiten modele të reja raportimi që mundësojnë përgatitjen e statistikave më të avancuara për OSHC-të.

7.4 Publikimi i skedave të përditësuara me statistika kyçe për kontributin e sektorit të shoqërisë civile në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, si dhe përhapja e gjerë e rezultateve.

Fushat e mundshme për asistence teknike:

- Asistencë për zhvillimin e klasifikimit/kategorizimit të ri të sektorëve/nënsektorëve të aktiviteteve të OJF-ve si bazë për krijimin e sistemit të ri të regjistrimit dhe krijimin e databazës publike me informacion më të detajuar mbi profilin e OJF-ve në të gjithë vendin (përfshi workshope-t e këshillimit me OSHC-të mbi kriteret për klasifikimin e sektorëve të aktiviteteve të OJF-ve).

Institucionet përgjegjëse: MF, AMSHC

8. ZHVILLIMI I VULLNETARIZMIT

Aktualisht, nuk ka një politikë shtetërore që mbështet zhvillimin e vullnetarizmit në Shqipëri. Kjo manifestohet me mungesën e kuadrit ligjor për vullnetarizimin, mungesën e incentivave shtetërorë për infrastrukturën apo programet vullnetare, mungesën e të dhënave të besueshme mbi numrin e vullnetarëve, si edhe konceptet e gabuara dhe stereotipet për vullnetarizmin të përhapura që janë trashëguar nga periudha komuniste.

Mungesa e rregullimit ligjor për vullnetarizmin ka rezultuar problem në praktikë për shumë vende evropiane, gjë që ka dekurajuar vullnetarizmin dhe ka lejuar hapësira për keqpërdorim. Shumica e shteteve anëtare të BE-së kanë njohur rëndësinë e rregullimit ligjor të vullnetarizmit dhe kanë vendosur, gjatë viteve të fundit, që të rregullojnë çështjen e vullnetarizmit si me anë të legjislacionit të brendshëm, ashtu edhe me anë të akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Të gjitha vendet që kanë miratuar një ligj për vullnetarizmin rregullojnë ose mundësojnë këto drejtime: i) promovimi i vullnetarizmit si veprimtari me rëndësi të përgjithshme sociale; ii) vullnetarizmi afatgjatë dhe transkombëtar i rinisë; iii) kompensimi i kostove që rrjedhin nga vullnetarizmi; iv) sigurimi ndaj dëmtimeve; v) përcaktimi i të drejtave dhe miratimi i Kodit të Etikës për Vullnetarin.

Miratimi i një kuadri ligjor të qartë për vullnetarizmin, qartësimi i detyrimeve dhe përgjegjësive të të gjitha palëve, përfshi standardet

etike dhe cilësore të vullnetarizmit, mund të kontribuojnë në zgjerimin e njohjes së punës vullnetare dhe në ndryshimin e mendësisë mbi vlerat e vullnetarizmit. Hap i mëtejshëm në këtë proces është krijimi i një infrastrukture solide me qendra vullnetare vendore, që mund të mbështeten nga shteti apo aktorë të tjerë, si edhe formimi i programeve financuese për zhvillimin e vullnetarizmit. Pas miratimit të një kuadri ligjor të qartë me përcaktimet e duhura për vullnetarizmin, si edhe ngritja e një infrastrukture solide, mund të realizohen fushata sensibilizuese dhe veprimtari për promovimin e vullnetarizmit. Për organizatorët e punës vullnetare mund të miratohen akte nënligjore për raportimin, me qëllim që të lehtësohet mbledhja e të dhënave për vullnetarizmin dhe matja e vlerës ekonomike të punës vullnetare.

Aksione të propozuara:

8.1 Miratimi i ligjit për vullnetarizmin që rregullon qartë mundësitë, të drejtat dhe detyrimet në lidhje me punën vullnetare;

8.2 Mbështetja e forcimit të qendrave vullnetare vendore në Shqipëri, si infrastrukturë e nevojshme për punën vullnetare;

8.3 Ngritja e skemave të financimit nga shteti për të mbështetur zhvillimin dhe menaxhimnin e programeve vullnetare, si në OSHC, ashtu edhe në institucionet publike në mbarë vendin;

8.4 Krijimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi shpeshtësinë dhe përhapjen e veprimtarive vullnetare (mundësisht përmes akteve nënligjore specifike që përcaktojnë kriteret e raportimit për organizatorët e punës vullnetare), si edhe vlerën ekonomike të punës vullnetare;

8.5 Krijimi i Çmimit Kombëtar për punën vullnetare si pjesë e promovimit të praktikave më të mira në vullnetarizëm si edhe inkurajimi i interesit mediatik për këtë çështje.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

- Përgatitja e manualit për OSHC-të dhe organizatorët e tjerë të vullnetarizmit mbi zbatimin e kërkesave të reja në kuadrin e ligjit për vullnetarizmin që do të miratohet;

- Orgarnizimi i programeve trajnuese për koordinatorët e punës vullnetare në OSHC-të dhe institucionet publike mbi menaxhimin efektiv të programeve vullnetare;

- Mbështetja e fushatës sensibilizuese kombëtare mbi vlerat e vullnetarizmit;

- Kontribut në zhvillimin e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave mbi punën vullnetare.

Institucionet përgjegjëse: MMSR, MIE, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

9. Kontributi i OSHC-ve në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë

Siç theksohet në udhëzimet e *DG Enlargement* për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit gjatë 2014-2020, fuqizimi i shoqërisë civile luan rol të rëndësishëm në respektimin në praktikë e vlerave dhe parimeve themelore të traktateve të BE-së, në vendet që dëshirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit. Procesi i integrimit në BE nënkupton reforma gjithëpërfshirëse që prekin të gjitha segmentet e shoqërisë dhe pothuajse të gjithë sektorët ku OSHC-të janë aktive. Prandaj, ky proces mund të konsiderohet si katalizator për të forcuar qeverisjen e mirë dhe kulturën e dialogut midis qeverisë dhe sektorit joshtetëror. Ministria e Integrimit Evropian ka hedhur hapa të rëndësishëm, tashmë, drejt forcimit të bashkëpunimit me OSHC-të në procesin e integrimit evropian, sidomos duke ngritur një sektor për bashkëpunimin me OSHC-të dhe pjesëmarrjes aktive në koordinimin e mbështetjes së donatorëve për OSHC-të.

Bazuar në përvojën e vendeve kandidate dhe të shteteve anëtare të reja, roli i shoqërisë civile në procesin e integrimit evropian mund të përmblidhet si vijon:

- përfshirja direkte në negociatat e anëtarësimit (*screening*, përgatitja e pozicioneve kombëtare, mbikëqyrja e progresit);

- dialogu me qeverinë në formulim politikash dhe në harmonizim legjislativ me acquis të BE-së;

- monitorimi i zbatimit të legjislacionit që harmonizon acquis të BE-së si dhe gjurmimi i efekteve sociale të procesit të reformave;

- pjesëmarrja në programimin e financimit të asistencës së paraderimit;

- zbatimi i projekteve të rëndësishme të financuara nga BE-ja në fusha kyçe të reformave në kuadrin e intregrimit evropian;

- komunikimi i temave të BE-së dhe thellimi i njohurive të qytetarëve mbi efektet sociale dhe ekonomike të reformave që ndërmerren në kuadër të integrimit evropian, duke kontribuar kështu në marrjen e vendimit të mirinformuar mbi aderimin në BE në fund të procesit të paraanëtarësimit;

- dhënie kontributi për të krijuar një startegji komunikimi me jashtë më të suksesshme për

shoqërinë, përmes rrjeteve të BE-së dhe projekteve të partneritetit me OSHC-të nga shtetet anëtare, duke promovuar njohjen dhe solidaritetin trans-kombëtar, por duke ndihmuar edhe në kapërcimin e perceptimit për "lodhjen nga zgjerimi" që ekziston ndër aktorët kyç dhe qytetarët e vendeve të BE-së.

Aksione të propozuara:

9.1 Mundësimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në të gjitha grupet e ekspertëve, grupet e punës për çdo kapitull dhe takimet e ekipit negociator kurdo që çështjet e aderimit prekin shoqërinë civile, përmes një procesi përzgjedhjeje transparent pas një ftese publike me kritere të qarta.

9.2 Angazhimi i OSHC-ve në kryerjen e vlerësimeve të ndikimit rregullator (RIA), kur përgatiten pozicionet kombëtare negociuese dhe bëhet harmonizimi ligjor, me qëllim që të bëhet identifikimi i risqeve në kohën e duhur.

9.3 Miratimi dhe publikimi i politikave për transparencën e strukturave negociuese, procedurat dhe afatet, si edhe të paktën përmbajtjen e pozicioneve negociuese për dijeninë e publikut të gjerë.

9.4 Rritja e pjesëmarrjes së OSHC-ve në programimin e fondeve të paraanëtarësimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit.

9.5 Sigurimi i fondeve adekuate nga BE-ja për zhvillimin e shoqërisë civile, sidomos për programet që kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve që të kryejnë monitorim efektiv të zbatimit të acquis të BE-së dhe kohëzgjatjes së reformave të integrimit evropian.

9.6 Mbështetja e ngritjes së fondit për bashkëfinancimin e projekteve të BE-së për OSHC-të.

9.7 Përgatitja e planit të komunikimit publik për procesin e integrimit në BE, ku specifikohet roli i shoqërisë civile në zbatimin e planit të komunikimit.

9.8 Investimi i fondeve shtesë në forcimin e rrjeteve evropiane të OSHC-ve që të forcojnë kapacitetet për pjesëmarrjen e tyre në proceset e politikave kombëtare, edhe që të mundësohen për të dhënë kontribut më thelbësor në promovimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe solidaritetit ndërmjet qyetarëve shqiptarë dhe qytetarëve të BE-së.

9.9 Forcimi i kapaciteteve të Njësisë për Shoqërinë Civile dhe Strategjinë pranë MIE-s që të luajë rol kyç në sigurimin e përfshirjes aktive të OSHC-ve në të gjitha aspektet e procesit të integrimit evropian të Shqipërisë.

9.10 Mundësimi i përfshirjes efektive të OSHC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian (bazuar në kritere përzgjedhjeje transparente), si mekanizëm institucional kyç për konsultimet mbi çështjet e BE-së.

Fushat e mundshme për asistencë teknike:

-Asistimi i Ministrisë së Integrimit Evropian në përgatitjen dhe zbatimin e planit të komunikimit të integrimit evropian, në partneritet me shoqërinë civile;

-Organizimi periodik i debateve publike mbi çështjet e *acquis* të BE-së, me pjesëmarrjen e qytetarëve, OSHC-ve, partnerëve socialë dhe përfaqësuesve të tjerë të shoqërisë civile të organizuar nga mbarë vendi;

-Forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve për pjesëmarrje më aktive në çështjet e BE-së;

-Lehtësimi i komunikimit të punës së Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian te shoqëria civile.

Institucionet përgjegjëse: MIE

SHTOJCA 1

FUSHAT PRIORITARE DHE INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E: UDHËRRËFYESIT PËR HARTIMIN E POLITIKËS DHE MASAVE PËR NJË MJEDIS MUNDËSUES PËR SHOQËRINË CIVILE

Fushat prioritare dhe institucionet përgjegjëse për zbatim		
UDH.01	**Mjedisi kombëtar i politikave strategjike për zhvillimin e shoqërisë civile**	**Kryeministria Ministria e Integrimit Europian**
UDH.02	**Institucionet që mbështesin bashkëpunimin qeveri-OSHC**	**Kryeministria Ministria e Integrimit Europian Ministria e Financave Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile**
UDH.03	**Përfshirja e OSHC-së në procesin e politikëbërjes**	**Ministria e Integrimit Europian Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile**
UDH.04	**Kuadri i financimit publik për programet e OSHC-së**	**Ministria e Integrimit Europian Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile Ministria e Financave**
UDH.05	**Kuadri legjislativ për regjistrimin dhe punën e OSHC-së**	**Ministria e Integrimit Europian Ministria e Financave Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile**
UDH.06	**Kontabiliteti/raportimi financiar dhe trajtimi tatimor i OSHC-së**	**Ministria e Financave Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile**
UDH.07	**Mbledhja dhe disponueshmëria e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile**	**Ministria e Financave Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile**
UDH.08	**Zhvillimi i vullnetarizimit**	**Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Ministria e Integrimit Europian Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile**
UDH.09	**Kontributi i OSHC-së në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë**	**Ministria e Integrimit Europian**

VENDIM
Nr. 460, datë 27.5.2015

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PARË KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E KONVENTËS SË OKB-SË "PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të konventës së OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara"", ratifikuar me ligjin nr. 108/2012, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Raportit të Parë Kombëtar për zbatimin e konventës së OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHQYRTIMI I RAPORTEVE, PARAQITUR NGA SHTETET PALË BAZUAR NË NENIN 35 TË KONVENTËS "PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA"
PROJEKT-RAPORTI I PARË

LISTA E SHKURTIMEVE

Shkurtimi	**Emërtesa e plotë**
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AP	Avokati i Popullit
DAR/ZA	Drejtori arsimore/zyrë arsimore
DRSHSSH	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
FSHDPAK	Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
IEVP	Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale
INSTAT	Instituti i Statistikave
ICF-CY	*International Classification of Functioning, Disability and Health for Children and Youth*
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KMCAP	Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë
KEDNJ	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
KKAK	Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJF	Organizata joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve te Bashkuara
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OSHMA	Ofrues të Shërbimeve Mediatike Audiovizive
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PNUD	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
RSH	Republika e Shqipërisë
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
SOROS	Fondacioni për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri
SDC	Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim
TVSH	Televizioni Publik Shqiptar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
UNICEF	*United Nations Children's Fund*/Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNFPA	*United Nations Population Fund*/ Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
KDESHK	Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore e Kulturore

HYRJE

1. Në zbatim të nenit 35 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara[1], Shqipëria i paraqet Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, raportin e parë për përmbushjen e detyrimeve të saj. Konventa DPAK hyri në fuqi për Shqipërinë në 11 shkurt 2013[2].

2. Shqipëria është e angazhuar të promovojë, të respektojë, të zbatojë, të përmbushë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, KDPAK, Konventën

[1] Këtej e tutje Konventa, ose KDPAK.

[2] Konventa u ratifikua nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 108, datë 15.11.2012, hyri në fuqi në 11 shkurt 2013.

Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), instrumentet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacionin e brendshëm.

3. Raporti përfshin informacione të detajuara për zbatimin e Konventës në Shqipëri, gjatë (shkurt 2013 - mars 2015), lidhur me kuadrin ligjor, nënligjor, politikat dhe masat konkrete për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

4. Raporti u hartua si rezultat i koordinimit të punës dhe përfshirjes së institucioneve shtetërore, sipas fushave të kompetencës mbi çështjet që trajton Konventa. Grupi Ndërministor i Punës (GNP) ngritur për këtë qëllim (urdhri i Kryeministrit nr. 112/2014)[3] përbëhej nga përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të pavarura: Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Kuvendi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve etj. Në kuadrin e hartimit të Raportit u zhvillua edhe procesi i konsultimit, me përfaqësues të institucioneve shtetërore, vendore, shoqërisë civile[4], organizatave ndërkombëtare, etj. Rol të rëndësishëm luajti mbështetja e PNUD, në procesin e hartimit të Raportit[5].

5. Raporti u hartua në përputhje me Udhëzimet[6] e Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Rezolutën[7] e Asamblesë së Përgjithshme mbi forcimin dhe përmirësimin e funksionimit efektiv të sistemit të traktateve për të drejtat e njeriut.

6. Raporti u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 460, datë 27.5.2015.

Informacion i përgjithshëm mbi personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri

7. Në Shqipëri 6.2 % e popullsisë mbi 15 vjeç, ka një formë aftësie të kufizuar, bazuar në censusin e popullsisë të vitit 2011[8] (shih figurën 1). Shifrat i referohen personave, që vetëidentifikohen se kanë vështirësi të rënda ose ekstreme në të paktën një prej aspekteve si: shikimi, dëgjimi, lëvizja, shqisore, kujdesi për veten, komunikimi. Duhet marrë në konsideratë fakti se: censusi nuk përfshin të dhëna për personat nën 15 vjeç; mungojnë të dhënat për lloje, tipa aftësish të kufizuara të padukshme për të cilat pyetjet e drejtuara nuk kanë qenë të orientuara drejt identifikimit të tyre; në disa raste pyetjet nuk janë orientuar në mënyrë të përshtatshme, duke bërë që të përftohen të dhëna për disa lloje aftësish të kufizuara, që sipas klasifikimeve ndërkombëtare nuk mund të cilësohen si të tilla.

Figura1: Aftësia e kufizuar sipas tipit (përqindje, %)



8. Prevalenca e aftësisë së kufizuar është e lidhur ngushtë me moshën. Aftësia e kufizuar te të rinjtë është në nivele të ulta, nën 3 % për të dy gjinitë. Për popullatën 50-64 vjeç, aftësia e kufizuar është 6 % për burrat dhe 8 % për gratë. Për moshat mbi 65 vjeç aftësia e kufizuar është në shifrat 20 % për burrat dhe 25 % për gratë[9] (*Censusi 2011*).

9. Në vitin 2013, sipas të dhënave për përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar bazuar në vlerësimin e Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), numri i personave me aftësi të kufizuar (individë me aftësi të kufizuar dhe invalidë) ishte 139,130 persona. Në vitin 2014, pagesat e aftësisë së kufizuar i përfitonin 143, 516 persona.

Zhvillime të së shkuarës

10. Në Shqipërinë e para viteve '90, personat me aftësi të kufizuara trajtoheshin kryesisht përmes modelit mjekësor, duke lënë jashtë kontekstin psiko – social në të cilin ata jetonin, si dhe rëndësinë e integrimit të tyre në shoqëri. Të gjitha institucionet e kujdesit për individët me aftësi të

[3] "Për ngritjen e GNP-së "Mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut".

[4] Organizatave të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

[5] Dy konsulentë nën drejtimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe mbështetjen e PNUD-it, punuan dhe mbështetën grupin e punës për hartimin e raportit.

[6] CRPD/C/2/3, 18 nëntor 2009.

[7] A/RES/68/268 , 9 prill 2014.

[8] Për më shumë detaje mbi të dhënat e censusit të vitit 2011, referim informacionit mbi nenin në vijim.

[9] Sipas të dhënave të censusit 2011.

kufizuara ishin nën varësinë dhe juridiksionin e Ministrisë së Shëndetësisë.

11. Zhvillimet e vrullshme që shoqëruan shoqërinë shqiptare në fillimin e viteve `90 pas rënies së komunizmit, sollën ndryshimet e para në mënyrën e trajtimit të individëve me aftësi të kufizuara, duke filluar që nga kuadri ligjor e më gjerë. Shqipëria nisi gradualisht të integrojë disa elementë socialë në trajtimin e aftësisë së kufizuar, krahas atyre mjekësorë. Dispozitat Kryesore Kushtetuese[10] të vitit 1991, njohën të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për përkrahje dhe ndihmë shoqërore. Një zhvillim i rëndësishëm u arrit në vitin 1993 me kalimin e kompetencave për aftësinë e kufizuar nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) tek Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)[11]. Gjatë viteve 1993-1996, u hartuan disa akte ligjore të rëndësishme për përkrahjen sociale, arsimimin, si edhe rehabilitimin e trajtimin e personave me aftësi të kufizuara, si: ligji për përkrahje dhe ndihmë sociale[12]; ligji për statusin e të verbrit; ligji për sistemin arsimor parauniversitar[13]"; ligji për shëndetin mendor[14]. Deri në vitin 2002, shërbimi social për personat me aftësi të kufizuara konsistonte vetëm në shërbim rezidencial në institucione dhe mbështetje ekonomike përmes pagesës së aftësisë së kufizuar dhe në disa raste, edhe me pagesën e kujdestarisë.

12. Që prej vitit 2002, janë bërë përpjekje për zgjerimin e tipologjisë së shërbimit për personat me aftësi të kufizuara duke aplikuar gradualisht shërbimin komunitar përkundrejt shërbimit rezidencial. Me gjithë progresin e arritur, ende mbetet shumë për të bërë në drejtim të realizimit të procesit të decentralizimit dhe deinstitucionalizimit të shërbimeve.

[10]Ligji nr. 7692, datë 31.03.1991 mbi Dispozitat Kryesore Kushtetuese. Në nenin 31 parashikohej se sipas një sistemi të caktuar, kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur ka një handikap.

[11] Në atë kohë emërtimi ishte Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

[12]Ligji nr. 7710, datë 18.05.1993 "Për përkrahjen dhe ndihmën sociale". Ky është akti i parë ligjor që i hapi rrugën gjithë rregullimeve të tjera ligjore në favor të trajtimit të individëve me aftësi të kufizuara.

[13]Ligji nr. 7592, datë 21. 6. 1995 ku për herë të parë arsimi special trajtohet në një kre më vete.

[14]Ligji nr. 8092, datë 21.3.1996 "Për shëndetin mendor" i cili garantonte ndër të tjera të drejtën e rehabilitimit dhe trajtimit falas në institucione të përkrahjes sociale, institucionet publike të rehabilitimit e arsimit.

13. Përpjekjet e Shqipërisë për respektimin dhe realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar janë të mëdha. Ato kulmuan me ratifikimin në vitin 2012, të KDPAK-së dhe miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë në korrik të vitit 2014, të ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

I. Dispozita të përgjithshme të konventës

Nenet 1 – 4 të Konventës

a) Masat ligjore

14. Konventa zbatohet në Shqipëri përmes Kushtetutës, ligjeve, akteve nënligjore. Sipas nenit 122 të Kushtetutës së Shqipërisë, marrëveshjet apo traktatet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e rendit të brendshëm ligjor, janë drejtpërdrejtë të zbatueshme, përveç rasteve kur zbatimi i tyre kërkon miratimin e një ligji. Një marrëveshje e ratifikuar me ligj prevalon mbi legjislacionin e brendshëm, i cili bie në kundërshtim me këtë traktat. Në këtë kuadër, Konventa është pjesë e sistemit të brendshëm ligjor në Shqipëri dhe në rast se norma të legjislacionit të brendshëm bien në kundërshtim me të, kjo Konventë ka përparësi.

Më specifikisht, Konventa bëhet efektive si vijon:

15. Kushtetuta, kryesisht përmes kreut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat garantohen dhe respektohen për çdo individ, përfshirë për personat me aftësi të kufizuara dhe "Objektivave sociale" (neni 59), ku parashikohen e drejta për punësim, strehim, kujdes shëndetësor, arsimim, riaftësim dhe integrim të personave me aftësi të kufizuara, përmirësim të kushteve të jetesës së tyre, përkujdesje, ndihmë për invalidët, me qëllim mbrojtjen e tyre nga përjashtimi social.

16. Ligji "Për sistemin arsimor para-universitar[15], që parashikon të drejta dhe kushte thelbësore për aksesueshmërinë dhe pjesëmarrjen e plotë, arsimimin cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin e detyrueshëm dhe atë parashkollor.

17. Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"[16], që përcakton parime dhe rregullime të përgjithshme në fushën e

[15]Ligji nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

[16]Ligji nr. 93, datë 24.7.2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".

përfshirjes, aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara, dhe detyrimet ligjore, institucionale në realizimin e gjithëpërfshirjes, integrimit të personave me aftësi të kufizuara në zbatim të parimeve të KDPAK-së. Ligji garanton nxitjen, mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë, efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për ta, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes. Ligji përcakton përgjegjësinë e strukturave publike, jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore, vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara.

18. Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi"[17] rregullon zbatimin, respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predis-pozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

19. Në legjislacionin shqiptar ka një sërë dispozitash të tjera mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara:

- Kuadri ligjor:

Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar;

Ligji nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik e tetraplegjik", i ndryshuar;

Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit të punës", i ndryshuar;

Ligji nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbërit", i ndryshuar;

Ligji nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor";

Ligji nr. 10 347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës";

Ligji nr. 7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar;

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar;

Ligji nr. 10237, datë 18.2.2010 'Për sigurinë dhe shëndetin në punë";

Kodi i Punës i RSH-së[18].

-Akte nënligjore

Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 904, datë 12.12.2012 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave, dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot", i ndryshuar;

VKM nr. 787 datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", i ndryshuar;

VKM nr. 658, datë 17.10.2005 "Për standardet e shërbimeve shoqërore";

VKM nr. 822, datë 6.12.2006 "Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara në qendrat rezidenciale dhe ditore";

VKM nr. 31, datë 20.1.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik e tetraplegjik", i ndryshuar;

VKM nr. 618, datë 7.9.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara", i ndryshuar;

VKM nr. 78, datë 7.2.2007 "Për masën, kriteret, procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjienosanitare për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë", i ndryshuar;

VKM nr. 277, datë 18.6.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", i ndryshuar;

VKM nr. 89, datë 26.1.2012 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë";

VKM nr. 869, datë 18.6.2008 "Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit të punës", i ndryshuar;

VKM nr. 723, datë 17.12.2008 "Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit të punës", i ndryshuar;

VKM nr. 404, datë 20.6.2012 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjikpër

[17] Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

[18] Në muajin prill 2015 janë miratuar në Këshillin e Ministrave disa ndryshime dhe shtesa në Kodin e Punës, të cilat në vijim priten të miratohen në Kuvendin e RSH-së.

faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”;

VKM nr. 565, datë 14.1.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kwh në muaj”, të ndryshuar;

VKM nr. 8, datë 14.1.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri 300 kwh në muaj”;

VKM nr. 617, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore”, i ndryshuar;

VKM nr. 425, datë 27.6.2012 “Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesjes shoqërore”, i ndryshuar;

VKM nr. 31, datë 20.1.2001“Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar;

VKM nr. 248, datë 30.4.2014 “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”;

VKM nr. 48, datë 16.1.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi”, i ndryshuar me VKM nr. 192, datë 2.4.2014;

VKM nr. 27, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”, i ndryshuar me VKM nr. 189, datë 2.4.2014, ku përfitojnë femrat punëkërkuese të papuna me aftësi të kufizuara.

b) Institucionet përgjegjëse për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

1. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar

20. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) është organ këshillimor, i ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 12, datë 9.2.2015 bazuar në ligjin për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Ai kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, aktualisht nga Ministri i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), ka në përbërje të tij 17 anëtarë, nga të cilët 7 anëtarë janë individë me aftësi të kufizuara, 5 anëtarë janë përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara, 2 anëtarë janë përfaqësues të organizatave që merren me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit bëhet duke i kushtuar vëmendjen e duhur gjithëpërfshirjes së kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar, moshës dhe gjinisë. Personat me aftësi të kufizuara përfaqësohen në nivelet më të larta shtetërore për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre.

21. Roli i KKAK-së është të këshillojë Qeverinë për përcaktimin e politikave shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë, përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat. KKAK vlerëson gjendjen konkrete të personave me aftësi të kufizuara, rekomandon shërbime, programe specifikisht të orientuara për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, bën propozime, rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. KKAK jep rekomandime për ndërtimin e mekanizmave të mbledhjes së statistikave, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave, institucionet e tjera shtetërore dhe mbikëqyr mbledhjen, përpunimin e tyre. Evidentohet se KKAK ende nuk ka filluar të ushtrojë aktivitetin e tij për shkak se nuk ka përfunduar faza e përzgjedhjes së kandidatëve që do të jenë pjesë e tij.

2. Nëpunësi përgjegjës i çështjeve të aftësisë së kufizuar

22. Është parashikuar që në të gjitha ministritë dhe njësitë vendore të caktohet një nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar. Këta nëpunës do të caktohen me qëllim bashkërendimin e veprimtarive për problemet e personave me aftësi të kufizuara. Ata do të kenë kanë formim, njohuri të posaçme në fushën e aftësisë së kufizuar, do të kenë për detyrë të monitorojnë që politikat dhe programet të hartohen dhe të zbatohen në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni për aksesueshmërinë dhe përfshirjen, duke siguruar mundësi të barabarta për personat me aftësi të kufizuara. Ky parashikim ligjor ende nuk është vënë në zbatim.

3. Organizatat jofitimprurëse me të drejtë për t’u konsultuar

23. Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë parashikon se subjektet, që marrin pjesë në procesin e konsultimit publik, për çështjet e aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik, janë: a) individë

me aftësi të kufizuara; b) organizatat e personave me aftësi të kufizuara; c) organizatat për personat me aftësi të kufizuara; ç) organizatat që përfaqësohen në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

c) Politikat dhe strategjitë për personat me aftësi të kufizuara

24. Vizioni i Shqipërisë për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara është jetësuar në Strategjinë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara e miratuar në vitin 2005[19] (2005-2015). Qëllimi i saj është përmirësimi i statusit dhe cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, në përputhje me standardet e OKB-së mbi mundësitë e barabarta. Strategjia përmban një Plan Kombëtar Veprimi me 95 masa, përcakton afatet përkatëse kohore, institucionet përgjegjëse.

25. Dokumenti politik që adreson të drejtat e personave me aftësi të kufizuar është Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020, e cila është në proces hartimi nga MMSR. Personat me aftësi të kufizuara janë një prej kategorive të personave që marrin përfitime nga skemat e mbrojtjes sociale. Në të parashikohet mënjanimi i institucionalizimit dhe shndërrimi i institucioneve rezidenciale në modele shtëpi-familje ose shërbime komunitare. Gjithashtu, parashikohet që fëmijët me aftësi të kufizuara në institucione rezidenciale, në një të ardhme të afërt, të zhvendosen në familje kujdestarie të përkohshme.

26. Strategjia për përfshirjen sociale (2015-2020), e cila është në proces hartimi parashikon t'u mundësojë të gjithë individëve aksesin e pakufizuar në shërbimet publike, për të lehtësuar, mbështetur pjesëmarrjen e tyre aktive në shoqëri, pavarësisht nivelit të të ardhurave, gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, origjinës etnike, orientimit dhe identitetit seksual, vendit të banimit ose bindjeve fetare. Njëkohësisht, synon të garantojë që politikat dhe programet sektoriale për punësimin, arsimin, shëndetësinë, strehimin dhe drejtësinë të jenë gjithëpërfshirëse për personat që vuajnë përjashtimin social, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, si dhe u jep përparësi këtyre personave për aksesin në shërbimet publike.

27. Dokumente strategjike që trajtojnë të drejta të veçanta të personave me aftësi të kufizuara, apo grupe specifike të personave me aftësi të kufizuara janë:

- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (2014 -2020);
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje (2011-2015 (e rishikuar).

d) Integrimi i përkufizimeve kryesore të Konventës

Përkufizimi i koncepteve “aftësi e kufizuar”, “dëmtim afatgjatë, “përshtatje e arsyeshme”.

28. Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” nuk përkufizon aftësinë e kufizuar si të tillë, por përkufizon “personat me aftësi të kufizuara”, konkretisht individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale, ndijore, dëmtime që, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë, efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

29. Termi “*dëmtim afatgjatë*” nuk është i përcaktuar në legjislacion, por një rregullore e përbashkët e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe e Ministrisë së Shëndetësisë[20], parashikon diagnozat/nozologjitë e sëmundjeve, mbi bazën e të cilave vlerësohet dhe përcaktohet aftësia e kufizuar nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Por, pavarësisht kësaj, në Shqipëri nuk ka një prag të përcaktimit të aftësisë së kufizuar dhe nuk është zgjidhur ende konfuzioni i termit “*dëmtim afatgjatë*. Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara përcakton se personat me aftësi të kufizuara janë ata persona tek të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor, gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen për më shumë se 6 muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse, që sjell për pasojë kufizime të pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore. Kjo i referohet përkufizimit të OBSH-së, ndërkohë që në Shqipëri kjo ka ngelur si praktikë nga invalidët e punës, të cilët duhet të marrin paaftësi të përkohshme (sipas përkufizimeve aktuale ligjore) dhe më pas mund të

[19] VKM nr. 8, datë 7.1.2005“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara”.

[20] Urdhri nr. 362, datë 26.02.2007 “Për miratimin e rregullores për kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar”.

kualifikohen për t'u shqyrtuar në KMCAP EPROR. Kjo nuk vlen për personat me aftësi të kufizuara që trajtohen nga ligji për shërbimet shoqërore dhe ndihmën ekonomike. Përkufizimi në strategji nuk sjell pasoja ligjore në realitet.

30. Termi *"Përshtatje e arsyeshme"* përkufizohet në nenin 3 të ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, si "modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme, pa vendosur barrë të tepruar, për t'u garantuar personave me aftësi të kufizuara gëzimin, ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave, lirive themelore të njeriut". "*Mohimi i përshtatjes së arsyeshme*" përkufizohet si formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat, liritë themelore të njeriut[21].

31. Një vendim[22] i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë i vitit 2013 hedh më shumë dritë mbi përkufizimin e përshtatjes së arsyeshme dhe mohimit të saj si formë diskriminimi. Më konkretisht, në këtë çështje, Shoqata e të Verbërve dhe Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuara[23] i kërkoi Gjykatës që të deklaronte si të papajtueshme me Kushtetutën dhe me Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK), me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kartën Sociale Evropiane, një dispozitë[24] (neni 3 pika 7) të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Kjo dispozitë lidhet me përkufizimin e mohimit të përshtatjes së arsyeshme. Sipas kërkuesve, shprehja *"barrë të tepruar"* sipas nenit 3, pika 7 të ligjit, i përkufizon në mënyrë të qartë veprimet e shtetit si një barrë për akomodimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Gjykata, në vlerësimin e ekzistencën së diskriminimit që mund të përmbajë shprehja "barrë e tepruar", për personat me aftësi të kufizuara, krahasuar me kategoritë e tjera, subjekte të ligjit, u shpreh edhe për konceptin ligjor "*përshtatje e arsyeshme*", brenda të cilit është përdorur shprehja "barrë e tepruar". Gjykata konstatoi se termi "përshtatje e arsyeshme" është zbërthyer nga neni 2 i KDPAK-ut, sipas të cilit "përshtatje e arsyeshme" do të thotë modifikim i nevojshëm, i duhur apo përshtatje që nuk imponon *barrë disproporcionale ose të tepruar*, në një çështje specifike, me qëllim për t'i siguruar personit me aftësi të kufizuara, gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore mbi baza barazie, njësoj si të tjerët[25]. Ajo iu referua edhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që është shprehur për konceptin "përshtatje e arsyeshme". Sipas kësaj Gjykate, trajtimi i diferencuar mund të jetë i pajustifikuar, kur nuk bëhen përshtatje të arsyeshme, në mënyrë që të drejtat themelore të kufizohen më pak, por edhe qëllimi i ligjvënësit të arrihet[26].Gjykata iu referua edhe direktivës 2000/78, të Këshillit Evropian, "Mbi krijimin e kuadrit rregullator për trajtim të barabartë në marrëdhëniet e punësimit"[27].

32. Sipas vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, nga një vështrim i përgjithshëm i Konventës, por edhe të legjislacioneve evropiane, rezulton se një dështim apo mohim për t'i ofruar një personi me aftësi të kufizuara një përshtatje të arsyeshme, do të krijonte dhe do të konsiderohej diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar. Përshtatja ka kufizimet e veta, prandaj dhe legjislacionet kanë huazuar

[21]Të njëjtin përkufizim për "mohimin e përshtatshëm" e jep edhe ligji për mosdiskriminimin.

[22]Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 48 datë 15.11.2013.

[23]Koalicion organizatash në fushën e aftësisë së kufizuar.

[24]Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", në nenin 3 përkufizon kuptimin e disa termave të përdorura në këtë ligj. "*Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme*" është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një *barrë të tepruar*, me qëllim që të sigurohet gëzimi, ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave, lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e "*Organizatat me interesa legjitime*" janë ato organizata, të regjistruara në RSH-së, kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe ofrimin e ndihmës, viktimave të diskriminimit.

[25]Paragrafi 21 i vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 48/2013

[26]*Glor kundër Zvicrës,* aplikimi nr. 13444/04, vendim i datës 6.11.2009, perifrazim prg. 94-97

[27]Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 48/2013, paragrafët 20-22

termin "e arsyeshme". Nëse përshtatja do të vendosë barrë të tepruar apo disproporcionale për atë që ka detyrimin ta kryejë përshtatjen, atëherë mosrealizimi i "përshtatjes së arsyeshme" nuk do të konsiderohej diskriminim. Në këtë kontekst, edhe ligji për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon në nenin 5/2 se: "Mohimi i modifikimeve dhe përshtatjeve të duhura e të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara përbën diskriminim"[28].

33. Si përfundim, Gjykata çmoi se detyrimi për "përshtatjen e arsyeshme", vetëm ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, është një diferencim kushtetues (i përligjur dhe objektiv), në funksion të garantimit të zbatimit të parimit të barazisë ndaj kësaj kategorie. Termi "barrë e tepruar" është parashikuar në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi" në përputhje me konceptin e ofruar nga KDPAK-u, në kuadrin e parimit të proporcionalitetit, balancimit të interesave të kryqëzuara të personave me aftësi të kufizuara dhe entiteteve publike, private, që duhet t'u garantojnë përshtatje të arsyeshme. Gjykata më tej sqaron se termi "barrë e tepruar" ka gjetur vend dhe në fushën e të mirave dhe shërbimeve dhe ku qartësisht del kuptimi i këtij termi, si barrë, që nuk duhet të jetë e shpërpjesëtuar *(e tepruar)* për personin që ofron të mirat apo shërbimet dhe ka detyrimin të bëjë përshtatjet e duhura dhe të nevojshme[29].

c) Analiza e përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm me Konventën

34. Shqipëria ka realizuar analizën e përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm me Konventën. Ndalimi i diskriminimit në të gjitha fushat përkatëse, përbën "detyrimet ligjore minimale bazë"[30]. Institucionet shqiptare vlerësojnë se të gjitha masat që lidhen me mosdiskriminimin sipas Konventës duhet të zbatohen në mënyrë të menjëhershme. Mes detyrimeve kryesore ligjore, të cilat duhet të përmbushen brenda parimit të realizimit të detyrimeve progresive përfshihen masa administrative, financiare, arsimore dhe sociale.

d) Sfidat kryesore

35. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit trajtohet gjerësisht nga Kushtetuta dhe kuadri ligjor, por sfida e zbatimit të KDPAK-së lidhet kryesisht me zbatimin e ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë dhe ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

36. Liria për të bërë zgjedhjet vetjake mbetet ende një çështje, e cila duhet të pasqyrohet me forcë në legjislacionin shqiptar – një fushë ku do të duhet të bëhen ndryshime gjithëpërshkuese për të siguruar përputhjen me KDPAK-në, veçanërisht me qëllimin për të eliminuar kujdestarinë ligjore dhe vendosjen e sistemit të vendimmarrjes së mbështetur, dhe për të vazhduar përpjekjet për deinstitucionalizimin e personave me aftësi të kufizuara.

37. Parimi i arsimit gjithëpërfshirës, ndonëse është pranuar gjerësisht në të gjitha nivelet e institucioneve arsimore dhe është bërë pjesë e legjislacionit shqiptar në fushën e arsimit, ende zbatimi i tij në praktikë has shumë pengesa. Transformimi i shkollave në mjedise gjithëpërfshirëse kërkon veprime shumëplanëshe dhe është një proces që varet prej mbështetjes së shoqërisë, reformës kurrikulare, organizimit shkollor, trajnimit të mësuesve dhe ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara. Parimi i aksesueshmërisë po përfshihet gjithnjë e më shumë në legjislacionin shqiptar, por ka rëndësi që ky parim të zbatohet në të gjitha fushat dhe politikat dhe në të gjitha dimensionet e tij.

38. Kalimi në modelin bio-psiko-social. Në kuadër të projektit të Bankës Botërore "Modernizimi i Asistencës Sociale" , në vitin 2014 ka nisur procesi për reformimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri, që përfshin: a) rishkrimin e kritereve ekzistuese të vlerësimit dhe përcaktimit të aftësisë së kufizuar; b)

---

[28]Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 48/2013, paragrafi 22.

[29] Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon: Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave, shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një *barrë të shpërpjesëtuar* ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet. Në zbatim të vlerësimeve të mësipërme të saj, Gjykata konkludoi se pika 7 e nenit 3 të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, nuk bie në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës për shkak të termit "barrë e tepruar".

[30]KDESHK, Komenti i Përgjithshëm nr. 3, Karakteri i Detyrimeve të Shteteve Palë.

krijimin e procesit të ri multidisiplinor për përcaktimin e aftësisë së kufizuar; c) krijimin e strukturave të Vlerësimit dhe Përcaktimit të Aftësisë së Kufizuar; d) reformimin e përfitimeve për skemën jo-kontributive dhe kriteret e përfitimit; e) dixhitalizimin e informacionit dhe komunikimit; ë) hartimin e kuadrit të ri ligjor.

39. Institucionet shqiptare po punojnë për rishikimin e kritereve mjekësore aktuale të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, përshkrimin më të detajuar për secilën gjendje mjekësore që sjell aftësinë e kufizuar të strukturave trupore, shoqëruar kjo me përshkrimin e impaktit në funksionet e trupit, në pjesëmarrjen në aktivitetet e jetës së përditshme dhe në barrierat mjedisore, për të krijuar uniformitet dhe konsistencë në procesin e vlerësimit dhe të përcaktimit të aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, do të shtohen diagnozat shëndetësore që shkaktojnë aftësi të kufizuara të munguara në kriteret ekzistuese dhe do të hiqen prej tyre diagnozat, që nuk konsiderohen më si shkaktare të gjendjeve të aftësisë së kufizuar. Do të vijohet me hartimin e udhëzuesve të vlerësimit bio-psiko social të aftësisë së kufizuar për fëmijë e të rritur për të mundësuar vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar të bazuar në modelin konceptual të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH).

II. TË DREJTAT SPECIFIKE

Neni 5 – Barazia dhe mosdiskriminimi

40. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit garantohen në nenin 18 të Kushtetutës. Sipas këtij neni, të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe, të tilla si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare, filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive. Ndonëse Kushtetuta nuk e përmban specifikisht aftësinë e kufizuar si shkak diskriminimi në listën e shkaqeve, mosdiskriminimi formulohet në formën e një ndalimi të përgjithshëm dhe lista e shkaqeve është ilustruese dhe jo shterruese. Termi "askush" përfshin edhe personat me aftësi të kufizuara.

41. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, ndër të tjera dhe specifikisht edhe për shkak të aftësisë së kufizuar. Ligji përcakton se çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në aftësinë e kufizuar, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi, përbën diskriminim. Ligji parashikon disa forma diskriminimi, si: diskriminimi i drejtpërdrejtë, diskriminimi i tërthortë, diskriminimi për shkak të shoqërimit, shqetësimit, udhëzimit për të diskriminuar, viktimizimi dhe mohimit të përshtatjes së arsyeshme.

42. Parimi i mosdiskriminimit përfshihet edhe në parimet e ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Ligji përkufizon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara si çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen të pamundur të ushtrimit, njëlloj si të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH-së dhe legjislacioni në fuqi.

43. Kodi i Punës ndalon çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit. Në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Punës" parashikohet: 1. ndalimi i çdo formë diskriminimi në fushën e punësimit dhe të profesionit. 2. Me "diskriminim" kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim apo parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare, martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, përkatësinë në një grup të veçantë, ose çdo shkak tjetër që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të së drejtës për punësim dhe profesion. 3. Të gjitha format e diskriminimit, në kuptim të pikës 2, të këtij neni, nënkuptojnë të gjitha format që parashikohen nga ligji specifik për mbrojtjen nga diskriminimi. 4. Ndalimi i diskriminimit, i përcaktuar nga ky ligj,

nuk zbatohet nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive. 5. Dallimet, kufizimet, përjashtimet ose parapëlqimet, që bazohen në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë diskriminim kur, për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj.

Mekanizmat zbatues dhe monitorues të parimit të mosdiskriminimit dhe barazisë

44. Monitorimi dhe zbatimi i parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit realizohet nga:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)[31] është institucion i pavarur, i cili shqyrton dhe vendos për ankesat individuale për diskriminim. Ai bën sondazhe, publikon raporte dhe rekomandime, përfshi rekomandime legjislative, kryen aktivitete ndërgjegjësuese për parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Gjithashtu, Komisioneri mund të bëjë hetime *ex officio* në rast se ka informacione për sjellje apo veprime diskriminuese ndaj personave të akomoduar në institucion. Komisioneri, në rast se gjen shkelje, mund të vendosë gjoba[32].

Gjykatat. Ligji parashikon të drejtën e ankimit në gjykatë për rastet e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar përfshi edhe "mohimin e përshtatjes së arsyeshme" (mohimin e një akomodimi të arsyeshëm), si një nga format e diskriminimit që parashikon ligji. Një individ që pretendon se është diskriminuar mund t'i drejtohet gjykatës për dëmshpërblim.

Avokati i Popullit është institucion i pavarur, i cili, ndër të tjera, kryen inspektime në institucionet e përkujdesit shoqëror, për të monitoruar e vlerësuar realizimin e të drejtave ligjore të individëve të akomoduar në këto institucione. Më pas përgatit rekomandime të cilat ia dërgon institucioneve shtetërore të linjës (qendrore dhe vendore). Një nga komisionerët e Avokatit të Popullit është person me aftësi të kufizuara.

[31]Bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"

[32] Informacion i detajuar jepet në komentet për nenin 33 të KDPAK

Inspektorati i Shërbimeve Shoqërore, pjesë e MMSR-së, me anë të inspektimeve periodike konstaton nëse plotësohen kushtet bazë për jetesë normale në përputhje me Standardet e Shërbimeve Shoqërore[33] dhe Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për personat me aftësi të kufizuara[34].

Drejtoria e Monitorimit në Shërbimin Social Shtetëror, bën monitorim të standardeve të shërbimeve shoqërore për personat me aftësi të kufizuara.

Masa të veçanta

45. Autoritetet shqiptare kanë marrë masa të veçanta për të adresuar pabarazitë që krijohen në realitet, ndaj personave me aftësi të kufizuara. Këto masa e gjejnë shprehjen e tyre: i) në ligjin për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara; ii) në ligjet që rregullojnë statuset e veçantë të grupeve të personave me aftësi të kufizuara, si të verbrit, tetraplegjikët, paraplegjikët; iii) politikat për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

46. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi (neni 11), parashikohet se masat e përkohshme e të veçanta që synojnë përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të mbrojtur nga ligji, përfshirë këtu edhe aftësinë e kufizuar", konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim. Kjo masë duhet të ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

Masat e veçanta në fushën e mbrojtjes sociale

47. Programi i mbrojtjes sociale përfshin ndihmën ekonomike për familjet dhe individët në nevojë, pagesat e aftësisë së kufizuar dhe shërbimet shoqërore për fëmijët, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë, vajzat në nevojë, si dhe personave në rrezik, të bëjnë pjesë në grupet në nevojë. Numri i përfituesve (personave me aftësi të kufizuara dhe kujdestarëve) nga programi i mbrojtjes sociale është 162.350, si më poshtë[35]:

[33]VKM nr. 658, datë 17.10.2005 "Për standardet e shërbimeve shoqërore".

[34]VKM nr. 822, datë 06.12.2006 "Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar

[35]Referuar statistikave të Shërbimit Social Shtetëror

Të verbër	12,248 persona
Paraplegjikë dhe tetraplegjikë	6,350 persona
Persona me aftësi të kufizuara mendor e fizike	50,545 persona
Invalidë pune	74,373 persona
Nr. i kujdestarëve	18,834 persona

48. Sipas të dhënave statistikore të Shërbimit Social Shtetëror rezultojnë të jenë 6,553 familje[36] në ndihmë ekonomike që në përbërje të tyre kanë anëtarë me aftësi të kufizuara, që nuk u përllogariten të ardhurat e personave me aftësi të kufizuara për efekt të përfitimit të ndihmës ekonomike.

49. Personat me aftësi të kufizuara, përveç përfitimeve që marrin bazuar në ligjin "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" (pagesat e aftësisë së kufizuar dhe shërbime të përkujdesit shoqëror), përfitojnë disa të drejta edhe në bazë të statuseve të tyre sipas: a) ligjit për statusin e të verbrit[37]; b) ligjit për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik; c) ligjit për statusin e invalidit të punës. Përfitimet për këto kategori personash janë si vijon:

Të verbrit përfitojnë:

a) Pagesë prej 11,25038 lekë në muaj dhe po të njëjtën masë përfitimi edhe për kujdestarinë.

b) Të verbrit që arsimohen[39] mbështeten me pagesë shtesë: i) gjatë periudhës që kryejnë arsimin e mesëm apo kurse kualifikimi të verbrit përfitojnë 200% të masës së pagesës; ii) gjatë periudhës që kryejnë arsimin e lartë, kualifikime pas universitare, përfitojnë 300% të masës së pagesës; iii) të verbrit që kanë tituj apo grada shkencore përfitojnë 300% të pagesës gjatë gjithë jetës.

c) Ata që kanë humbur vendin e punës për arsye të ndryshme pas 1 janarit të vitit 1991, përfitojnë 150% të vlerës së masës së pagesës deri në sistemimin e tyre në punë.

d) Kompensim financiar[40] për faturën e energjisë elektrike në masën 2000 lekë në muaj të verbrit që kanë nevojë për kujdestarë dhe në masën 1400 lekë në muaj të verbrit që nuk kanë nevojë për kujdestarë. Ndërsa masa e kompensimit për faturën e telefonisë fikse është 1000 lekë në muaj për të gjithë të verbrit. Kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 KwH, në muaj në masën 648 lekë[41] në muaj.

e) Të drejtën e rimbursimit për ilaçet, siguracion shëndetësor falas;

f) Punësim sipas ligjit "Për nxitjen e punësimit" dhe stimulimin e biznesit për të punësuar të verbrit;

g) Strehim sipas ligjit për strehimin; etj.

Paraplegjikët dhe tetraplegjikët përfitojnë:

a) Pagesa[42] për aftësinë e kufizuar në masën 9.900 lekë në muaj dhe për kujdestarin 10.400 lekë në muaj[43].

b) Periudha e shërbimit të kujdestarisë, për invalidin paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si edhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni, barrëlindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale, dhe sigurimi shëndetësor[44].

c) Mbështetja me pagesë shtesë[45] gjatë kohës që kryejnë arsimin e mesëm apo kurse kualifikimi në masën 200% të pagesës te pika "a" më lart; gjatë periudhës që kryejnë arsimin e lartë dhe kualifikime pasuniversitare, përfitojnë 300% të pagesës; dhe nëse kanë tituj apo grada shkencore përfitojnë 300% të pagesës gjatë gjithë jetës së tyre.

d) Rimbursim të ilaçeve dhe sigurim shëndetësor falas;

---

[36]Referuar statistikave të Shërbimit Social Shtetëror për periudhën shtator-tetor 2014

[37]Ligji nr. 8098, datë 28.3.1996, i ndryshuar

[38] Udhëzim nr. 14, datë 29.9.2014 "Mbi zbatimin e VKM nr. 277, datë 18.6.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit"", të ndryshuar. Pagesat indeksohen për çdo vit në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

[39]VKM nr. 277, datë 18.6.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar.

[40]VKM nr. 404, datë 20.6.2012 "Për përcaktimin e masës, të kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse".

[41]VKM nr. 8, datë 14.1.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri ne 300 kwh në muaj"

[42]Udhëzim nr. 12, datë 29.9.2014 "Mbi zbatimin e VKM nr. 31, datë 20.1.2001, "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik"".

[43]Këto pagesa indeksohen për çdo vit në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

[44]VKM nr. 328, datë 12.3.2009 "Për disa shtesa në VKM nr. 618, datë 7.9.2006, "Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar"", të ndryshuar.

[45]VKM nr. 618, datë 7.9.2006, "Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit, masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar.

e) Strehim me përparësi dhe sipas kuotave të ligjit për strehimin;

f) Punësim sipas ligjit "Për nxitjen e punësimit" dhe lehtësi për bizneset për çdo të punësuar;

g) Përjashtim nga taksat e drejtpërdrejta;

h) Përjashtim nga taksat doganore për automjetet që paraplegjikët dhe tetraplegjikët i përdorin për lëvizje;

i) Dhënie falas të mjeteve mbështetëse për lëvizje (karrige, paterica etj.).

j) Kompensim për faturën e energjisë elektrike në masën 2000 lekë në muaj për ata që kanë nevojë për kujdestarë dhe në masën 1400 lekë në muaj për ata që nuk kanë nevojë për kujdestarë. Ndërsa masa e kompensimit për faturën e telefonisë fikse është 1000 lekë në muaj. Kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 KWH, në muaj në masën 648 lekë në muaj.

k) Pagesë për blerjen e artikujve higjieno-sanitare[46], në masën 16.000 lekë në muaj;

Pagesë për karburantin[47] e automjeteve për lëvizjen e paraplegjikëve, tetraplegjikëve invalidë pune, në masën 7.000 lekë në muaj.

Invalidët e punës përfitojnë:

a) kompensimin e rritjes së çmimit të energjisë elektrike (350 lekë në muaj nga skema e sigurimeve shoqërore ose 700 lekë në muaj kur janë persona të vetmuar dhe 640 lekë[48] në muaj nga programi i mbrojtjes sociale), si edhe kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 KwH, në muaj në masën 648 lekë në muaj.

b) invalidët që kanë mjete lëvizëse marrin 7.000 lekë në muaj për rimbursim të karburantit;

c) rimbursim të trajtimit mjekësor 100 % për invalidët e plotë dhe 50% për invalidët e pjesshëm;

d) përjashtim nga taksat direkte dhe doganore për pajisje të ndryshme rehabilituese, duke përfshirë automjetet, etj.

e) përfitojnë mbi pensionin e invaliditetit apo të pleqërisë edhe një shtesë për aftësinë e tyre të kufizuar e cila është e diferencuar[49]sipas shkallës së invaliditetit. Personat që përfitojnë pension invaliditeti të plotë dhe që vuajnë nga sëmundje të përgjithshme mbështeten me një pagesë shtesë në masën 3.300 lekë në muaj. Personat që përfitojnë pension invaliditeti të pjesshëm dhe që vuajnë nga sëmundje të përgjithshme mbështeten me një pagesë shtesë në masën 2.200 lekë në muaj;

f) personat që përfitojnë pension invaliditeti të plotë nga aksidentet në punë, sëmundjet profesionale mbështeten me një pagesë shtesë në masën 4.000 lekë në muaj;

g) personat që përfitojnë pension invaliditeti të pjesshëm nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale mbështeten me një pagesë shtesë në masën 2.700 lekë në muaj.

Personat me aftësi të kufizuara mendore, fizike përfitojnë:

a) pagesën prej 9.900 lekë në muaj[50] dhe të njëjtën masë pagese përfitojnë edhe kujdestarët e tyre. Këto pagesa indeksohen për çdo vit në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

b) mbështetje me pagesë shtesë gjatë periudhës që kryejnë arsimin e mesëm ose kurse kualifikimi përfitojnë 200% të pagesës; gjatë periudhës që kryejnë arsimin e lartë dhe kualifikime pas universitare, përfitojnë 300% të pagesës; nëse kanë tituj apo grada shkencore përfitojnë 300% të pagesës gjatë gjithë jetës së tyre.

c) Kompensim të energjisë elektrike në masën 640 lekë në muaj, si edhe kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 KwH, në muaj në masën 648 lekë në muaj. Pagesat e aftësisë së kufizuar nuk përfshihen në llogaritjen e të ardhurave të familjes për efekt të përfitimit të ndihmës ekonomike. Edhe në zonat ku po pilotohet skema e re e ndihmës ekonomike (Tiranë, Durrës, Elbasan), familjet në nevojë, të cilat kanë si

[46]VKM nr. 327, datë 12.03.2009 "Për një ndryshim në VKM nr. 78, datë 04.02.2007 "Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë", të ndryshuar.

[47]VKM nr. 1962, datë 17.12.2008 "Për një ndryshim në VKM nr. 723, datë 19.11.1998, Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit të punës"", të ndryshuar.

[48]VKM nr. 565, datë 9.8.2006 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit te energjise elektrike", të ndryshuar

[49]Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 869, datë 18.6.2008 "Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit"".

[50]Udhëzim nr. 13, datë 29.9.2014 "Mbi zbatimin e VKM nr. 618, datë 7.9.2006, "Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar"", të ndryshuar

kryefamiljar një person me aftësi të kufizuara, fizike e mendore, i verbër, paraplegjik/tetraplegjik ose invalid pune dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij janë fëmijë ose persona mbi moshë pune, që nuk përfitojnë pension, përjashtohen nga llogaritja e të ardhurave (vlerësimi në koeficient i të ardhurave).

50. Skema e re e ndihmës ekonomike, në zonat e pilotimit, është më e lehtë për t'u përfituar për disa arsye:

- Thjeshtëzimi i dokumentacionit, pasi kërkohet dokumentacioni për përbërjen e familjes, pronave dhe pasurive në zotërim;
- Krijimi i regjistrit elektronik që lidh në kohë reale administratorin shoqëror, sekretarin e këshillave të njësive të pushtetit lokal dhe Shërbimin Social Shtetëror;
- Kontrolli i kryqëzuar i informacionit nga ana e Shërbimit Social Shtetëror me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, gjykatat etj.
- Paraqitja në zyrat e administratorëve shoqërorë çdo tre muaj (nga afati i shpeshtë një herë në muaj).

Masa të veçanta në fushën e punësimit

51. Për të nxitur punësimin e personave me aftësi të kufizuara është parashikuar që, personat që punësohen mund të përfitojnë edhe pagesat e aftësisë së kufizuar, që jepen nga buxheti i shtetit krahas pagës deri në 24 muaj punësim, moment ky në të cilin ndërpritet pagesa e aftësisë së kufizuar[51]. Pavarësisht të gjitha këtyre masave, aktualisht personave që nuk dëgjojnë iu refuzohet pajisja me leje drejtimi i të gjitha kategorive dhe ofrimi i shërbimit të interpretimit në gjuhën e shenjave gjatë testit teorik.

Neni 8 – Rritja e ndërgjegjësimit

52. Shqipëria ka ndërmarrë politika sensibilizuese efektive për promovimin e një imazhi pozitiv të personave me aftësi të kufizuara. Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara parashikon një dispozitë të veçantë (neni 18) kushtuar imazhit publik dhe ndërgjegjësimit. Media publike dhe private detyrohet me ligj që të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet imazheve që theksojnë mosdiskriminimin, e autonominë e personave me aftësi të kufizuara.

53. Në programet informative të operatorëve kombëtare, si Televizioni Shqiptar, Televizioni KLAN, Top Channel, Radio Tirana, Top Albania Radio ka pasur informacione në formën e lajmeve, kronikave, intervistave, reportazheve etj., për të pasqyruar problematikën e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, duke evidentuar ato që janë prioritare dhe të ngutshme për zgjidhje nga autoritetet. Pavarësisht kësaj, ende në mediat publike, private personat me aftësi të kufizuara përqasen nëpërmjet modelit të bamirësisë dhe mëshirës, ose paraqiten si persona me probleme te shëndetit mendor, që janë të rrezikshëm.

54. Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS), në bashkëpunim me organizata joqeveritare që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar, ka marrë masa për informimin e publikut, personave me aftësitë kufizuara, familjarëve të tyre, për ndryshimet më të fundit ligjore për arsimim cilësor për personat me aftësi të kufizuara. Gjatë javës globale për "Arsimin dhe fëmijët me aftësi të kufizuara", në vitin 2014, u organizuan një sërë aktivitetesh në qytete të ndryshme të Shqipërisë për ndërgjegjësimin e opinionit publik për të drejtat e këtij grupi të shoqërisë.

55. Seminare ndërgjegjësuese janë organizuar në qytetet Shkodër, Vlorë, Elbasan dhe Tiranë, mbi "Diskriminimin në fushën e arsimit" nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), me mbështetjen e *Civil Rights Defenders*. Një spot televiziv për të rritur ndërgjegjësimin e opinionit publik për ligjin dhe kompetencat e Komisionerit është përgatitur në kuadër të projektit të OSBE-ODIHR "Praktikat më të mira për integrimin e romëve", transmetuar në shkurt 2013 në dy televizione kombëtare.

56. MMSR me mbështetjen e projektit të PNUD-it, "Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për përfshirjen sociale në Shqipëri", me financimin e Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim (SDC) zhvilloi në Berat, Kuçovë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Pogradec, trajnime ndërgjegjësuese me përfaqësues të qeverisjes vendore për forcimin e kapaciteteve të strukturave vendore për integrimin e çështjeve të aftësisë së kufizuar në politikat, planet, programet

[51] Referim i informacionit në vijim për nenin 27: Puna dhe punësimi.

dhe buxhetet e qeverisjes vendore.

57. Gjatë vitit 2014, u realizua fushata e Komunikimit “Shqipëria Solidare”, dhe u zhvilluan takime të hapura me qytetarët, u shpërndanë broshura, fletëpalosje, postera në Tiranë, Durrës e Elbasan. Realizimi i këtyre aktivitete ka ndërgjegjësuar publikun për thelbin e reformës së ndihmës ekonomike, përfitues të së cilës janë edhe familjet e personave me aftësi të kufizuara, ndërmarrë në kuadër të projektit të Bankës Botërore “Modernizimi i asistencës sociale në Shqipëri”.

58. Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), në bashkëpunim me organizata jofitimprurëse (OJF), ka organizuar aktivitete ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese për komunitetin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si paraqitja e punimeve me dorë, pikturë, punë okupacionale, etj., të realizuara nga personat me aftësi të kufizuara etj.

59. Qeveria shqiptare ka vijuar përpjekjet për adresimin e steriotipeve gjinore duke sfiduar traditat e dëmshme që shkelin të drejtat e grave dhe vajzave (përfshirë dhe të drejtat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, të cilat përjetojnë diskriminim të shumëfishtë), nëpërmjet fushatave dhe aktiviteteve që organizohen, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Grave në 8 mars, si edhe të Fushatës mbarëbotërore të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Këto fushata organizohen në bashkëpunim me OJF-të, pushtetin vendor dhe organizatat ndërkombëtare (sidomos të OKB).

60. Një koncert i veçantë bamirësie dedikuar të verbërve u organizua për herë të parë në Shqipëri në vitin 2014 me mbështetjen e Fondacionit Vodafone Albania. E veçanta e kësaj mbrëmjeje ishte se gjithçka organizohej në errësirë. Mbrëmja u organizua nën moton “Të ndjejmë botën përmes zërit”. Për dy orë të pranishmit darkuan në errësirë të plotë dhe dëgjuan interpretimet e artistëve më në zë të skenës. Për një natë, përfaqësues të bizneseve, artistë, politikanë etj., e kanë vënë veten në vendin e njerëzve që nuk shikojnë. Kontributet e mbledhura nga Fondacioni Vodafone Albania do të mundësojnë programimin për leximin e kompjuterit në shqip *via audio* për personat me probleme në shikim në Shqipëri dhe viset shqipfolëse.

61. Avokati i Popullit, në bashkëpunim me shoqërinë civile, ka përgatitur dhe shpërndarë postera, për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe ka organizuar ditë të hapura në qytete të ndryshme të Shqipërisë, për të rritur nivelin e informimit të opinionit publik rreth kuadrit ligjor që mbron dhe garanton të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Avokatit i Popullit në muajin dhjetor 2013, ka organizuar Konferencën për të Drejtat e Njeriut, ku një panel iu kushtua të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, me pjesëmarrje të gjerë nga organizatat jofitimprurëse që operojnë në këtë fushe, nga komunitetit i personave me aftësi të kufizuara, institucionet shtetërore etj.

Neni 9 – Heqja e barrierave

62. Shqipëria ka bërë progres për përmbushjen e detyrimit për të ndërmarrë masat e nevojshme që t’i garantojë personave me aftësi të kufizuara një jetë sa më të pavarur që të jetë e mundur dhe pjesëmarrje të plotë në të gjitha aspektet e jetës. Përmirësimi i aksesueshmërisë në godina, infrastrukturë, transport dhe komunikim është një prioritet i qeverisë shqiptare. Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara (neni 3) e përkufizon termin “Aksesueshmëri” si mënjanimi i pengesave (barrierave) të të gjitha llojeve. Ndërsa termi “Pengesa” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

63. Garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimit të pengesave të të gjitha llojeve është një nga parimet bazë të përfshira në legjislacion. Shqipëria do ta realizojë aksesueshmërinë përmes realizimit progresiv, duke marrë masa në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cenuar të drejtat e fituara, në përputhje me KDPAK[52]. Aksesueshmëria bën të mundur që

[52]Neni 4 i ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara

personat me aftësi të kufizuara të kryejnë detyrat dhe punët që kërkohen në punësim, arsimim dhe mjedise të tjera, duke i dhënë mundësi të barabarta me të tjerët për të marrë pjesë në çdo sferë të jetës. Sigurimi i zgjedhjeve dhe mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara, kërkon ndërtimin e rrjeteve të vendimmarrjes së mbështetur, për të mundësuar një shoqëri vërtetë të barabartë.

Aksesueshmëria fizike

64. Në bazë të ligjit për transportin rrugor (neni 85) kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi i personave me aftësi të kufizuara në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta. Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi, dokumentin që përcakton ligji për ta, por në praktikë hasen vështirësi, pasi një numër i kufizuar mjetesh transporti, janë të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara.

65. Kodi Rrugor parashikon se për qarkullimin dhe pushimin e mjeteve në shërbim të invalidëve, entet pronare të rrugës janë të detyruara të ndërtojnë, të mirëmbajnë strukturat përkatëse, si dhe sinjalizimin e nevojshëm për të lejuar e lehtësuar lëvizjen e tyre, por zbatimi i kësaj klauzole është në nivele tepër të ulëta. Në bazë të dispozitave[53] të përgjithshme të formateve të licencave për transportin qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës të udhëtarëve dhe certifikatave të autobusëve, janë përcaktuar detyrimet për shoqëritë transportuese, që të zbatojnë të gjitha lehtësirat për personat me aftësi të kufizuara, në bazë të ligjeve përkatëse. Por këto dispozita nuk monitorohen. Në vitin 2014 është miratuar rregullorja e posaçme "Për të drejtat e invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara lëvizëse kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit".

66. Për arritjen e përshtatshmërisë ndërtimore në objektet shtetërore u ngrit[54] grupi ndërministror për zbatimin e rregullave të përshtatshmërisë ndërtimore në institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore. Si rezultat, është kryer evidentimi i objekteve për nivelin e përshtatshmërisë ndërtimore[55]. Me koordinimin e MMSR-së u arrit të inspektoheshin për përshtatshmëri 70 ndërtesa publike dhe u konstatua se ka nivel të ulët përshtatshmërie, aksesueshmërie. Publiku nuk është i mirëinformuar për procedurat dhe dokumentacionin e përshtatshmërisë ndërtimore për aftësinë e kufizuar. Ka raste kur kryhen ndërhyrje me modele përshtatshmërie, që nuk janë brenda normave ndërtimore. Në përfundim të këtij procesi inspektimi u propozua një plan masash për ndërhyrje të mundshme dhe u bënë parashikime buxhetore të mundshme. Janë miratuar rregullat për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara kryesore për heqjen graduale të pengesave ekzistuese arkitektonike, urbanistike të transportit dhe parandalimin e shfaqjes së pengesave të reja. Por ende nuk janë përcaktuar mekanizmat kontrollues për zbatimin e këtyre rregullave.

Aksesueshmëria fizike në objekte publike

67. Qendrat publike të zhvillimit për personat me aftësi të kufizuara (qendrat rezidenciale) ofrojnë shërbime dhe i trajnojnë përfituesit për të qarkulluar në mjediset e brendshme dhe të jashtme të institucionit nën vëzhgimin apo mbikëqyrjen e kujdestarëve, edukatorëve dhe specialistëve. Kalimi në rrugë, orientimi me sinjalistikën rrugore realizohet nën kujdesin ose shoqërimin e personelit ose të prindërve. Disa nga përfituesit e shërbimeve në qendrat ditore me parametra më të avancuar kanë akses edhe në programe profesionale të mësimit të kompjuterëve, parukerisë, kopshtarisë, mekanikës.

68. Prej vitit 2004, në Tiranë, është zbatuar projekti "Një qytet pa barriera". Në vitin 2010 përfundoi së zbatuari një fazë e projektit : "Vende parkimi dhe kryqëzime për personat me aftësi të kufizuara". Ky projekt ka siguruar parkim për personat me aftësi të kufizuara në 35 pika në qytetin e Tiranës me rreth 52 poste parkimi. Ndërtimet e reja të shkollave, kopshteve, qendrave sociale janë planifikuar konform elementëve të përshtatshmërisë. Bashkia e Tiranës ka nisur një ndërhyrje rrënjësore në trotuaret e rrugëve të

[53]Udhëzimi nr. 20, datë 10.10.2007 "Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", i ndryshuar.

[54] Urdhri i Kryeministrit nr. 239, datë 11.12.2013.

[55]Ky projekt u mbështet nga PNUD dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

kryeqytetit. Synimi është përshtatja e trotuareve për të bërë të mundur aksesin në to të përdoruesve të karrigeve me rrota të invalidëve. Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë në Bashkinë e Tiranës konfirmon se 390 disheza (rampa) janë realizuar në trotuaret e kryeqytetit.

69. Në planin e veprimit të strategjisë lokale për rajonin e Durrësit, për personat me aftësi të kufizuara ka një fushë të veçantë për përshtshmërinë mjedisore me objektiva dhe masa konkrete për zbatim, e shoqëruar edhe me nje paketë projektesh konkrete, me vlerësim kostosh për ndërhyrje në objekte sociale ekzistuese. Bashkia Vlorë e ka bërë pjesë të Planit të Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban të qytetit të Vlorës problematikën e aftësisë së kufizuar. Bashkia Korçë ka vazhduar të përshtatë trotuaret e qytetit dhe hapësirat në ambientet çlodhëse.

70. Çdo ndërtim i ri spitalor apo qendër shëndetësore nuk miratohet nga Ministria e Shëndetësisë, nëse nuk zbaton rregulloren e urbanistikës për ndërtimin e lehtësirave për personat me aftësi të kufizuara. Parashikimi i fondeve për përshtatshmëri është i përfshirë në fondin e përgjithshëm të objekteve spitalore që po rikonsruktohen apo që po ndërtohen.

71. Sigurimi i sinjalistikës së përshtatur për persona me aftësi të kufizuara të të parit e të dëgjuarit është në fazat fillestare dhe ende nuk ka rezultate konkrete.

Akesueshmëria në komunikim

72. Një zhvillim i rëndësishëm ligjor për të rritur aksesueshmërinë në komunikimin dhe informacion është VKM për njohjen e gjuhës së shenjave[56]. Ky akt ka për qëllim njohjen e gjuhës së shenjave, për t'i ardhur në ndihmë komunitetit të njerëzve që nuk dëgjojnë në Shqipëri, në mënyrë që të kenë qasje në informacionet e ofruara nga institucionet e vendit, si edhe për të gëzuar të njëjtat të drejta sikurse qytetarët e tjerë. MMSR është autoriteti përgjegjës për koordinimin, vlerësimin dhe bashkërendimin e legjislacionit, politikave, e programeve në këtë fushë dhe për hartimin e një platforme veprimi.

73. Televizioni Publik Shqiptar (TVSH), prej vitit 2008, ka transmetuar çdo ditë në orën 13.00 një edicion emision informativ 10-minutësh, ku jepte "shpjegime me shenja" në një cep të ekranit, sipas standardeve ndërkombëtare, në ndihmë të njerëzve që kanë probleme me dëgjimin dhe të folurin[57].

Prodhimi i librave me zë dhe botimeve në brail

74. Shërbimi i botimeve në brail ofrohet nga Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë (Instituti) dhe nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, përmes Qendrës së saj Kombëtare të Rehabilitimit të Personave me Dëmtim të Shikimit (Qendra). Instituti prodhon për nevojat e nxënësve të tij 619 tekste në *brail*, për nxënësit me shikim të humbur dhe një sasi tekstesh me shkrim të zmadhuar për nxënësit me shikim të pjesshëm, por nuk arrin të plotësojë tërësisht nevojat që ka. Botimet realizohen me fonde shtetërore dhe nga donatorë të ndryshëm. Është e nevojshme të zgjerohet baza teknike me personel dhe të plotësohet me programe më bashkëkohore printimi. Qendra e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, e mbështetur pjesërisht me fonde të buxhetit të shtetit ka një koleksion librash, mes tyre tekste shkollore, letërsi artistike, materiale të përzgjedhura shkencore, si dhe një fonotekë librash në audiokasetë. Shoqata drejton edhe një shtypshkronjë, në të cilën përgatiten materiale në brail.

Neni 10 – E drejta e jetës

75. Legjislacioni shqiptar njeh dhe mbron të drejtën e jetës dhe mbijetesës së personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të barabartë me të tjerët. Nuk ka pasur raste që personat me aftësi të kufizuara të kenë qenë subjekt i privimit arbitrar të jetës.

Neni 11 – Situatat e rrezikut dhe emergjencat humanitare

76. Policia e Shtetit, në bashkëpunim me strukturat e tjera shtetërore të ngarkuara me ligj, në rastet e emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore, kanë prioritet të ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara duke bërë evakuimin e tyre dhe siguruar mjetet e nevojshme. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) e ka përfshirë çështjen e personave me aftësi të kufizuara në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Reduktimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe të Mbrojtjes Civile, si

[56] VKM nr. 837, datë 03.12.2014

[57] Por, ky program, prej të paktën 3 muajsh, nuk transmetohet nga TVSH-ja.

dhe të rishikimit të legjislacionit për emergjencat civile.

77. Qendrat publike të zhvillimit janë të pajisura në çdo kat me pajisje kundër zjarrit. Gjatë vitit 2014, personeli i institucioneve ka marrë informacionin e duhur për përdorimin e tyre dhe kryerjen e veprimeve që duhet të ndiqen nga punonjësit në rast rënie të zjarrit. Qendrat e zhvillimit kanë dalje në rast emergjence. Gjatë periudhës qershor-korrik 2014, në bashkëpunim me Drejtorinë e Emergjencave Civile në (MPB), është hartuar një plan veprimi për trajnimin, mbrojtjen, minimizimin nga rënia e zjarreve në ambientet e 8 qendrave publike të përkujdesit social në Tiranë. Plani u vu në zbatim dhe personeli u trajnua dhe mori udhëzime për të vepruar. Masat iu shpjeguan edhe përfituesve të këtyre qendrave.

Neni 12 - Njohja e barabartë para ligjit

78. Barazia para ligjit është një parim themelor kushtetues por nevojitet që, legjislacioni shqiptar, veçanërisht Kodi i Familjes, Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile duhet të pësojnë ndryshime për të qenë në përputhje me Konventën. Analiza e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me Konventën ka nxjerrë në pah disa problematika. Shqipëria është e ndërgjegjshme se ndryshimi thelbësor që ka sjellë Konventa është që personat me aftësi të kufizuara të zotërojnë të drejtën e tyre për zotësi juridike për të vepruar dhe të mbrohen në ushtrimin e saj, si një nga hapat më të rëndësishëm për realizimin e parimit të mosdiskriminimit. Shqipëria është e angazhuar që të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme të të metave të vërejtura në legjislacion dhe zbatimin e tij në praktikë.

79. Konkretisht, probleme janë konstatuar në formulime të disa neneve të Kodit Civil, dispozita të cilat bien në kundërshtim me pranimin e zotësisë juridike dhe ku konceptet e "prapambetjes mendore" dhe "sëmundjes psikike" të kujtojnë të ashtuquajturin model mjekësor, në vend të modelit bio-psiko-social. Në të njëjtën linjë dhe me problematika të ngjashme mund të përshkruhen edhe formulime të Kodit të Familjes, Kodit të Procedurës Civile, Kodit Penal. Për shembull, neni 307 i Kodit të Familjes parashikon se gjykata, në vendimin për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, cakton dhe kujdestarin për personin që i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar. Shprehje si "Personi të cilit po i hiqen të drejtat" duhen hequr nga legjislacioni i brendshëm. Administrimi i pasurisë nga kujdestari (neni 309 i Kodit të Familjes) i mohon personave me aftësi të kufizuara të drejtën për të kontrolluar çështjet e tyre financiare dhe të drejtën e disponimit mbi pasurinë.

80. Progres përbën miratimi i ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë, një nga parimet e të cilit është autonomia, respektimi i pavarësisë së vendimmarrjes së personave me aftësi të kufizuara (neni 7). Ligji parashikon "vendimmarrjen e mbështetur" si ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundësuar kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime. Çdo person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje, merr mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, përfshirë mbështetjen me anë të interpretimit dhe gjuhës së thjeshtë, dhe ndihmën në marrëdhëniet e personit me palë të treta, që nuk mund të kuptojnë mënyrat e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht, duke u dhënë kohë të mjaftueshme personave që e kërkojnë atë, për të mësuar se si mund ta përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.

81. Personat me aftësi të kufizuara të vendosur në institucionet e përkujdesit shoqëror vetëpërfaqësohen në rastet kur kanë zotësi të plotë për të vepruar. Në rastet kur personit i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë, ai/ajo përfaqësohet nga kujdestari ligjor, i cili mund të jetë edhe institucioni (punonjësi përgjegjës që e ka në ngarkim). Mungojnë statistika të veçanta për personat e braktisur që jetojnë në këto institucione.

82. Në përputhje me Konventën, Shqipëria synon të zbatojë modelin "vendimarrje e mbështetur". Në këtë rast, mbështetësi në vendimmarrje bën edhe përcjellje të informacionit në mënyrë të thjeshtuar, në mënyrë që personi me aftësi të kufizuara që nuk është në gjendje të kuptojë gjithçka pa asistencë të mund të informohet dhe të bëjë zgjedhjen personale. Mbështetësi në vendimmarrje duhet të jetë person që njeh dhe kupton mirë komunikimin me personin me aftësi të kufizuara. Këta persona do të trajnohen bazuar në ligjin për aksesueshmërinë.

Neni 13 – Aksesi në drejtësi

83. Aksesi në drejtësi garantohet me ligj, por shpesh, për shkak të mjediseve të paaksesueshme, materialeve shkresore jo në format të aksesueshëm, procedurave jo të thjeshtuara vërehen pengesa në realizimin e tij. Analiza e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me Konventën nxori në pah edhe disa mospërputhje të legjislacionit të brendshëm me Konventën mbi zbatimin e të drejtës për akses në drejtësi. Neni 33 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se nuk mund të ngrihet padi nga një person që i mungon zotësia juridike për të vepruar. Ky nen kërkon rregullime në frymën e nenit 12 të Konventës lidhur me zotësinë juridike.

84. Element bazë që garanton aksesin në drejtësi është përdorimi i gjuhës së kuptueshme gjatë të gjitha fazave të procesit, në mënyrë që të ushtrohen të drejtat procedurale dhe materiale në të gjitha fazat e tij. Kodi i Procedurës Penale parashikon se në të gjithë fazat e procedimit përdoret gjuha shqipe. Personat që nuk dinë shqip, përdorin gjuhën e tyre dhe, me anën e përkthyesit, kanë të drejtë të flasin e të marrin dijeni për provat e aktet, si dhe për zhvillimin e procedimit. Kjo dispozitë për përdorimin e gjuhës shqipe mund të përmirësohet, me qëllim që të sigurojë mbrojtjen e të drejtave për ata persona që kuptojnë shqip, por nuk mund ta flasin atë. Kjo zbatohet si për personat që nuk dëgjojnë dhe që kanë vështirësi në dëgjim, të cilët mund të përdorin një interpretues të gjuhës së shenjave, ashtu edhe për personat që nuk flasin dhe të tjerët që përdorin "mënyra të ndryshme komunikimi", të tilla si kompjuterë ndihmës, programe me zë dhe aparate të tjera teknike. Në të gjitha fazat e gjykimit përdoret gjuha shqipe. Personat që nuk dinë shqip, përdorin gjuhën e tyre. Ata marrin dijeni për provat dhe për gjithë zhvillimin e gjykimit me anë të përkthyesit.

Ndihma juridike

85. Ligji për ndihmën juridike përcakton personat dhe kriteret që duhet të plotësojë një person për të përfituar ndihmë juridike për çështje penale apo çështje civile dhe administrative. Që një person ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetojë se: i) përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to; ii) është viktimë e dhunës në familje ose viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, për çështjet gjyqësore që lidhen me to, apo të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj, apo është i mituri dëmtuar nga vepra penale. Pra që një person me aftësi të kufizuara të përfitojë ndihmë juridike, ai duhet të bjerë në një nga kategoritë e mësipërme.

Trajnime për gjyqtarët

86. Shkolla e Magjistraturës, me mbështetjen e PNUD-it, ka realizuar trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë për parashikimet e Konventës. Megjithatë ende mbetet shumë për të bërë në drejtim të forcimit të kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve për të realizuar në praktikë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në zbatim të së drejtës për barazi para ligjit dhe aksesit në drejtësi.

Neni 14 – Liria dhe siguria e personit

87. Gëzimi i i plotë i të drejtës së lirisë dhe sigurisë personale nga personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të mos privohen nga liria e tyre, në mënyrë të jashtëligjshme ose arbitrare, bazuar në ekzistencën e aftësive të tyre të kufizuara, është një detyrim ligjor kushtetues dhe e drejtë themelore e individit. Në vitin 2013 u miratuan ndryshime në Kodin Penal[58] konkretisht dispozita, e cila konsideron si rrethanë rënduese kryerjen e veprës penale të shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar të personit.

Personat me aftësi të kufizuar të privuar nga liria nga Policia

88. Ministria e Punëve të Brendshme, me strukturat e saj në varësi si pjesë e institucioneve shtetërore, në zbatim të Kushtetutës, kuadrit ligjor, ka detyrimin ligjor për mbrojtjen e lirisë dhe sigurisë së shtetasve, veçanërisht të atyre me aftësi të kufizuara. Për të miturit dhe personat me aftësi të kufizuara, trajtimi është i veçantë. Masa e kufizimit të lirisë është mjeti i fundit për kufizimin personal të personit e parashikuar dhe në Kodin e Procedurës Penale. Personat me aftësi të kufizuara dërgohen në kohën më të shpejtë të mundshme për vlerësimin e masës së sigurisë, kur arrestohen apo ndalohen. Neni 255 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se personat me aftësi të kufizuara mund të mbahen me kufizim personal në ambientet e banesave apo ambiente të përshtat-shme të ruajtura nga policia.

89. Punonjësit e policisë janë të trajnuar në

[58]Ligji nr. 144/2013,"Për disa shtesa e ndryshime të Kodit Penal, neni 50/j.

lidhje me trajtimin e të miturve dhe personave me probleme shëndetësore dhe këto veprime janë të zbatuara në temat mësimore të shkollimit policor. Policia e Shtetit ka marrë dhe zbatuar masa për përmirësimin e kushteve të ambienteve të dhomave të sigurisë për mbajtjen e trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar dhe në këtë kuadër dhe për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara. Me investime të qeverisë shqiptare është bërë e mundur krijimi i kushteve të përshtatshme në ambientet e komisariateve të policisë Kukës, Kavajë, Fier, Gjirokastër, Korçë, Durrës, Lezhë dhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Gjatë vitit 2014 - 2015, në 5 Drejtori të Policisë në qarqe (Tiranë, Lezhë, Fier dhe Vlorë, Berat) dhe 3 komisariate policie janë realizuar investime për krijimin e zyrave të shërbimit me ambiente të përshtatshme për shërbimin ndaj qytetarëve, në të cilat mund të kenë akses edhe shtetasit me aftësi të kufizuara duke krijuar të gjitha kushtet e hyrjes, pritjes dhe qëndrimit të tyre. Angazhimi i personelit policor për trajtimin dhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara që ndalohen/arrestohen, është maksimal.

Personat me aftësi të kufizuara në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP)

90. Ligji për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve[59] parashikon se të dënuarve me aftësi të kufizuara u garantohen liritë, të drejtat themelore të njeriut, trajtim jodiskriminues dhe mundësi të barabarta gjinore, duke marrë masa për aftësimin dhe riaftësimin e tyre. Të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuara u garantohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, trajtimi josdiskriminues i ndonjë lloji, për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre. Rëndësi të veçantë i kushtohet programit të trajtimit psiko-social të personave me aftësi të kufizuar duke hartuar programe individuale trajtimi duke mbajtur parasysh edhe nevojat specifike te tyre. Trajtimi i grupeve të veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve bëhet nga personel i trajnuar për këto kategori.

91. Personat me aftësi të kufizuara, sipas specifikave shëndetësore janë akomoduar në institucionet penitenciare apo seksione të posaçme brenda IEVP-ve, siç janë: institucioni i kategorisë së veçantë në Krujë, Qendra Spitalore e Burgjeve, një seksion i veçantë spitalor për të sëmurët mendorë në Durrës, dhe sektorët e kujdesit të veçantë për personat me çrregullime të shëndetit mendor në Peqin, Lezhë, Elbasan, Korçë, Tiranë. Këto institucione ofrojnë jo vetëm infrastrukturën e duhur, por edhe një personel të kualifikuar dhe të trajnuar për trajtimin e kësaj kategorie. Në lidhje me të dhënat mbi aftësinë e kufizuar në institucionet e vuajtjes së dënimeve penale janë 363 persona me aftësi të kufizuara meshkuj dhe 16 femra[60].

92. Në vijim të masave të marra për krijimin e një sistemi efektiv rehabilitues për personat e privuar nga liria, në vitin 2014 është miratuar një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë mbi çështjet e rehabilitimit dhe përgatitjes për lirim, duke krijuar mundësi për riintegrim të suksesshëm të personave me aftësi të kufizuar pas lirimit të tyre.

93. Në çdo institucion afishohen numrat e kontaktit të institucioneve dhe organizatave monitoruese, për adresimin e çdo ankese për dhunë, diskriminim apo keqtrajtim. Një mekanizëm i brendshëm inspektimi funksion në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Në çdo rast objekt monitorimi është trajtimi mjekësor dhe rehabilitues, si dhe respektimi i të drejtave të personave të paraburgosur dhe të dënuar me aftësi të kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara në qendrat rezidenciale

94. Qendrat rezidenciale të përkujdesit shoqëror, të cilat ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara (ose ndryshe qendrat e zhvillimit), kanë si objektiv kryesor rehabilitimin, vetëshërbimin dhe arsimimin për integrimin e këtyre personave në komunitet. Ofrimi i shërbimeve sociale për personat me aftësi të

[59]Ligji nr. 40/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328,datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve", të ndryshuar"

[60] Konkretisht: 31 persona të grup-moshës 66 – 25 vjeç, 115 persona të grup-moshës 26 – 35 vjeç, 130 persona të grup-moshës 36 – 45 vjeç, 76 persona të grup-moshës 46 – 54 vjeç dhe 27 persona i përkasin grup moshës mbi 55 vjeç. 39 persona me aftësi të kufizuara që vuajnë dënimin janë me aftësi të kufizuara fizike, 15 me aftësi të kufizuara ndijore, 18 me aftësi të kufizuara intelektuale, 307 me aftësi të kufizuara mendore.

kufizuara ofrohet në qendrat rezidenciale në Tiranë, Durrës, Shkodër, Berat, Vlorë dhe Korçë. Ky shërbim është parashikuar të ofrohet edhe në Qendrën Polivalente Poliçan, qendër nën administrimin e Shërbimit Social Shtetëror, e cila aktualisht nuk ka përfitues me aftësi të kufizuara, por vetëm të moshuar. Personat me aftësi të kufizuara janë vendosur në qendrat e zhvillimit në rastet kur nuk ka qenë e mundur që të jetojnë të pavarur, nuk kanë pasur anëtarë të familjes të gatshëm për t'u kujdesur për ta, kanë qenë të braktisur në kushtet kur nuk ushtronin dot vullnetin e tyre për të zgjedhur vetë për veten apo nuk kanë pasur kushte të mjaftueshme për jetesë normale, si strehim i përshtatshëm etj.

95. Prioriteti i punës në këto qendra është përkujdesi ndaj personave me aftësi të kufizuara si një proces i kushtëzuar nga gjendja shëndetësore dhe riaftësimi i tyre. Integrimi i personave me aftësi të kufizuara përbëhet nga 3 komponentë: i) vetëshërbimi; ii) arsimimi; dhe iii) veprimtaritë sociale krijuese në komunitet. Pranimi në institucion i personave me aftësi të kufizuara bëhet në bazë të kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin në institucione rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesjes shoqërore[61]. Nismën për vendosjen në institucion nuk e merr personi me aftësi të kufizuara, por prindi apo kujdestari i caktuar me vendim gjykate ose nga KMCAP, Policia e Shtetit, administratori shoqëror në nivel vendor, seksioni i ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në nivel vendor. Pranimi në institucion i personave me aftësi të kufizuara bëhet nga Komisioni Qendror pranë SHSSH i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

96. Standardet e Shërbimeve Shoqërore[62] për personat me aftësi të kufizuara parashikojnë ofrimin e kujdesit personal, respektimin e dinjitetin, intimitetit dhe rehatisë së tyre. Ofruesit e shërbimeve shoqërore respektojnë të drejtat e njeriut për përfituesit e tyre duke u garantuar mbrojtje dhe siguri nga të gjitha llojet e abuzimeve. Përfituesit gjithashtu mbështeten me programe dhe procedura të hapura dhe të përshtatshme për ta. Standardet parashikojnë edhe detyrimin e personelit që ofron shërbimet për të respektuar kodin etik të profesionit, si edhe mekanizma konkretë në lidhje me garantimin e jetës private, mbrojtjes së fshehtësisë së korrespondencës dhe të të dhënave personale.

Neni 15 - Liria nga tortura ose nga trajtimi /dënimi mizor, çnjerëzor apo degradues

97. Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara nga tortura, trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor dhe degradues është detyrim kushtetues dhe i së drejtës ndërkombëtare. Neni 25 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor poshtërues. Rregulloret e funksionimit të qendrave të zhvillimit kanë parashikuar hapa konkretë për parandalimin dhe trajtimin e keqtrajtimeve. Personeli i qendrave të zhvillimit është i ndërgjegjësuar për përballjen me drejtësinë në rast të trajtimeve çnjerëzore dhe dergaduese. Rregulloret përmbajnë procedura ankimore të detajuara dhe rastet e keqatrajtimeve menaxhohen menjëherë. Të gjitha institucionet kanë regjistër të rasteve të dhunës. Nuk ka asnjë rast të përdorimit të këmishëve të forcës në të gjitha qendrat e zhvillimit.

98. Legjislacioni penitenciar ndalon çdo formë dhune të qëllimshme, që cenon jetën apo shkakton denigrim dhe diskriminim të të paraburgosurve dhe të dënuarve veçanërisht për shkak të aftësisë së kufizuar. Personeli i burgut nuk përdor forcë kundër të burgosurve, me përjashtim të rasteve kur ky veprim është i nevojshëm për mbrojtjen e jetës së vetë individit nga vetëdëmtimi ose në mbrojtje të jetës të bashkëvuajtësve të tjerë. Edhe në këto raste, forca përdoret si mjet i fundit. Masa e forcës së përdorur është minimumi i mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme. Për trajtimin e kategorive me nevoja specifike në sistemin penitenciar, synohet parandalimi i diskriminimit, dhunës dhe keqtrajtimit për këto kategori. Në masat parandaluese një aspekt i rëndësishëm është rekrutimi i stafit profesional dhe trajnimi i tij. Në planin vjetor të trajnimeve ka disa module specifike trajnimi mbi shprehitë e komunikimit, trajtimit dhe mosdiskriminimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve, veçanërisht për kategoritë me nevoja specifike, siç janë personat me aftësi të kufizuara. Personat që janë dënuar në kushtet e e një aftësie të kufizuar mendore duhet të vendosen në institucione të posaçme, të cilat nuk janë krijuar ende në Shqipëri.

[61]VKM nr. 839 datë 3.12.2014
[62]VKM nr. 822, datë 6.12.2006

99. Janë përgatitur materiale informative për njohjen e të dënuarve dhe të paraburgosurve me të drejtat e tyre, me qëllim rritjen e vetëdijësimit për mbrojtjen e të drejtave të tyre, veçanërisht tek kategoria e personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu një sërë udhëzuesish administrativë zbatohen nga administrata e sistemit penitenciar në çështje të trajtimit psiko-social dhe të sigurisë, me qëllim përmirësimin e trajtimit të kategorive vulnerabël: a) Udhëzues mbi trajtimin psikologjik të personave me çrregullime të shëndetit mendor; b) Udhëzues mbi politikën disiplinore për personat me çrregullime të shëndetit mendor; c) Udhëzues mbi kufizimin fizik; d) Udhëzues mbi përdorimin e masës së izolimit; e) Udhëzues mbi vetëvrasjen; f) Udhëzues mbi trajtimin e detyrueshëm;

100. Në çdo institucion penitenciar zbatohet Protokolli i Stambollit për dokumentimin e rasteve të dhunës, edhe për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Për të parandaluar torturën dhe format e tjera të trajtimit diskriminues brenda popullatës së të paraburgosurve dhe të dënuarve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka hartuar udhëzime për stafin e sistemit penitenciar, të cilat përfshijnë masa për akomodimin, observimin dhe ndërmarrjen e fushatave sensibilizuese brenda institucioneve për të siguruar një klimë të sigurt bashkëjetese dhe pranimi të personave që i përkasin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara. Masat përfshijnë kontakte të vazhdueshme me të paraburgosurit dhe të dënuarit e kësaj kategorie, për njohjen dhe adresimin në kohë çdo problematikë apo nevojë të tyre.

101. Të paraburgosurve dhe të dënuarve, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale, para ose gjatë qëndrimit në institucion, i ofrohen menjëherë masa mbrojtjeje, mbështetjeje dhe këshillime ligjore, si dhe programe të individualizuara me qëllim rehabilitimin e tyre. Në raste të përdorimit të dhunës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, autoritetet e institucionit, në çdo rast, mundësojnë fillimin e menjëhershëm të një hetimi të pavarur nga strukturat dhe organet kompetente të ngarkuara me ligj, duke respektuar parimin e privatësisë, mbrojtjes dhe sigurisë personale.

102. Pas pranimit në institucion, i paraburgosuri dhe i dënuari informohen nga komisioni i pritjes lidhur me të drejtën për të paraqitur kërkesa ose ankesa, me shkrim ose përjashtimisht me gojë, drejtuar personelit të institucionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Ministrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare, OJF-ve vendase dhe të huaja, gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit penal, prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, si dhe personave të tjerë që vizitojnë institucionin.

103. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka marrë masa efektive për të garantuar që mekanizmi i kërkesë-ankesës të funksionojë si një procedurë efektive përmes së cilës të paraburgosurit dhe dënuarit mund të adresojnë në mënyrë konfidenciale kërkesat dhe ankesat e tyre dhe të gjejnë zgjidhje të vlefshme për ta. Në çdo rast pretendimi për keqtrajtim, grupe multidisiplinare të inspektimit të DPB verifikojnë rastin në institucion. Çdo institucion administron një regjistër të veçantë për administrimin e rasteve të dëmtimeve të ekzaminuara apo të raportuara nga të burgosurit, gjatë pranimit.

Garancitë për mbrojtje nga eksperimentet

104. Ligji për shëndetin mendor parashikon se asnjë person me çrregullime të shëndetit mendor nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues (neni 8). Kërkimet shkencore dhe mjekësore ndaj personave me çrregullime të shëndetit mendor ndërmerren vetëm pasi të jetë marrë miratimi i informuar nga këta pacientë. Këto kërkime shkencore dhe mjekësore nuk zbatohen ndaj personave me çrregullime të shëndetit mendor, që janë duke marrë trajtim të pavullnetshëm në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër dhe pesonave që nuk kanë zotësi për të vepruar (neni 26).

Monitorimi i zbatimit të së drejtës për të mos iu nështruar torutës, trajtimit çnjerëzor e degradues

105. Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit Çnjerëzor dhe Poshtërues, monitoron, rregullisht, me anë të inspektimeve periodike, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, apo në burgje e paraburgim, në institucionet ku personat me aftësi të kufizuara janë të privuar nga liria. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mundëson takime konfidenciale të të paraburgosurve dhe të

dënuarve, pa dallim, me anëtarët e komisionit mbikëqyrës, mbrojtësin e zgjedhur ose të caktuar kryesisht, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të OJF-ve, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të fëmijëve, grave, të rinjve, personave me aftësi të kufizuar etj. Avokatit të Popullit, gjatë inspektimeve, i garantohet hyrja lirisht në të gjitha vendet dhe mjediset e institucioneve të privimit të lirisë, i garantohet marrja e çdo informacioni, sipas legjislacionit në fuqi. Avokati i Popullit paraqet rekomandime në organet përkatëse.

Neni 16 - Liria nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi

106. Kushtetuta parashikon mbrojtje të veçantë për çdo fëmijë nga dhuna, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi[63]. Gjithashtu, gratë me aftësi të kufizuara mbrohen nga ligji. Kodi Penal (neni 130/a) e parashikon dhunën në familje si vepër penale[64]. Gjithashtu ndryshimet kanë përfshirë dhe abuzimin sistematik psikologjik dhe ekonomik, si dhe masa për t'i çliruar viktimat e dhunës në familje nga detyrimi për të nisur ndjekjen penale në rastin e "lëndimeve fizike të lehta". Neni 121/a parashikon se kërcënimi ose /apo "veprimet e përsëritura" me qëllimin për t'i shkaktuar një personi një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndërrojë mënyrën e jetesës dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 4 vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti /bashkëjetuesi, dënimi rritet me një të tretat. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t'u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet me ½.

107. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare ", të ndryshuar, ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore, garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, që janë viktima të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Efektet e zbatimit të këtij ligji janë:

- Krijimi i një rrjeti të koordinuar institucionesh në nivel qendror dhe vendor për t'u dhënë mbështetje të menjëhershme viktimave të dhunës në familje;
- Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik dhe grave e vajzave për të denoncuar dhunën në familje;
- Rritja e numrit të denoncimeve dhe pajisja e viktimave me urdhra mbrojtës;
- Ngritja e Qendrës Kombëtare për Viktimat e Dhunës;
- Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me viktimat e dhunës në familje.

108. Në zbatim të ligjit kundër dhunës në familje, në shkurt të vitit 2011 janë ngritur:

Mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare[65]dhe janë përcaktuar procedurat për ndërhyrjen multidisiplinare në ndihmë të viktimave të dhunës në familje.

Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, e cila funksionon prej datës 25.4.2011.

109. Janë miratuar standardet[66] e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike. Standardet synojnë përmirësimin e jetesës së viktimave të dhunës në familje dhe të familjeve të tyre. Në korrik 2014, u lançua ngritja e sistemit *online* për regjistrimin e rasteve të dhunës në familje. MMSR-ja në bashkëpunim me PNUD-in ngriti sistemin elektronik kombëtar për regjistrimin e rasteve të dhunës në familje të trajtuara në nivel vendor nga anëtarët e Mekanizmit Kombëtar të Referimit. Nga të dhënat e mbledhura nga sistemi rezulton se personat me aftësi të kufizuara kanë pësuar dhunë vetëm në 2% dhe 1% të rasteve, përkatësisht në vitin 2014 dhe 2013.

Neni 17- Mbrojtja e integritetit të personit

110. Kuadri ligjor garanton të drejtën për integritet të çdo individi, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, për

---

[63] Referim informacionit në vijim për nenin 6 të Konventës.

[64] Sipas KP dhuna në familje, përfshirë rrahjen, kanosjen dhe plagosjen e kryer me dashje, dënohen me burgim deri në 5 vjet.

[65]VKM nr. 334 datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".

[66]VKM nr.505 datë 13.7.2011

personat me aftësi të kufizuara, shërbimet shëndetësore janë të orientuara drejt: 1) parandalimit; 2) diagnostikimit dhe trajtimit të hershëm; c) rehabilitimit dhe kujdesit shëndetësor. Parandalimi i aftësisë së kufizuar duhet të arrihet përmes: a) promovimit; b) vaksinimit; c) diagnostikimit prenatal; d) kujdesit pre dhe perinatal; e) mundësisë për abort. Diagnostikimi dhe trajtimi i hershëm duhet të mbështeten nga: a) analiza nga laboratorë gjenetikë; b) depistimi i fëmijëve 0-6 vjeç. Rehabilitimi dhe shërbimi shëndetësor duhet të arrihet përmes: i) diagnostikimit dhe trajtimit në shërbimet e kujdesit parësor, sekondar dhe terciar; ii) përcaktimit / vlerësimit të specializuar të aftësisë së kufizuar nga komisionet e ngritura me këtë qëllim; iii) ndihmës financiare; iv) përfitimit të shërbimeve; v) përfitimit të medikamenteve; vi) përfitimit të kujdesit dentar.

111. Në qendrat e zhvillimit, ku janë të akomoduar personat me aftësi të kufizuara, ofrohet shërbimi mjekësor me bazë qendre, pra funksionon shërbimi mjekësor, i cili bën të mundur hartimin e planit shëndetësor për çdo përfitues. Mjeku përcakton në bashkëpunim me grupin multidisiplinar protokollin që duhet të ndiqet për shërbimin që do të marrë një përfitues rezidencial. Përcaktohen terapia e mjekimit, doza dhe kohëzgjatja e saj. Ecuria shëndetësore e përfituesit pasqyrohet në kartelën e tij shëndetësore, në qendrën e zhvillimit ku personi është i akomoduar.

111. Masat e marra për të mbrojtur personat me aftësi të kufizuara nga trajtimet mjekësore apo trajtimet e tjera të dhëna pa miratimin me vullnet të lirë dhe të informuar të personit janë parashikuar në disa nene të veçanta të ligjit nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor", përkatësisht në nenin 19 "Trajtimi i vullnetshëm" dhe nenet 20, 21, 22, 23, 24, ku përcaktohen hapat e procedurës të trajtimit të pavullnetshëm si një moment shumë delikat dhe neni 25 për trajtimet e veçanta mjekësore dhe kirurgjikale.

Mbrojtja nga aborti i detyruar

112. Ligji "Për ndërprerjen vullnetare të shtatzënisë" parashikon respektimin e çdo qenieje njerëzore që në fillim të jetës. Ky parim nuk shkelet, përveç rasteve kur është e domosdoshme dhe në kushtet e përcaktuara në këtë ligj. Ligji përcakton se aborti në asnjë rast nuk duhet të përdoret si metodë e planifikimit familjar. Parashikohet ndërprerja vullnetare e shtatzënisë me kërkesën e nënës deri në 12 javë shtatzënie. Ligji garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës së tyre, pra që në fazën e konceptimit. Shtatzënia deri në 22 javë mund të ndërpritet për një sërë arsyesh shëndetësore përfshirë edhe ato psiko-sociale, të cilat janë përcaktuar në zbatim të këtij ligji nga Ministria e Shëndetësisë. Mjeku të cilit i kërkohet ndërprerja e vullnetshme e shtatzënësisë, që në vizitën e parë duhet të informojë gruan për rreziqet mjekësore që sjell ndërprerja e shtatzënisë për shtatzënitë e ardhshme; problemet biologjike të ndërhyrjes mjekësore; të drejtat, ndihmën dhe avantazhet e garantuara me ligj për familjen, nënën dhe fëmijën; për mundësitë e adoptimit të fëmijëve që priten të lindin; institucionet dhe organizmat që mund t'i ofrojnë gruas mbështetje morale dhe financiare; klinikat dhe spitalet që kryejnë ndërprerje të shtatzënësisë. Nga monitorimi rezulton se nuk ka pasur asnjë rast të sterilizimit të detyruar të personave me aftësi të kufizuara që jetojnë në qendrat e zhvillimit.

Neni 18 - Liria e lëvizjes dhe shtetësia

113. Legjislacioni trajton dhe parashikon pa asnjë dallim kushte të njëjta për të gjithë shtetasit shqiptarë, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit mbulon të gjitha çështjet për të siguruar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të hyrë apo për të dalë nga vendi.

114. Legjislacioni për gjendjen civile parashikon kriteret për ndryshimin e vendbanimit, parashikon kushte të njëjta, pa asnjë dallim për të gjithë shtetasit shqiptarë, përfshirë këtu dhe personat me aftësi të kufizuara. Ligji parashikon se shtetasit kanë të drejtë të zgjedhin lirisht në cilën banesë të jetojnë zakonisht ose të shumtën e kohës. Banesën, në të cilën shtetasi jeton zakonisht ose për më shumë se tre muaj pa ndërprerje ose më shumë se gjashtë muaj në një vit kalendarik, ka detyrimin ta deklarojë si vendbanimin e tij (neni 14/2). Në aktin nënligjor të miratuar për ndryshimin e vendbanimit, vendimit nr. 1243, datë 11.12.2009 "Për përcaktimin e dokumenteve që duhet të paraqesin shtetasit e të procedurave që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe institucionet shtetërore të posaçme për ndryshimin e vendbanimit / adresës së shtetasve", parashikohen rregulla të njëjta për të gjithë

shtetasit, të cilët kërkojnë të regjistrojnë/ ndryshojnë vendbanimin.

Regjistrimi i lindjeve

115. Regjistrimi i çdo fëmije të lindur në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhet në zyrën e gjendjes civile, në bazë të dokumentit, "certifikatë e asistencës në lindje", ose "raportit mjekësor", të hartuar në kohën e lindjes dhe të vërtetuar nga personeli mjekësor i pranishëm, apo personave të tjerë, të autorizuar nga ligji në mungesë të personelit mjekësor. Institucionet shëndetësore, shtetërore ose private, kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen dhe kanë detyrimin për të dërguar çdo ditë të hënë në zyrën e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre (neni 46). Pra legjislacioni në fuqi detyron jo vetëm personat që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, por njëkohësisht ngarkon edhe institucionet shëndetësore.

Neni 19 - Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet

116. Garantimi i jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të tillë, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, është një nga qëllimet e ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë. Specifikisht, lidhur me jetesën e pavarur, personave me aftësi të kufizuara u garantohet zgjedhje, kontroll, liri të njëjtë me të tjerët, si dhe mbështetje dhe ndihmë, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim, shërbime e mundësi të tjera, dhe pjesëmarrje në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare, qytetare.

117. Ligji parashikon se jetesa e pavarur mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen: asistenca personale, pajisjet e mjetet teknike mbështetëse, shërbimet e aksesueshmërisë, përfshirë transportin, përshtatja e arsyeshme dhe, atëherë kur është e nevojshme, vendimmarrja e mbështetur (neni 6). Ligji përcakton edhe karakteristikat minimale që duhet të përmbushin këto shërbime. Parashikohet që ndihmësi personal do të ofrojë asistencë personale për kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara, shoqëruesit për personat e verbër, interpretues i gjuhës së shenjave dhe lehtësuesit në komunikim për personat me paaftësi në të folur dhe të dëgjuar.

118. Personave me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për pajisje u sigurohen mjete ndihmëse për të kapërcyer pengesat. Sigurimi i mjeteve ndihmëse bëhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe koordinohet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Por kjo nuk ka nisur ende të zbatohet dhe ndoshta fillimi i këtij procesi do të kërkojë një kohë të gjatë.

119. Me gjithë këto zhvillime të reja ligjore, në Shqipëri ende nuk ka shërbime që të mbështesin personat me aftësi të kufizuara që duan të jetojnë të pavarur në komunitetet e tyre. Në vend ofrohen disa shërbime mbështetëse në shtëpi për të moshuar me aftësi të kufizuara kryesisht mbi baza projektesh pilote, të cilat realizohen nga OJF ose nga programe vullnetarizmi të tyre. Shërbime për personat me aftësi të kufizuara ofrohen në shtëpi-familje apo qendra ditore, të cilat në shumicën e rasteve mbështeten nga OJF-të ose misione fetare. Strukturat shtetërore monitorojnë dhe i inspektojnë këto shërbime mbi bazën e standardeve të shërbimeve shoqërore. Aktualisht, një numër shumë i pakët personash me aftësi të kufizuara jetojnë të shkëputur nga familjet e tyre për shkak të kostos së lartë të jetesës së pavarur, mungesës së banesave personale si dhe mjeteve ndihmëse të posaçme.

Neni 20. Lëvizshmëria personale

120. Në qendrat e zhvillimit është siguruar teknologjia e nevojshme për përdorimin e sinjalistikës. Por aksesueshmëria jashtë institucionit në sinjalistika apo shenja rrugore është e parealizuar (shih më lart seksionin për nenin 9- Heqja e barrierave).

Neni 21 - Liria e shprehjes, e mendimit dhe aksesi në informacion

121. Kuadri ligjor garanton të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për lirinë e shprehjes dhe mendimit përfshirë lirinë për të kërkuar, marrë e dhënë informacione dhe ide nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit që ata zgjedhin Kushdo ka të drejtë, pra edhe personat me aftësi të kufizuara, që në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore (nenet 22, 23 të Kushtetutës).

122. Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara parashikon sigurimin e jetesës së pavarur nëpërmjet politikave

për komunikim dhe informacion (neni 5/2) dhe formateve të aksesueshme (neni 19). Ky ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, veçanërisht ato që lidhen me të drejtat dhe përfitimet e posaçme të personave me aftësi të kufizuara, do të jenë të disponueshëm në format të aksesueshëm, siç është printimi dhe botimi në brail, printimi me shkronjë të madhe dhe në gjuhë të thjeshtuar.

123. Legjislacioni për të drejtën e informimit[67] ka përmirësuar rregullat për mbrojtjen e të drejtës për informim, të çdo qytetarit dhe i atribuon kompetenca për monitorimin e realizimit dhe zbatimit të kësaj të drejte, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP). Në të parashikohet se çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit (neni 3/3).

124. Të gjithë individët, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit për ndihmën juridike e përfitojnë informacionin falas deri në një numër të caktuar faqesh për çdo kërkesë ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër.(neni 13/4).

125. Ligji nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në RSH-së", garanton të drejtën e personave me aftësi të kufizuara, për akses në shërbimet e transmetimeve audio dhe audiovizive. E drejta për të marrë informacion dhe garantimi i lirisë së shprehjes për komunitetet me nevoja të veçanta shqisore, janë pjesë e parimeve themelore të veprimtarisë audiovizive, të sanksionuara në ligj. Legjislacioni trajton dhe përcakton detyrimet e ofruesve të shërbimit audioviziv, për të realizuar marrjen e programeve në një nivel të kënaqshëm nga personat me aftësi të kufizuara. Kështu shërbimet e transmetimeve audiovizive marrin parasysh nevojat e personave me nevoja të veçanta shqisore (neni 32/5). Ky komunitet ka edhe të drejtën e paraqitjes së kandidaturave për anëtar të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)[68] dhe të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Publik Shqiptar.

126. Në ligj parashikohet se rregulloret e transmetimit duhet të përcaktojnë për çdo Ofrues të Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA), sigurimin e shërbimeve të tilla, si gjuha e shenjave, shërbimet e teletekstit, titrimin dhe përshkrimin me zë, si dhe detyrohen të angazhohen për marrjen e programeve në një nivel të kënaqshëm nga personat që kanë një shkallë të caktuar aftësie të kufizuar dëgjimi ose shikimi. Legjislacioni i mundëson komuniteteve me nevoja të veçanta shqisore, të pajisen me licencë të transmetimit audio të komunitetit. Kjo realizohet në nenet 57 dhe 58 të ligjit nr. 97/2013. Në zbatim të detyrimeve ligjore, AMA siguron që shërbimi i programit audioviziv të përfshijë, në mënyrë të arsyeshme, përdorimin e gjuhës së shenjave në emisionet e lajmeve për njerëzit që nuk dëgjojnë (neni 67).

127. Një nga masat për të garantuar të drejtën e aksesit në media të personave me aftësi të kufizuara, është hartimi dhe miratimi nga AMA, me vendimin nr. 1, datë 27.01.2014 i Kodit të Transmetimit, ku një kapitull i veçantë (seksioni 6), i kushtohet problematikave të personave me aftësi të kufizuara. Në procesin e këshillimit publik për hartimin e Kodit dhe akteve të tjera nënligjore, i është kushtuar vëmendje trajtimit të detyrave të OSHMA-ve për personat me aftësi të kufizuara, për dhënien e një imazh të respektuar për ta në transmetimet audiovizive. Kodi i Transmetimit i është përcjellë zyrtarisht të gjithë operatorëve audio dhe audiovizivë për njohje dhe zbatim. Kodi i Transmetimit, i miratuar, është publikuar në faqen zyrtare të internetit të AMA-s.

128. Gjatë vitit 2014 u miratua ligji nr. 146/2014 "Për njoftim dhe konsultim publik", i cili përcakton rregulla procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike. Ligji i jep të drejtë çdo pale të interesuar që t'i propozojë organeve publike fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e projektakteve, t'i dorëzojë organeve publike komente dhe rekomandime për projekt/aktet që janë në proces të njoftimit e të konsultimit publik, etj.

129. Në dhjetor të vitit 2013, u ngrit grupi ndërinstitucional i punës "Për zyrtarizimin e gjuhës

[67] Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
[68]Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e RSH-së.

së shenjave në RSH-së". Është realizuar një studim i kuadrit ligjor dhe politikave për identifikimin e nevojave për ndërhyrje dhe rekomandimet përkatëse. Gjithashtu, në vijim të këtij procesi do të përgatitet një platformë masash për zbatim ku do të përcaktohen detyrimet për institucionet që duhet të ofrojnë këtë shërbim. Në këtë kuadër, është miratuar vendimi nr. 837, datë 3.12.2014 i Këshillit të Ministrave "Për njohjen e gjuhës së shenjave", i cili ka për qëllim njohjen zyrtarisht të gjuhës së shenjave, për t'i ardhur në ndihmë komunitetit të njerëzve që nuk dëgjojnë në Shqipëri, në mënyrë që të kenë qasje në informacionet e ofruara nga institucionet e vendit. Pavarësisht të gjitha këtyre masave, do të vijohen përpjekjet për të eliminuar barrierat në komunikim, që çojnë në përjashtimin e personave me aftësi të kufizuara, nga shumë fusha të jetës dhe bëhen pengesë për gëzimin në baza të barabarta me të tjerët të shumë të drejtave, shërbimeve që ofrohen për publikun.

Neni 22 - Respektimi i privatësisë

130. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e privatësisë së informacionit personal, shëndetësor dhe në lidhje me statusin e rehabilitimit të personave me aftësi të kufizuara, njësoj si pjesa tjetër e popullatës janë parashikuar në ligjin për shëndetin mendor (nenet 6 dhe 7). Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale (KDIMDP) i kushton vëmendje të veçantë të dhënave sensitive (në të cilat bëjnë pjesë dhe të dhënat shëndetësore), duke kërkuar nga kontrolluesit publikë dhe privatë masa më të rrepta sigurie për sa i përket përpunimit të tyre, duke përfshirë dhe këtë kategori të ndjeshme, përpunimin e të dhënave të "personave me aftësi të kufizuara". KDIMDP ka hartuar dhe miratuar akte nënligjore për përpunimin e të dhënave shëndetësore, përkatësisht udhëzimin nr. 5, datë 26.5.2010 "Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor" dhe udhëzimin nr. 23, datë 20.11.2011"Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë". Për mbrojtjen e të dhënave personale të personave me aftësi të kufizuara, nga Zyra e Komisionerit janë ndërmarrë kontrolle administrative. Në këto raste, Zyra e Komisionerit ka dalë me rekomandime, nëpërmjet të cilave ka sugjeruar kontrolluesit për respektimin e detyrimeve ligjore.

131. Ligji "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve„ parashikon masat për mbrojtjen e privatësisë personale, korrespodencës, informacioneve të lidhura me shëndetin dhe rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet e vuajtjes së dënimeve penale marrin masa për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale për personat e paraburgosur dhe të dënuar pa dallim, duke garantuar një nivel sigurie të plotë gjatë përpunimit dhe ruajtjes së tyre. Në çdo institucion funksion mekanizmi i kërkesë ankesës, duke ruajtur dhe respektuar konfidencialitetin në çdo rast. Konfidencialiteti gjatë zhvillimit të ekzaminimeve mjekësore është një nga parimet bazë që respektohet gjatë ekzaminimeve mjekësore dhe një nga tematikat kryesore të moduleve të trajnimit për stafin mjekësor dhe të sigurisë në sistemin e burgjeve. Ndërkohë që kartelat mjekësore me të dhënat personale shëndetësore të të burgosurve, administrohen vetëm nga mjekët.

132. Në të gjithë qendrat e zhvillimit për personat me aftësi të kufizuara zbatohet e drejta e ruajtjes së të dhënave personale në bazë të ligjit "për mbrojtjen e të dhënave personale". Çdo informacion që merret prej tyre dhe që përdoret për efekte studimore apo statistikore jepet përmes inicialeve, pasi është marrë dakortësia e personit kujdestar. Informacioni për përfituesit administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, nga drejtuesit e qendrave institucionet kompetente, të cilët mbledhin të dhënat dhe ruajnë konfidencialitetin e përfituesve.

Neni 23 - Respektimi i shtëpisë dhe familjes

133. Kushtetuta garanton të drejtën e martesës së çdo individi, përfshirë personat me aftësi të kufizuara të martohet dhe të ketë familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit. Megjithatë Kodi i Familjes vendos kufizime për të drejtën për t'u martuar për personin që vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, që e bën të paaftë të kuptojë qëllimin e martesës, ndërsa martesa e lidhur nga një person që vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, që e bën të paaftë të kuptojë qëllimin e martesës, është e pavlefshme.

134. Përsa i përket aksesit në planifikimin

familjar, riprodhimit të asistuar dhe programet e adoptimit, të personave me aftësi të kufizuara, kuadri aktual rregullator parashikon akses në shërbime publike sikurse programi kombëtar i planifikimit familjar, i shtrirë në të gjitha qendrat shëndetësore dhe maternitet në vend. Riprodhimi i asistuar është i kufizuar në sektorin publik.

135. Në kuadër të deinstitucionalizimit, Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) ka nxjerrë një urdhër për të gjitha drejtoritë rajonale, që të bashkëpunojnë me institucionet e përkujdesit lidhur me vlerësimin dhe fuqizimin e familjeve biologjike. Rol të rëndësishëm i kushtohet për koordinimit të punës midis familjeve biologjike dhe administratorëve shoqërorë për parandalimin e institucionalizimit për gjetjen e alternativave të mundshme për shërbime komunitare. Qendra e Zhvillimit në Tiranë ka aplikuar një model të ri të shërbimit për personat me aftësi të kufizuara duke i trajtuar ata në qendra ditore, por edhe duke përfshirë familjet biologjike në arritjen e autonomisë së këtyre personave.

136. Shërbimi i kujdestarisë[69], si shërbim alternativ social për fëmijët në nevojë pa kujdes prindëror, është një shërbim, i cili po zbatohet në të gjithë vendin dhe synon të sigurojë: i) vazhdimësinë e mirërritjes për fëmijët në vështirësi në një ambient familjar nëpërmjet një familjeje zëvendësuese ku fëmijët të ndjehen të rrethuar me vëmendje dhe kujdes familjar; ii) kujdes dhe zhvillim për fëmijët në vështirësi në përputhje me moshën, nevojat individuale dhe standardet e shërbimit të kujdestarisë; iii) socializimin dhe riintegrimin e fëmijës në familjen biologjike tek të afërmit, familja adoptive dhe në komunitet. Për fëmijën e vendosur në familje kujdestare, shteti ofron mbështetje financiare për shpenzimet për ushqim, veshmbathje, shkollim dhe shpenzime të tjera indirekte. Kur fëmija i vendosur në familje kujdestare është fëmijë me aftësi të kufizuara mbështetja me pagesë është më e madhe. Gjatë vitit 2014, janë vendosur në shërbimin e kujdestarisë së përkohshme, 131 fëmijë nga të cilët 48 fëmijë janë me aftësi të kufizuara[70]. Masa e financimit për familjen kujdestare, për shpenzimet e ushqimit të një fëmije në kujdestari, është 9 000 lekë në muaj, ndërkohë që për fëmijën me aftësi të kufizuar të vendosur në kujdestari, është 10 000 lekë në muaj, pra 1 000 lekë më shumë. Këta fëmijë mbështeten edhe me 25 000 lekë në vit për veshmbathje, shpenzime për shkollën dhe shpenzime të tjera indirekte.

137. MMSR është duke realizuar një reformë të shërbimit social bazuar në decentralizimin dhe de-institucionalizimin gradual të shërbimeve në përmbushje të objektivave të strategjisë së mbrojtjes sociale. Kjo reformë do të ulë numrin e fëmijëve dhe të rinjve në institucione, si dhe do të ofrojë shërbime më cilësore në komunitet për këdo që ka mundësi të kufizuara për shkak të aftësisë së kufizuar.

Neni 24 – Arsimimi

138. Legjislacioni shqiptar garanton të drejtën e arsimimit në të gjitha nivelet e arsimit që përcakton ligji, pavarësisht nga gjendja shoqërore, kombësia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shëndetësore dhe niveli ekonomik. E drejta për arsim e fëmijëve me aftësi të kufizuara është një e drejtë themelore e tyre, e cila sanksionohet në aktet ndërkombëtare dhe kombëtare. Në Kushtetutë sanksionohet e drejta e barabartë e të gjithë shtetasve për t'u arsimuar (neni 57) dhe edukimi i specializuar e integrimi në shoqëri i personave me aftësi të kufizuara si pjesë e objektivave sociale (neni 59).

139. Ligji për arsimin parauniversitar përfshin parime të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara (neni 63), konkretisht:

- Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre për t'i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe tregun e punës.
- Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme.
- Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore.
- Nxënësve, që nuk dëgjojnë e nuk flasin, u garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenja.

140. Sipas censusit të popullsisë të vitit 2011, rreth 55.6% e popullsisë mbi 15 vjeç me aftësi të kufizuara kanë përfunduar arsimin bazë, 3.3% kanë përfunduar arsimin e lartë dhe pasuniversitar,

[69] VKM nr. 89, datë 26.1.2012 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurës së shërbimit të kujdestarisë".

[70] Sipas statistikave të SHSSH shtator – tetor 2014

ndërsa 24.3% nuk e kanë ndjekur asnjëherë shkollën[71].

141. Për vitin akademik 2013-2014, në shkallë vendi, janë regjistruar 2410 fëmijë me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e arsimit bazë (1013 fëmijë me aftësi të kufizuar mendore; 465 fëmijë me aftësi të kufizuara fizike; 298 fëmijë me probleme në shikim; 126 fëmijë me problem në dëgjim dhe 505 fëmijë me autizëm). Për vitin akademik 2014-2015, në arsimin parauniversitar janë regjistruar 3201 fëmijë me aftësi të kufizuara, ose rreth 33% më shumë se një vit më parë. Ky numër përbën vetëm 0.5% të numrit të përgjithshëm të fëmijëve të regjistruar në arsimin e detyruar[72]. Rreth 673 fëmijë me aftësi të kufizuara, nga të cilët 213 femra, mësojnë në dhjetë shkolla speciale në të gjithë vendin.

142. Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me njësinë bazë të qeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit e komisionin pranë drejtorisë arsimore/zyrës arsimore, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara. Njësia arsimore vendore[73], sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të Ministrit të Shëndetësisë, siguron arsimim në shtëpi nxënësve që nuk mund të ndjekin një shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë. Por nuk ka një udhëzim për të siguruar këtë formë arsimi për fëmijët me aftësi të kufizuara.

143. Mbetet ende një nevojë e paadresuar nevoja për mësues mbështetës në shkollat e arsimit bazë, për të mbështetur procesin e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, pavarësisht daljes së udhëzimi të Ministrit të Arsimit, nr. 38, datë 7.10.2014, "Për kriteret e punësimit të mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike te arsimit parauniversitar". Gjithashtu nuk ka tekste shkollore të përshtatura për fëmijët me aftësi të kufizuara që mësojnë në shkollat e arsimit bazë.

144. Bazuar në ligj, çdo fëmijë duhet të arsimohet. Kështu, fëmijët me aftësi të kufizuara, pavarësisht llojit dhe rëndesës së aftësisë së kufizuar kanë të drejtën të regjistrohen në çerdhe, kopshte dhe shkolla të zakonshme. Ndjekja e arsimit parashkollor është lehtësuar përmes heqjes së të gjitha tarifave për fëmijët që janë të komisionuar.

145. Bazuar në Dispozitat Normative[74] të Arsimit Parauniversitar (neni 93), pranë çdo drejtorie arsimore/zyrë arsimore janë ngritur, por ende nuk kanë filluar të realizojnë qëllimin e tyre komisionet shumë-disiplinore për vlerësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara. Këto komisione përbëhen nga ekipe multidisiplinare dhe bazohen në modele vlerësimi bio-psiko-sociale. Këto komisione përcaktojnë nevojën e fëmijës për mësuesin ndihmës, por edhe japin udhëzimet e nevojshme për hartimin e planit edukativ individual që do të ndjekë çdo fëmijë me aftësi të kufizuara. Ka pasur përpjekje serioze gjatë viteve të fundit nga organizata "Save the Children" dhe shoqata MEDPAK, në disa rajone të vendit, për fuqizimin e komisioneve me bazë drejtorie arsimore ose zyre arsimore. Këto organizata në bashkëpunim me MAS dhe DA/ZA, në disa rajone të vendit kanë mbështetur zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

146. Gjatë viteve të fundit, Ministria e Arsimit dhe Instituti i Zhvillimit të Kurrikulave kanë rishikuar kurrikulat parashkollore dhe shkollore, në mënyrë që ato të jenë të hartuara në një gjuhë gjithëpërfshirëse. Megjithatë, ende ka shumë për të bërë në drejtim të përshtatjes së të gjithë teksteve shkollore në teknikën brail.

147. Ministria e Arsimit dhe Sportit vijon punën për evidentimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara jashtë sistemit arsimor, duke synuar tërheqjen e tyre në shkollë, në moshën e detyrimit shkollor. MAS krijon kushtet dhe mundësitë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara në moshë të rritur, që dëshirojnë të fitojnë arsimin e detyruar, të regjistrohen në shkolla me kohë të shkurtuar.

148. Aftësimi profesional i mësuesve për mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara është rritur dhe përfshin nivelet e mësuesve kandidatë dhe mësuesve në detyrë. Kuadri ligjor në fuqi parashikon si nevojë të ngutshme rishikimin e kurrikulës universitare për studentët e mësuesisë dhe zgjerimin e njohurive dhe aftësive për mësuesit

[71]Sipas Censusit 2011, burimi INSTAT.
[72]http://www.instat.gov.al
[73]Njësitë arsimore vendore janë drejtoritë arsimore, në nivel qarku, dhe zyrat arsimore, në nivel rrethi.

[74] Dispozitave Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar, Nr.343, datë 19.08.2013.

e arsimit të zakonshëm dhe atij të specializuar. Përgatitja profesionale për specialistët e arsimit, si edhe modulet e trajnimit po planifikohen dhe zbatohen në programet e MAS. Udhëzimi i ministrit të Arsimit nr. 38, datë 7.10.2014, "Për kriteret e punësimit të mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike te arsimit parauniversitar", i vjen në ndihmë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e arsimit bazë.

149. Në përgjithësi, infrastruktura ekzistuese dhe mjedisi fizik në shkolla nuk është i përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sipas një studimi[75], vetëm 35% e godinave të kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare i plotësojnë kushtet për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në pjesën më të madhe të shkollave, kjo përshtatje e infrastrukturës ka konsistuar me vendosjen e rampave në hyrjen e shkollës dhe vetëm në katin e parë, por jo në katet e tjera të shkollës. Klasat nuk riorganizohen për t'u bërë më të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe kanë numër të madh nxënësish, veçanërisht në qytetet e mëdha.

150. Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe shoqërinë civile, përmes politikave e masave që synojnë sigurimin e së drejtës për pjesëmarrje në arsim, masave për përmirësimin e cilësisë së arsimit, po ashtu edhe përmes planeve të integruara me institucione të tjera përgjegjëse në këtë fushë, ka punuar në drejtim të zhvillimit të arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës.

151. Shqipëria është e ndërgjegjshme që pavarësisht të gjitha masave të marra, situata e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në vend ka qenë dhe është gjithmonë një ndër sektorët më problematikë, që ndikon negativisht në integrimin e fëmijës në shoqëri, në aktivitete të jetës së përditshme, si edhe në tregun e punës në të ardhmen.

Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në qendrat e përkujdesjes sociale

152. Udhëzimi nr. 38, datë 13.08.2013 "Për arsimimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e përkujdesjes shoqërore" përcakton se individët që janë nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes shoqërore, arsimohen me kohë te plotë ose të pjesshme në shkollën më të afërt me institucionin përkujdesës ose në një shkollë të arsimit publik të caktuar nga DAR/ZA-ja përkatëse. Ky udhëzim detyron çdo institucion të përkujdesjes shoqërore, publik ose privat, të njoftojë DAR/ZA-në përkatëse për çdo përfitues të shërbimeve shoqërore që nuk ndjek arsimin e detyrueshëm. DAR/ZA-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social, identifikon fëmijët që janë përfitues të shërbimeve të institucioneve të përkujdesjes shoqërore. Kur përfituesi i përkujdesjes shoqërore është në moshën e detyrimit shkollor, DAR/ZA-ia cakton shkollën ku fëmija do të regjistrohet. Regjistrimi mund të bëhet në çdo kohë. Kur përfituesi i përkujdesjes shoqërore nuk është në moshën e detyrimit shkollor, institucioni përkatës i përkujdesjes shoqërore dhe DAR/ZA-ja, bashkëpunojnë për ta regjistruar përfituesin në një shkollë të arsimit bazë me kohë të pjesshme.

153. Një nga sfidat në punën për plotësimin e parametrave psiko-socialë të fëmijëve në qendrat e zhvillimit është vështirësia e zbatimit të filozofisë gjithëpërfshirëse në arsimin publik apo privat. Pengesat për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës për këtë kategori fëmijësh lidhen edhe me qëndrimin e specialistëve në përqasjen e filozofisë së gjithpërfshirjes dhe përgatitjes e aftësimit të këtyre personave për jetën.

154. Ka përpjekje konkrete në aplikimin programeve specifike për disa fëmijë të qendrave të zhvillimit në shkollat speciale në komunitet apo pranë qendrave ditore. Në çdo qendër zhvillimi, personeli përfshin mësues dhe edukatorë zhvillimi të specializuar sipas profesioneve përkatëse si dhe specialistë të tjerë si: psikolog, punonjës social, logopedist, fizioterapist etj. Si rrjedhojë, shërbimi që ju ofrohet përfituesve në qendrat rezidenciale ofrohet në mënyrë profesionale duke pasur prioritet plotësimin e nevojave sipas rastit.

Arsimi i lartë për personat me aftësi të kufizuara

155. VKM nr. 517, datë 01.08.2014 përcaktoi kriteret për pranimin në institucionet e arsimit të lartë, për ciklin e parë (*bachelor*) dhe VKM nr. 668, datë 15.10.2014, përcaktoi kriteret për ciklin e dytë (*master's degree*) në institucionet e arsimit të

[75] Studimi analitik "Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me AK në Shqipëri", Njësia e Menaxhimit të Projektit në bashkëpunim me *Save the Children* dhe MAS.

lartë, për personat që nuk shikojnë dhe për ata që kanë statusin e paraplegjikut dhe tetraplegjikut. Për ciklin e parë u akorduan 15 kuota për studentët që nuk shikojnë, 15 për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, për ciklin e dytë u akorduan15 kuota për studentët që nuk shikojnë, 15 për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, 20 për romët dhe ballkano-egjiptianët dhe 15 për jetimët (në total 65 kuota). Për ciklin e dytë u akorduan 15 kuota për studentët që nuk shikojnë; 15 për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë; 15 për romët dhe ballkano-egjiptianët; 15 për jetimët (në total 60 kuota).

156. Referuar të dhënave sipas tabelave të shpallura në faqen e publikimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, konstatojmë se në ciklin e parë të studimeve u përzgjodhën 42 fitues (23 djem dhe 19 vajza) përkatësisht në degët drejtësi, histori, psikologji, punë sociale, menaxhim, financë kontabilitet, administrim biznesi, arkitekturë dhe informatikë ekonomike,të ndara sipas kategorive për vitin akademik 2014-2015. Në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional/Master i Shkencave/Master i Arteve të Bukura", me kohë të plotë, për vitin akademik 2014-2015, nga 12 studentë fitues (6 djem dhe 6 vajza) të ndara sipas kategorive. 2 (dy) studentë të verbër (1 djalë dhe 1 vajzë) janë fitues për programin e studimit Master i Shkencave pranë Universitetit të Tiranës, në degët marrëdhënie ndërkombëtare dhe drejtësi.

157. Sipas udhëzimeve përkatëse, kandidatët aplikuan direkt në MAS për kuotat e parashikuara për vitin 2014- 2015. Për të qenë sa më korrekt dhe transparent, për herë të parë MAS-i, për vitin akademik 2014-2015 zbatoi procedurën e intervistave me gojë pas aplikimit me dosjet e tyre pranë MAS. Por këtu përjashtohen një numër personash me aftësi të kufizuara që nuk gëzojnë statuset e mësipërme Në universitetet publike të vendit janë rishikuar kurrikulat e përgatitjes fillestare të mësuesve. Në degët e Shkencave Sociale dhe Mësuesisë zhvillohen lëndë apo module të veçanta për aftësinë e kufizuar, si dhe ka programe të veçanta studimi të përgatitjes së profesionistëve që do të punojnë me fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara. Pranë Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, në vitin akademik 2011-2012 është hapur program i Masterit Profesional "Pedagogjia e specializuar sociale".

Neni 25 – Shëndetësia

158. Kuadri ligjor për shëndetësinë parashikon një sërë masash specifike për personat me aftësi të kufizuara, si: i) masa kundër diskriminimit dhe që u sigurojnë personave me aftësi të kufizuara të njëjtin akses në shërbimet cilësore shëndetësore, përfshirë edhe në fushën e shëndetit seksual dhe atë riprodhues; ii) masa për të siguruar akses në rehabilitimin shëndetësor të lidhur me aftësitë e tyre të kufizuara në komunitetin e tyre dhe pa kosto financiare; iii) shërbime shëndetësore për zbulimin e hershëm dhe programet e ndërhyrjes, sipas rastit, për të parandaluar dhe minimizuar shfaqjen e aftësisë së kufizuar dytësore, duke i kushtuar vëmendje fëmijëve, grave dhe të moshuarve, përfshirë këtu edhe ata në zonat rurale; iv) trajnimi i mjekëve dhe profesionistëve të tjerë të shëndetit mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe ata në zonat rurale. Trajtimi dhe kujdesi shëndetësor iu ofrohet personave me aftësi të kufizuara mbi bazën e pëlqimit të tyre të lirë dhe të informuar.

159. Përsa i përket kujdesit mbi shëndetin mendor për personat çrregullime të shëndetit mendor, përfshirë edhe personat me aftësi të kuafizuara mendore, në reflektim të masave të mësipërme, në ligjin nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor" ka parashikime specifike, përkatësisht nenet 1, 2 , 4, 5, 6, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 të këtij ligji. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor" në vitin 2012, Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me organizma që veprojnë në fushën e shëndetit mendor si Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe Fondacioni për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri (SOROS) kanë organizuar përgjatë vitit 2013 disa sesione informimi me profesionistë të shërbimeve të shëndetit mendor mbi kuadrin e ri rregullator, të drejtat e personave me çrregullime të shëndetit mendor, përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara mendore, ku një moment i rëndësishëm ishte ndalimi i shtrimeve në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, të personave me çrregullime të shëndetit mendor, me qëllim vlerësimin e aftësisë për punë, për trajtimin të vullnetshëm, dhe trajtimin e pavullnetshëm (neni 19/5, neni 20/4 i ligjit 44/2012). Ky ligj sanksionon qasjen komunitare të shërbime të shëndetit mendor, me qëllim shmangien e institucionalizimit, shërbime komunitare të cilat

ofrojnë veprimtari parandaluese, kuruese dhe rehabilituese për personat me çrregullime të shëndetit mendor (neni 13). Duhet theksuar se qendrat e shëndetit mendor janë ngritur dhe funksionojnë vetëm në qytete të mëdha, në nivel qarku, por Plani i Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri (2013-2022) parashikon plotësimin e të gjitha rajoneve/qarqeve me sistemin e integruar të shërbimeve të shëndetit mendor. Bazuar në Paketën Bazë të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe sistemin e referimit, shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor ofron zbulim/identifikim të hershëm, referim dhe ndjekje të personave me çrregullimeve të shëndetit mendor (ligji nr. 44/2012, neni 11).

160. Në kuadër të reformimit të kuadrit rregullator të aftësisë së kufizuar në tërësi, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë ka ngritur një grup pune me mjekë specialistë të nivelit terciar për të rishikuar kriteret e përcaktimit të aftësisë së kufizuar. Përcaktimi i ri do të jetë i përshkallëzuar duke përfshirë aspektin biologjik të dëmtimit trupor, atë psikologjik të individit dhe barrierat sociale me të cilat përballohen personat me aftësi të kufizuara.

Shërbimi shëndetësor në institucionet e vuajtjes së dënimit penal

161. Shërbimi shëndetësor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale organizohet pa diskriminim për shkak të statusit ligjor të personit ose për ndonjë arsye tjetër që mund të shërbejë për diskriminim. Në muajin prill 2014 janë miratuar disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", sipas të cilit të dënuarit dhe të paraburgosurit përfitojnë pa pagesë të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor.

162. Qeveria shqiptare është e angazhuar të forcojë bashkëpunimin ndërinstitucional për të siguruar standarde bashkëkohore në trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në sistemin e burgjeve. Një memorandum bashkëpunimi është nënshkruar midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, në muajin korrik 2014. Kjo marrëveshje ka bërë të mundur ofrimin e shërbimeve të specializuara mjekësore në qendrat spitalore shtetërore dhe private jashtë sistemit të burgjeve, edhe për kategorinë e personave më aftësi të kufizuar, sipas diversitetit të tyre. Zbatimi i kësaj marrëveshje dhe udhëzuesit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në zbatim të kësaj marrëveshje, kanë zgjidhur problemin e furnizimit me medikamente mjekësore, dhe bërjen e konsultave mjekësore dhe psikiatrike në të gjitha spitalet rajonale për të burgosurit e të paraburgosurit, përfshi ata me aftësi të kufizuara

163. Njëkohësisht, është bërë i mundur realizimi i ekzaminimeve laboratorike, endoskopike, imazherike dhe çdo ekzaminim tjetër të nevojshëm, në spitalet e rajonit dhe në qendrat spitalore universitare, sipas legjislacionit në fuqi. Kjo marrëveshje ka bërë të mundur ofrimin e shërbimeve të specializuara mjekësore në qendrat spitalore shtetërore dhe private jashtë sistemit të burgjeve, edhe për kategorinë e personave më aftësi të kufizuar, sipas diversitetit të tyre. Të dënuarit dhe të paraburgosurit përfitojnë pa pagesë të gjitha shërbimet, që ofron skema e sigurimit shëndetësor. Në zbatim të ligjit për trajtimin e të burgosurve është nënshkruar kontrata tripalëshe, midis drejtorive rajonale të sigurimit të kujdesit shëndetësor - IEVP - depo farmaceutike, për rimbursimin e medikamenteve.

Neni 26 - Aftësimi dhe rehabilitimi

164. Shqipëria ka bërë përpjekje për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të arrijnë dhe të ruajnë pavarësinë e tyre maksimale, aftësinë e plotë fizike, mendore, shoqërore dhe profesionale, dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e plotë në të gjitha aspektet e jetës. Për këtë qëllim, janë ngritur dhe funksionojnë disa shërbime aftësuese dhe rehabilituese gjithëpërfshirëse. Por këto shërbime rehabilituese në shumicën e rasteve nuk funksionojnë; janë të kufizuara në numër dhe shpesh të paaritshme nga një pjesë e madhe e personave me aftësi të kufizuara. Ata detyrohen t'u referohen shërbimeve private për të plotësuar nevojat e tyre. Sfidë mbetet aftësimi dhe rehabilitimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara.

165. Në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi për shëndetin mendor (Dokumenti Politik për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor, 2003 dhe të Planit të Veprimit të Zhvillimit të Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri, 2013–2022, ligji nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor", Rregullorja e Shërbimeve të Shëndetit Mendor 2013 dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim

të ligjit për shëndetin mendor) personave me çrregullime të shëndetit mendor ndër ta edhe persona me aftësi të kufizuara mendor iu ofrohen shërbime të karakterit aftësues dhe rehabilitues nga shërbimet komunitare të shëndetit mendor, si Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor (shërbime ambulatore) dhe Shtëpitë e Mbështetura (shërbime rezidenciale).

166. Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor (QKSHM) janë shërbime ambulatore të specializuara të shëndetit mendor, të cilat ofrojnë shërbime multidisiplinare / multidimensionale në nivel komunitar. QKSHM-ja ushtron aktivitete identifikuese, diagnostikuese, trajtuese, rehabilituese për çdo person që vuan nga çrregullime mendore dhe luan rol parandalues të çrregullimeve dhe promovues të shëndetit mendor pozitiv në zonen e saj të mbulimit.

167. Shtëpitë e mbështetura janë njësi funksionale të shërbimeve të shëndetit mendor, të cilat kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve rezidenciale për individët në një ambient sa më të ngjashëm me atë familjar, ku qëllimi kryesor është përkujdesja dhe rehabilitimi i individëve me një sëmundje mendore. Procesi i rehabilitimit kryhet nëpërmjet planit individual të bazuar në vazhdimësinë terapeutiko-riaftësusese, dhe nëpërmjet strehimit pjesërisht apo tërësisht të mbeshtetur me personel. Shtëpitë e mbështetura janë pjesë e rrjetit të shërbimeve të shëndetit mendor komunitar në marrëdhënie me shërbime të tjera shëndetësore e shoqërore të zonës përkatëse. Këto struktura bashkëpunojnë me komunitetin të cilit i përkasin.

Neni 27 – Puna dhe punësimi

168. Kuadri ligjor i brendshëm garanton të drejtën për punësim të personave me aftësi të kufizuara dhe përfshin masa të veçanta mbështetëse për nxitjen e punësimit për kategori të veçanta, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara. Legjislacioni parashikon masa për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit dhe krijon lehtësira për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara.

169. Kushtetuta parashikon të drejtën për të fituar mjetet e jetesës nëpërmjet një pune të ligjshme, të zgjedhur prej shtetasit apo që ai e pranon vetë. Kjo e drejtë parashikohet për të gjithë shtetasit, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon të drejtat dhe detyrimet që kanë punëdhënësit dhe punëmarrësit, lidhur me çështjet e diskriminimit. Çdo punonjës që pretendon se ka pësuar diskriminim, në bazë të këtij ligji, ka të drejtën e ankimimit te punëdhënësi, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe, gjithashtu, në gjykatë. Ky ligj sjell një risi shumë të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara, atë të përshtatjes së arsyeshme[76].

170. Kodi i Punës ndalon diskriminimin në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit, kontraktuar parashikon se "kanë të drejtë të lidhin kontratë pune dhe personat me zotësi të kufizuara juridike për të vepruar, por të autorizuar shprehimisht ose në heshtje për të kryer punë nga përfaqësuesi i tyre ligjor."

171. Në projektligjin mbi disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Punës[77] parashikohen edhe shkaqe të tjera, që ndalojnë diskriminimin në punësimin dhe formimimin profesional dhe përkufizimi i diskriminimit është në përputhje me Kushtetutën, ligjin kundër diskriminimit dhe direktivat e BE-së. Barra e provës i lihet punëdhënësit, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për të respektuar parimin e mosdikriminimit. Në projektligj parashikohet konkretisht se: "punëdhënësi është i detyruar të sigurojë përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara". Për të siguruar përshtatjen e arsyeshme punëdhënësi duhet të bëjë modifikime dhe rregullime të nevojshme dhe të përshtatshme, që nevojiten në raste të veçanta dhe që nuk imponojnë një barrë të tepruar për të, për t'u garantuar këtyre personave gëzimin ose ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, të së drejtës për punësim dhe profesion. Mohimi i përshtatjes së arsyeshme nga ana e punëdhënësit përbën diskriminim. Në rastin kur një person pretendon se ai/ajo është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë, ndiqet procedura e ankimimit, e përcaktuar në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Kur çështja paraqitet për shqyrtim në gjykatë dhe paditësi paraqet fakte, nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar, i padituri duhet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë apo se ka pasur cenim të parimit të trajtimit të barabartë.

[76] Referim informacionit më sipër mbi nenin 9.
[77] Projektligj i miratuar nga Këshilli i Ministrave.

172. Ligji për ndihmën dhe shërbimet shoqërore (neni 11/2) garanton një periudhë tranzicioni prej 24 muajsh, gjatë së cilës personat me aftësi të kufizuara, nuk humbasin përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, ndërkohë që ata punësohen me kontratë të rregullt pune e paguhen për punën që bëjnë.

173. Ligji për nxitjen e punësimit parashikon se çdo punëdhënës publik dhe subjekt privat, ku ka të punësuar më tepër se 24 punonjës, është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 25 punonjës të personelit të tij. Sipas këtij ligji, çdo punëdhënës publik dhe subjekt privat që punëson persona me aftësi të kufizuara, gëzon të drejtën për të kërkuar subvencion nga zyra e punës për përshtatjen e vendit të punës, në mënyrën më funksionale për punëmarrësin. Edhe pse ekzistojnë këto parashikime ligjore nuk janë aplikuar asnjëherë gjobat për punëdhënësit që nuk kanë punësuar persona me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, paga e personave me aftësi të kufizuara përjashtohet nga taksat deri në një masë që caktohet nga Këshilli i Ministrave, por Këshilli i Ministrave nuk e ka caktuar ende masën e përjashtimit për pagën e personave me aftësi të kufizuara

174. Vendimi i Këshillit të Ministrave për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara[78] ofron iniciativa e fonde që nxisin punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Kështu, punëdhënësit përfitojnë financim mujor për të realizuar përshtatjen e arsyeshme të personit me aftësi të kufizuara. Sipas këtij programi, kur punëdhënësi punëson një person me aftësi të kufizuara, ky i fundit merr një financim mujor në masën 100% të pagës minimale në shkallë vendi për gjashtë muajt e parë të punësimit, deri në 50% për gjashtë muajt e dytë të punësimit dhe nuk e humbet pagesën që përfiton për shkak të aftësisë së kufizuar. Zyrat e punës financojnë formimin profesional të personave me aftësi të kufizuara për një periudhë jo më shumë se 6 muaj. Drejtoria rajonale e sigurimeve shoqërore derdh kontribut për sigurimin nga aksidentet në punë, në masën 0.3% të pagës minimale sipas procedurave përkatëse.

175. Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) "Për programin e nxitjes së punësimit për punëkërkueset femra"[79] parashikon që në rastin e punësimit të femrave rome, vajza nëna, femrave të divorcuara, me probleme sociale dhe femrave me aftësi të kufizuara, shteti financon sigurimet e detyrueshme të punëdhënësit. Përveç kësaj, niveli i përfitimit shtohet deri në nivelin e katër pagave minimale për kontratat e punës njëvjeçare, gjashtë paga për kontratat dyvjeçare dhe tetë paga për kontratat 3-vjeçare.

176. Ligji "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"[80], në nenin 5 të tij përcakton si përfitues dhe grupet e veçanta. Si pjesë e tyre konsiderohen edhe personat me aftësi të kufizuara, të cilët dëshirojnë riaftësim profesional. Në udhëzimin nr. 2222, datë 31.10.2002 "Mbi këshillimin dhe orientimin profesional për kursantët" janë hequr tarifat e regjistrimit për disa grupe ku bëjnë pjesë dhe personat me aftësi të kufizuara. Por nga ana tjetër, qendrat janë të papajisura me kurrikula, profesionistë, si dhe janë të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

177. Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", mbështet përfshirjen sociale në të gjitha aspektet e jetës së personave me aftësi të kufizuara përfshirë edhe punësimin. Në nenin 5 të këtij ligji që trajton të drejtën për jetesë të pavarur theksohet se jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, duke përfshirë edhe aksesin në punësim.

178. Ligji "Për statusin e të verbrit" parashikon që shteti siguron punësimin në kushte të favorshme e me përparësi për profesionet e mbrojtura me ligj. Të verbrit që janë pushuar apo e kanë humbur punën për arsye të ndryshme duhet të risistemohen në punë dhe gjatë periudhës së ndërmjetme marrin një shpërblim të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Por pavarësisht kësaj, numri i personave të verbër të punësuar është në nivele tepër të ulëta.

179. Ligji "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", mundëson që personat juridikë shtetërorë dhe privatë që punësojnë të sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë përfitojnë çdo vit kalendarik ulje tatimi mbi fitimin. Nga ana tjetër të gjithë personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë

[78]VKM nr .248, datë 30.4.2014.

[79]Vendimi nr. 632 datë18.09.2003.

[80]Ligji nr 8872, datë 29.03.2002

statusin e para - dhe tetraplegjikut dhe statusin e të verbrit kanë të drejtën për të përfituar nga lehtësitë fiskale në rast se vetëpunësohen, por kjo e drejtë në realitet nuk zbatohet. Personave me aftësi të kufizuara në raste punësimi nuk u ndërpriten pagesat e aftësisë së kufizuar deri 24 muaj nga punësimi i tyre.

180. Në bazë të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim për shkak të aftësisë së kufizuar, ku përfshihet: a) shpallja e vendeve të lira të punës; b)rekrutimi dhe përzgjedhja e punëmarrësve; c) trajtimi i punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

181. Në kuadër të ndryshimeve që po i bëhen Kodit të Punës dhe me qëllim harmonizimin e parashikimeve ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi, KMD-ja ka rekomanduar përfshirjen në Kodin e Punës të aftësisë së kufizuar si shkak diskriminimi, përfshirjen e të gjitha formave të diskriminimit të parashikuara nga ligji për mbrojtjen nga diskriminimi dhe, veçanërisht, *"mohimin e përshtatjes së arsyeshme,"* si një formë e veçantë diskriminimi, duke parashtruar edhe dispozita të posaçme për detyrimin e punëdhënësve për të realizuar përshtatjet e arsyeshme të vendit të punës për punëmarrësit me aftësi të kufizuara.

182. Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara i ka kushtuar disa objektiva punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (2014 – 2020) ka parashikuar nevojën për politika të posaçme, në përshtatje me karakteristikat dhe specifikat në fushën e arsimit, kualifikimit profesional, fuqizimit dhe punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Neni 28 – Standardi i përshtatshëm i jetesës dhe mbrojtja shoqërore

183. Shqipëria ka ndërmarrë një sërë masash për zbatimin e së drejtës së personave me aftësi të kufizuara për një standard të përshtatshëm jetese për ta dhe për familjet e tyre, përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin e përshtatshëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës pa diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

Strehimi

184. Ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit", ndryshuar me ligjin nr. 54/2012, parashikon që personat me aftësi të kufizuara kanë përparësi për të përfituar nga programet e strehimit social. Në kuptim të këtij ligji, personat me aftësi të kufizuara janë kategoritë e përcaktuara në VKM-në nr. 526, datë 6.8.2015, dhe që përfshihen në ligjin "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", ligjin "Për statusin e invalidit", ligjin "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar". Personat me aftësi të kufizuara kanë përparësi në përfitimin e ndihmës së shtetit për subvencionimin e qirasë ose të subvencionimit të interesave të kredisë.

185. Ligji "Për programet sociale të strehimit" dhe udhëzimi nr. 6257 datë 2.9.2008 (i ndryshuar 17.02.2011) "Mbi përcaktimin e masës së sunvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti", ku përcaktohen kushte favorizuese për PAK-un. Në zbatim të tij është miratuar VKM-ja nr. 526, datë 6.8.2014, "Për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara që trajtohen me përparësi si përfitues të programeve sociale të strehimit", i cili ka përcaktuar brenda kategorive të personave me aftësi të kufizuara, grupet që do të trajtohen me përparësi për strehim. Këto grupe janë: a) Të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët, sipas kritereve mjekësore, janë të paaftë për punë në kushte normale; b) Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen me vendim të të komisionit përkatës (KMCAP) se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha; c) Personat me aftësi të kufizuara, të cilët deklarohen të paaftë për punë, me vendim të KMCAP-së; ç) Personat të cilët janë deklaruar invalidë pune, me vendim të KMCAP-së, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas statusit të invalidit të punës.

186. Personat me aftësi të kufizuara mbështetur në VKM-në nr. 527, datë 6.8.2014, përfitojnë edhe një grant të menjëhershëm, deri në 10% të vlerës së

banesës së përfituar[81]. Kjo është një tjetër dëshmi e përpjekjeve të Shqipërisë për të garantuar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për një standard të përshtatshëm jetese dhe mbrojtje sociale. Mbështetur në aktet ligjore në fuqi, Enti Kombëtar i Banesave në të gjitha ndërtimet zbaton masat për heqjen e barrierave në ndërtesa për personat me aftësi të kufizuar, si dhe vendosjen e aksesoreve ndihmës për lehtësimin e lëvizjes së kësaj kategorie. Gjithashtu, këto masa dhe lehtësira janë zbatuar edhe gjatë ndërtimit të banesave sociale me qira në 8 bashki të vendit.

187. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 488, datë 22.7.2014, "Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore pa leje me funksionim banimi apo të përzier të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës dhe afateve të pagesës", ka parashikuar kushte favorizuese për legalizimin e ndërtimeve pa leje, të cilat janë në pronësi të personave me aftësi të kufizuara. Të dhënat statistikore në lidhje me situatën e strehimit të personave me aftësi të kufizuara përfitues të programeve të strehimit mungojnë.

Mbrojtja sociale

188. Personat me aftësi të kufizuara përfitojnë nga programet e mbrojtjes sociale (shih më lart seksionin për masat e veçanta sipas nenit 5), si dhe shërbime në qendra të përkujdesjes shoqërore.

Shërbimet shoqërore për personat me aftësi të kufizuara

189. Aktualisht në Shqipëri funksionojnë 28 shërbime shoqërore për personat me aftësi të kufizuara, ndër të cilat 12 qendra rezidenciale (6 qendra rezidenciale janë publike dhe 6 janë jopublike), 14 qendra ditore (7 qendra ditore janë publike dhe 7 janë jopublike) dhe 2 qendra komunitare jopublike.

190. Nga shërbimet rezidenciale dhe ditore përfitojnë shërbime 1437 persona me aftësi të kufizuara, nga të cilët 461 persona përfitojnë nga shërbimet publike dhe 976 nga shërbimet jopublike; 387 persona përfitojnë shërbim rezidencial dhe 1050 shërbim ditor. Prej këtyre, 427 janë fëmijë me aftësi të kufizuara, prej të cilëve 218 marrin shërbime publike, ndërsa 209 shërbime jopublike. Edhe pse këto shërbime ekzistojnë, shpërndarja gjeografike e tyre është jo e përshtatshme dhe e pamjaftueshme për të mbuluar nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Sigurimet shoqërore

191. Për trajtimin me të ardhura dhe forma të tjera mbështetjeje të personave me aftësi të kufizuara, ISSH e mbështet veprimtarinë e tij, në këto dispozita ligjore dhe nënligjore:

- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH-së", i ndryshuar. Qëllimi i këtij ligji është të mbrojë me të ardhura personat e punësuar në lidhje me paaftësinë e përkohshme në punë për shkak të sëmundjes, invaliditetit, aksidentimit në punë dhe sëmundjet profesionale dhe personat e tjerë ekonomikisht aktivë në lidhje invaliditetin. Dispozitat në lidhje me këto përfitime janë të parashikuara në pjesën e pestë të ligjit të sipërcituar dhe konkretisht: E ardhura për sëmundje (nenet 20- 25); pensionet (nenet 30, 35-39); pagesat për sigurimin nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale (nenet 43-51);
- Ligji nr. 7889/1994 "Për statusin e invalidëve", i ndryshuar;
- Ligji nr. 7663/1993 "Për statusin e invalidit të Luftës Kundër Pushtuesve Nazifashistë";
- VKM nr. 788/2015 "Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës"[82];
- VKM nr. 788/2015 "Për përcaktimin e sëmundjeve profesionale";
- VKM nr. 869/2008 "Për zbatimin e ligjit për "Statusin e invalidit"".
- VKM nr. 326/1993 "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës".
- Rregullorja "Për lëshimin e raporteve mjekësore për paaftësi të përkohshme në punë"[83]
- Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-së[84]
- Rregullorja për zbatimin e ligjit nr. 7889, "Për statusin e invalidëve të punës" [85]
- Rregullorja "Për kujdes mjekësor shtesë dhe

[81] Bazuar në VKM-në nr. 527, datë 6.8.2014, "Për procedurat kriteret dhe përparësitë për përfitimin e grantit të menjëhershëm".

[82]VKM nr. 788, datë 12.4.2005, "Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës".

[83]Rregullore nr. 494, datë 5.10.1994, "Për lëshimin e raporteve mjekësore për paaftësi të përkohshme në punë".

[84]Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-eve, datë 30.5.2005

[85]Rregullorja nr. 7, datë 24.12.2009, "Për zbatimin e ligjit nr. 7889, "Për statusin e invalidëve të punës", e ndryshuar", e ndryshuar.

riaftësim, përfitim të vogël dhe kompensime për dëmtime në masë të arsyeshme”[86].

192. Pas viteve ‘90, si rezultat i mbylljes së ndërmarrjeve shtetërore dhe kooperativave bujqësore, u rrit në mënyrë të menjëhershme numri i individëve të papunë. Shumë prej tyre, të cilët nga pikëpamja shëndetësore përbënin objekt për invaliditet dhe kishin kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore, mbeteshin të pambuluar me të ardhura për shkak të kushteve ligjore për të përfituar pensionin e invaliditetit. Për këtë arsye, në vitin 2005, ligji i sigurimeve shoqërore pësoi ndryshime të rëndësishme lidhur me kushtet ligjore të përfitimit të pensioneve të invaliditetit, duke hequr kriteret bazë, siç ishin të qenit i siguruar në momentin e fillimit të invaliditetit dhe minimumi i periudhës kontributive.

193. Ndryshimet ligjore sollën një rritje të dukshme të numrit të personave që përfitojnë pension invaliditeti nga sigurimet shoqërore. Kështu efektet e ndryshimeve ligjore të vitit 1993, për 10-vjeçarin e parë 1994 - 2004, janë reflektuar në rritje me 27.8 % të numrit të invalidëve të qytetit dhe në ulje me 32.8% të pensioneve të invaliditetit të fshatit, ndërkohë që në total numri i pensioneve të invaliditetit për këtë hark kohor është rritur me 12.8%. Nga 21766 pensione invaliditeti urbane që ishin në vitin 1994, numri i tyre arrit në 27809 në vitin 2014, ndërkohë që numri i pensioneve të invaliditetit rural nga 4748 që ishte në vitin 1994, arriti në 3576 në vitin 2004. Në total numri i pensioneve të invaliditetit nga 26514 që ishte në vitin 1994, arriti në 31385 në vitin 2004. Shpenzimet për këto përfitime nga viti 1994 në 2004 u pesëfishuan.

194. Gjatë periudhës 2004 - 2014, numri i pensioneve të invaliditetit, si pasojë e këtyre ndryshimeve apo liberalizimeve, u rrit në mënyrë të ndjeshme dhe në vitin 2014 u rrit me 221.4 %, në krahasim me vitin 2004. Kështu, numri i pensioneve urbane të invaliditetit u rrit nga 27809 në vitin 2004, në 61908 në vitin 2014, duke u rritur kështu me 222.6%. Numri i pensioneve rurale të invaliditetit u rrit nga 3576 që ishin në vitin 2004, në 7584 në vitin 2014, pra me 212,1%.

195. Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për sigurimet shoqërore në RSH”, parashikoi ndryshime në formulën e përllogaritjes së viteve të punës që i duhet një personi të siguruar për të përfituar pension invaliditeti. Konkretisht, periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa ¾ e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe, në 5 vitet e fundit para lindjes të së drejtës, të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror. Ndryshimet e fundit ligjore kanë pasur si qëllim incentivimin e qytetarëve që të rrisnin në mënyrë reale periudhat kontributive dhe masën e kontributeve në skemën e sigurimeve shoqërore. Formula e llogaritjes së përfitimeve është e njëjtë me atë të pensionit të pleqërisë, duke vendosur si dysheme për invalidët, 75% të pagës minimale në shkallë vendi të vitit të fundit të punës para momentit të fillimit të invaliditetit, me synim ruajtjen e nivelit të të ardhurave që kishin para fillimit të aftësisë së kufizuar. Formula e aplikuar është shoqëruar me parashikimin se tëgjithë invalidët nën moshën 50 vjeç, me kontribute deri në 15 vite, si rregull, përfitojnë pension të plotë invaliditeti, ndërsa ata që kanë më pak vite kontributive niveli i kërkesës për pension të plotë, marrin një pension të reduktuar në raport me vitet e punës.

Përfitime të tjera

196. Të gjithë personat me aftësi të kufizuara, që bëhen fizikisht ose psikikisht të paaftë dhe kanë nevojë për kujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër, përfitojnë shtesë për përkujdesje në masën 15% të bazës së vlerësueshme. Invalidët përfitojnë rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikantëve, invalidët që kanë mjete motorike për invalidë[87].Gjithashtu, këtë rimbursim e kanë përfituar edhe ata invalidë që, nëpërmjet procesit të çdoganimit, kanë çliruar nga detyrimi doganor autoveturë të siguruar nga vetë ata, në zbatim të rregulloreve të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Aktualisht, numri i personave që përfitojnë këtë të ardhur është 521 invalidë.

197. Personave me statusin e invalidit të punës, periudha e trajtimit me pension të plotë apo të pjesshëm invaliditeti, ju njihet si periudhë

[86]Rregullorja nr. 7, datë 16.6.1994 “Për kujdes mjekësor shtesë dhe riaftësim, përfitim të vogël dhe kompensime për dëmtime në masë të arsyeshme”

[87]Në zbatim të VKM nr. 723, datë 19.11.1998, “Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”.

sigurimi për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë dhe kontributet për këto periudha mbulohen nga buxheti i shtetit. Personat përfitojnë pensionin e invaliditetit, kur plotësojnë moshën për pension pleqërie, kanë të drejtën e zgjedhjes mes këtij të fundit dhe pensionit të invaliditetit dhe me plotësimin e moshës ata e ruajnë statusin e invalidit. Zakonisht ata preferojnë pensionin e invaliditetit, sepse favorizohen nga periudha më e vogël e kontributeve që kërkohet për kualifikim.

198. Trajtim të veçantë financiar të mbuluar nga buxheti i shtetit gëzojnë edhe invalidët e luftës, të cilët marrin një shtesë mbi pensionin e invaliditetit, masa e së cilës sot është mesatarisht 23,540 lekë në muaj. Numri i personave që trajtohen aktualisht me këtë përfitim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore është 134 invalidë. Në ndihmë të invalidëve të luftës të grupit të parë që kanë nevojë për shërbim, caktohet një person për shpërblim, masa e shpërblimit të të cilit caktohet nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga organet e pushtetit lokal. Nëse këta invalidë marrin statusin e të verbrit, paraplegjikut ose tetraplegjikut, personat që përfitojnë pension invaliditeti apo pleqërie, kanë edhe përfitime të tjera.

199. Ndryshimet në ligjin "Për taksat doganore"[88] parashikojnë përjashtimin nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura, si dhe nga pagimi i taksës së mjeteve të përdorura të transportit, në import dhe në shitje, autoveturat tip 4+1 vende dhe me cilindrate jo më shume se 2500 kubike, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve,invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që përfitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatës dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private.

200. Për të siguruar lehtësime në lëvizje për personat me aftësi të kufizuara, në ambientet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, janë krijuar kushte të përshtatshme duke u vendosur rampa apo janë krijuar mjedise me kushte të përshtatshme qëndrimi.

Neni 29 – Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Pjesëmarrja në jetën politike

201. Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", parashikon ndalimin e diskriminimit në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t'u zgjedhur dhe për t'u emëruar në një detyrë publike, për shkak të aftësisë së kufizuar.

202. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar udhëzimin "Për mënyrën e ngritjes dhe të caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet", sipas të cilit parashikohej detyrimi për vendosjen e qendrave të votimit në katin e parë të ndërtesave. Ky udhëzim i KQZ-së, përmirësoi ndjeshëm situatën ligjore të procesit të zgjedhjeve parlamentare të 23 qershorit 2013, por KMD-ja raporton se nga monitorimet e kryera rezultoi se KQZ-ja nuk kishte krijuar një procedurë apo një mekanizëm për të mbikëqyrur respektimin e vendosjes së qendrave të votimit në katet e para të vendndodhjeve apo godinave të përcaktuara si qendra votimi. Ka pasur tri raste të diskriminimit në 2014-n të personave me aftësi të kufizuara në të drejtën për të votuar.

Pjesëmarrja në jetën publike

203. Në disa qendra zhvillimi për fëmijët me aftësi të kufizuara organizohen takime periodike me prindër apo me organizata jofitimprurëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të tyre me aftësi të kufizuara. Organizata jofitimprurëse konsultohen dhe janë partnere në hartimin e politikave dhe të legjislacionit. Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara njeh shprehimisht në nenin 15 organizatat jofitimprurëse me të drejtë për t'u konsultuar. Ato janë: organizatat e personave me aftësi të kufizuara; organizatat për personat me aftësi të kufizuara; dhe organizatat që përfaqësohen në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar[89].

204. Organizatat e personave me aftësi të kufizuara janë çdo organizatë jofitimprurëse, ku personat me aftësi të kufizuara ose prindërit e tyre kanë shumicën e cilësuar në vendimmarrje. Ndërsa, organizatat për personat me aftësi të kufizuara janë organizata jofitimprurëse, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara dhe/ose kryejnë aktivitete në mbrojtje të interesave të këtyre personave e të familjeve të tyre. Nëse këto

[88] Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008.

[89] Referim informacionit të paraqitur më sipër, lidhur me mekanizmat institucionalë.

organizata pretendojnë se i është mohuar e drejta për t'u konsultuar apo se janë përjashtuar pa të drejtë nga proceset konsultuese, kanë të drejtë të ankohen, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik.

Neni 30 – Pjesëmarrja në jetën kulturore dhe sportive

205. Institucionet shqiptare kanë marrë masa për të garantuar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në jetën kulturore, për të zhvilluar dhe për të përdorur potencialin e tyre krijues, artistik dhe intelektual, njohjen dhe mbështetjen e identitetit të tyre specifik kulturor dhe gjuhësor, dhe për të marrë pjesë në veprimtari të kohës së lirë dhe veprimtari sportive në një mënyrë të barabartë me të tjerët. Kështu, në zbatim të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", me mbështetjen financiare të Ministrisë së Kulturës janë realizuar një sërë aktivitetesh të ndryshme, të cilat kanë qenë gjithëpërfshirëse, duke mos përjashtuar personat me aftësi të kufizuara.

206. Ministria e Kulturës ka mbështetur financimin dhe zbatimin e projektit: *"Laboratori i artit gjithëpërfshirës",* realizuar nga OJF "Art Link". Projekti u zhvillua në Durrës (maj – qershor 2014), me pjesëmarrjen e 80 personave me aftësi të kufizuara dhe zgjati 3 ditë. Gjatë këtij aktiviteti u realizuan disa seanca trajnimi për të aplikuar dhe për të përfituar nga fondet publike në mbështetje të artit dhe të kulturës.

207. Në projektligjin e ri "Për trashëgiminë kulturore", i cili është në proces hartimi, është parashikuar një nen i veçantë që detyron institucionet e trashëgimisë kulturore (materiale dhe jomateriale) për të siguruar akses dhe ndjekjen e aktiviteteve dhe shërbimeve të këtyre institucioneve për personat me aftësi të kufizuara. Për të lehtësuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete të ndryshme kulturore, janë vendosur tarifa të diferencuara të biletave[90], me qëllim mbështetjen e kësaj kategorie njerëzish, së bashku me shoqëruesit e tyre, për të parë dhe për të ndjekur aktivitetet e ndryshme kulturore dhe artistike që zhvillohen pranë qendrave të tyre të banimit.

208. Për të siguruar akses për *personat me aftësi të kufizuara* në aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike, Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me institucionet qendrore kulturore në vend, ka marrë masat e nevojshme për krijimin e infrastrukturës së posaçme për këta persona duke përfshirë: 1) ambientet hyrëse në institucionet kulturore qendrore; 2)ambientet e nevojshme brenda sallave artistike; 3) krijimin e çdo hapësire lehtësuese në institucionet kulturore qendrore për marrjen e një shërbimi sa më efikas për personat me aftësi të kufizuara.

209. Në Muzeun Historik Kombëtar dhe në Teatrin e Operës dhe Baletit janë instaluar rampat për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara. Në Muzeun Historik Kombëtar është investuar për vënien në funksionim të një ashensori të ri. Puna vijon për adresimin dhe orientimin e investimeve në ndryshime infrastrukturore edhe në institucionet e tjera kombëtare të artit dhe kulturës, si vendosja e rampave për lëvizjet në institucione dhe etiketave me alfabetin brail etj.

210. Personat me aftësi të kufizuara po përfshihen gjithnjë e më tepër në aktivitete fizike e sportive. Organizata "*Active Disabled People*" dhe Komiteti Olimpik janë anëtarë të Federatës Shqiptare të Sportit për të Gjithë dhe ushtrojnë aktivitet të rregullt prej disa vitesh. Komiteti Olimpik Special, i cili është, gjithashtu, anëtar i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, organizon veprimtari sportive për personat me aftësi të kufizuara mendore. Këto organizata zhvillojnë aktivitete sportive sipas një programi vjetor, ku më të spikatur janë "Kampionati i basketbollit me karroca" dhe pjesëmarrja në Javën Evropiane të Lëvizjes.

211. Qendrat e Zhvillimit, në mënyrë të vazhdueshme realizojnë aktivitete sportive e kulturore me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. Në vitin 2010, një grup fëmijësh i institucioneve rezidenciale u përfaqësuan në "Festivalin e Gjimnastradës Danc për të gjithë" dhe u vlerësuan me kupën e festivalit për ekipet me aftësi të kufizuara. Organizimi i ekspozitave me punimet e fëmijëve me aftësi të kufizuara është bërë ritual i përvitshëm në të gjitha qendrat e zhvillimit dhe këto punime janë vlerësuar nga specialistë të fushës dhe kanë marrë çmime të ndryshme.

[90]VKM nr. 776, datë 14.12.2005, "Për vendosjen e çmimeve të reduktuara të biletave të muzeve publike për kategori të caktuara shoqërore".

TË DREJTA E VAJZAVE, DJEMVE DHE GRAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 6- Gratë me aftësi të kufizuara

212. Shqipëria e ka ratifikuar konventën e OKB-së "Për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave". Të gjitha gratë me aftësi të kufizuara në Shqipëri kanë të drejtë që të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me burrat. Kushtetuta e Shqipërisë dhe ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë.

213. Sipas censusit të popullsisë së vitit 2011, 54,7% e 137435 personave mbi 15 vjeç, të cilët raportuan të kenë pasur një lloj të aftësisë së kufizuar, janë femra. Aftësia e kufizuar është më e lartë në moshat e vjetra dhe personat me moshë të vjetër më së shumti janë femra. Në nivel qarku, prevalencën më të lartë të aftësisë së kufizuar e ka Gjirokastra me 8,0%. Raportet[91] tregojnë se gratë në krahasim me burrat kanë më pak mundësi punësimi, u mungojnë aftësitë profesionale, janë më pak të arsimuara, apo nuk kanë punuar asnjëherë gjatë jetës së tyre. Gratë me aftësi të kufizuara vlerësuan si pengesa për punësimin e tyre paragjykimet e punëdhënësve, kufizimet dhe ndrydhjen që buron nga familja, mungesën e akomodimit të arsyeshëm. Megjithatë, ka raste që gratë me aftësi të kufizuara janë të përfaqësuara në nivelet më të larta vendimmarrëse në qeveri. Por, shumë përpjekje mbeten ende për t'u bërë për përfshirjen e grave me aftësi të kufizuara në vendimmarrje dhe punësim.

214. Legjislacioni në fushën e mbrojtjes sociale parashikon që gratë, familjet e të cilave përfitojnë ndihmë ekonomike kanë të drejtë të tërheqin dhe të marrin në dorëzim ndihmën ekonomike. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare (gra, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara etj.), për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilët nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore, përfitojnë ndihmë ekonomike në masën 3000 lekë në muaj.

215. Gratë e paraburgosura dhe të dënuara, me aftësi të kufizuara, trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore dhe pa diskriminim, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi që dënohen sipas ligjeve në fuqi. Në rastet e dhunës ndaj grave dhe të miturave, mbahen parasysh nevojat specifike gjinore të tyre.

Barazia gjinore dhe dhuna në familje

216. Ligji për barazinë gjinore[92] i rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe të trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore. Qëllimi kryesor i këtij ligji është që të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë; të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet.

217. Ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare[93] synon parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore, si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktima të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Ky ligj ka si objekt krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, për mbështetjen dhe për rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje; orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje; fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje; sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit[94].

218. Vizioni i Shqipërisë për arritjen e barazisë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore

[91] Punësimi i personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri, raportstudimi, 2011, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, f. 47-50

[92] Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri".

[93] Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"i ndryshuar.

[94] Referim informacionit të paraqitur më sipër në nenin 16.

në familje është i shkruar në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje[95]. Prioritetet e Strategjisë janë: forcimi i mekanizmit institucional dhe ligjor; rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje; fuqizimi ekonomik i vajzave dhe grave; zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore. Strategjia adreson edhe nevojat e grupeve të caktuara të grave që provojnë dizavantazh më të theksuar, që rrjedh ndër të tjera nga situata të lidhura me aftësitë e kufizuara. Për këtë, një nga objektivat e saj specifikë është rritja e shkallës së përfaqësimit dhe e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, të paktën deri në 30% në të gjithë sektorët vendimmarrës nëpërmjet masave të veçanta të përkohshme, si dhe monitorim i aplikimit të kuotës së 30% për gjininë e nënpërfaqësuar në nivelet e larta të vendimmarrjes në politikë dhe administratë, në sistemin arsimor të drejtësisë. Në këtë përqindje përfshihet edhe një përqindje në pjesëmarrje për personat me aftësi të kufizuara. Një objektiv tjetër i strategjisë është rritja e aftësisë së grave si qytetare për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe drejtim, dhe për këtë parashikohet të organizohen trajnime për udhëheqje dhe vetëvlerësim për të ndihmuar gratë dhe vajzat, veçanërisht ato me nevoja të veçanta, si gratë me aftësi të kufizuara.

219. Me qëllim rritjen e pavarësisë ekonomike të grave në përgjithësi dhe atyre me aftësi të kufizuara në veçanti, synohet shtimi dhe përmirësimi i aksesit në kreditim, programeve dhe strukturave mbështetëse për kujdes dhe mbrojtje shoqërore. Gratë me aftësi të kufizuara përfitojnë kurse falas të formimit profesional. Gratë me aftësi të kufizuara që janë nëna të vetme apo kryefamiljare trajtohen me shërbime mbështetëse nga qendrat publike komunitare dhe orientohen te OJF-të që ofrojnë shërbime alternative.

Neni 7- Fëmijët me aftësi të kufizuara

220. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Kushtetuta, ndër të tjera, parashikon se fëmijët kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti dhe se çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë.

221. Neni 30 i ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës parashikon dispozita specifike për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, sipas të cilit, fëmija me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike ushtron të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj, në përputhje me nivelin e zhvillimit të tij. Ky fëmijë gëzon përkujdesje të veçantë, e cila jepet falas nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindit/përfaqësuesit ligjor të tij. Përkujdesje e veçantë përcaktohet për t'i siguruar fëmijës me aftësi të kufizuara qasje efektive në arsimim, trajnim, shërbime të kujdesit shëndetësor, shërbime të rehabilitimit, përgatitje për punësim dhe argëtim, duke zhvilluar mundësitë e tij individuale në mënyrë të favorshme, për arritjen e integrimit sa më të plotë të mundshëm social, kulturor dhe shpirtëror.

222. Në shkallë vendi janë gjithsej 18474 fëmijë me aftësi të kufizuara, nga të cilët 8,189 janë vajza. Ky numër pasqyron vetëm ata fëmijë që kanë kërkuar vlerësimin nga KMCAP-ja dhe janë vlerësuar nga ky komision si të paaftë për punë. Pagesën në CASH e marrin vetëm ata fëmijë që janë vlerësuar me aftësi të kufizuara të rënda ose të thella, duke mos përfshirë ata fëmijë të cilët kanë aftësi të kufizuara të lehta ose të moderuara për disa diagnoza; pra që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara, të cilët nuk e përfitojnë pagesën.

223. Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës përfshirë edhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë:Mekanizmat në nivel qendror janë: 1) Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës; 2) Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës; 3) Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Mekanizmat në nivel vendor janë: a) Njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut; b) Njësia për mbrojtjen fëmijës në bashki/komunë.

Identifikimi i hershëm dhe vlerësimi

224. Parandalimi dhe identifikimi i hershëm janë dy ndër hallkat më të rëndësishme për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara me shërbime dhe mundësimin e zhvillimit sa më optimal të tyre. Megjithatë, ende mbetet shumë për të bërë për identifikimin e hershëm të tyre, kryesisht për shkak të mungesës së njohurive të prindërve dhe profesionistëve, por dhe mosngritjen e mekanizmave funksionalë të vlerësimit fillestar të aftësisë së kufizuar. Identifikimi është hapi më i rëndësishëm drejt sistemit të referimit të fëmijës për një vlerësim më të specializuar dhe mundësisë së përfitimit nga

[95] VKM nr. 573, datë 16.6.2011.

skema sociale dhe shërbimet. Pavarësisht se, bazuar në kuadrin rregullator të parashikuar në fusha të ndryshme, si shëndetësi, arsim dhe shërbime sociale, përgjegjësia për identifikimin dhe përfshirjen në rrjetin e referimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara mund të kryhet nga aktorë të ndryshëm në sistem (mamia, neonatologu, mjeku i familjes dhe infermieri, pediatri, edukatorët dhe mësuesit, psikologët dhe punonjësit socialë që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe atë arsimor, administratori social etj.), në të shumtën e rasteve kjo hallkë është jofunksionale.

Shërbimet shoqërore për fëmijët

225. Institucionet shqiptare po ndërmarrin masa, që shërbimet shoqërore për fëmijët me aftësi të kufizuara jo vetëm të jenë të disponueshme, të aksesueshme, të përshtatshme dhe cilësore, por të jenë të organizuara në mënyrë të tillë që të promovojnë përfshirjen sociale. Këto shërbime fokusohen në mbështetje të jetës familjare, duke mos ndarë fëmijën nga familja, përveçse në rastet kur është në interesin më të lartë të fëmijës.

Pengesat në përfshirjen sociale

226. Institucionet kompetente kanë detyrimin që të sigurojnë që fëmijët me aftësi të kufizuara të gëzojnë pjesëmarrjen aktive në komunitet, përmes eliminimit të barrierave, të tilla si: stigma dhe diskriminimi; neglizhimi, dhuna dhe shfrytëzimi; si dhe kufizime në vendimmarrje ose përfaqësim. Në shumë raste, fëmijët me aftësi të kufizuara, familjarët dhe kujdestarët e tyre, raportuan se u është mohuar shfrytëzimi i shërbimeve publike, të tilla si: transporti, lokalet dhe restorantet ose përdorimi i këndit të lojërave. Shpeshherë, qëndrimet stigmatizuese prekin familjarët e fëmijës me aftësi të kufizuara, po aq sa dhe fëmijën, duke ia pakësuar pranimin shoqëror.

Të miturit në institucionet e vuajtjes së dënimit

227. Trajtimi i të miturve në sistemin penitenciar bazohet në principet dhe standardet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, Rregullat Standarde Minimale për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit, Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve me liri të kufizuar, si dhe një sërë ligjesh dhe paketash ligjore vendëse. Mbikëqyrja e respektimit të të drejtave të personave të mitur realizohet nga institucione dhe struktura të specializuara brenda apo jashtë sistemit të burgjeve.

III. DETYRIME TË VEÇANTA

Neni 31- Statistikat dhe mbledhja e të dhënave

228. Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe ministritë përkatëse mbledhin të dhëna të përshtatshme statistikore dhe kërkimore, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave, për të mundësuar politika dhe planifikime të aksesueshme dhe përfshirëse. Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar sipas fushave ku ato operojnë. Llojshmëria e periodiciteti i mbledhjes së të dhënave dhe mënyra e raportimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave[96].

229. Sipas INSTAT-it, "personat me aftësi të kufizuara" përcaktohen si ata persona të cilët kanë një risk më të lartë sesa popullsia e përgjithshme për të përjetuar kufizime të posaçme në kryerjen e detyrave ose për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme. Ky grup përfshin personat të cilët kanë përjetuar kufizime të aktiviteteve bazë të funksionimit, siç janë: ecja, dëgjimi, shikimi, komunikimi, kujtesa, kujdesi i përditshëm edhe në qoftë se të tilla kufizime janë përmirësuar me përdorimin e mjeteve të veçanta. Shqipëria nuk ka një anketë të posaçme për "aftësinë e kufizuar" apo module pyetjesh mbi aftësinë e kufizuar në anketa që kryen aktualisht.

230. Censusi i popullsisë dhe i banesave është i vetmi burim informacioni mbi frekuencën dhe shpërndarjen e aftësisë së kufizuar në nivel kombëtar dhe rajonal. Tri arsyet kryesore për përfshirjen e pyetjeve mbi aftësinë e kufizuar në census janë: a) Të sigurojë shërbime, duke përfshirë zhvillimin e programeve dhe politikave për ofrimin e shërbimeve dhe vlerësimin e këtyre programeve dhe shërbimeve; b) Të monitorojë nivelin e funksionimit në popullsi. Monitorimi i niveleve të funksionimit përfshin nivelet e vlerësimit dhe tendencën e analizës. Niveli i funksionimit në popullsi konsiderohet indikator i shëndetit parësor dhe social dhe karakterizon statusin e popullatës në një shoqëri; c) Të sigurojë mundësi të barabarta. Sigurimi i mundësive të barabarta përfshin monitorimin, vlerësimin e rezultateve e ligjeve antikorrupsion, politikave, shërbimeve, programet e rehabilitimit të hartuara

[96]Neni 17 i ligjit "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".

për të përmirësuar dhe për të krahasuar pjesëmarrjen në të gjitha aspektet e jetës të personave me aftësi të kufizuar.

231. Censusi i popullsisë dhe i banesave ishte burimi kryesor për statistikat e aftësisë së kufizuar. Pyetësori përfshinte një pyetje mbi statusin e aftësisë së kufizuar, e cila ishte dizenjuar në 6 fusha kryesore për përcaktimin e aftësisë së kufizuar: 1) në shikim; 2) në dëgjim; 3) në të ecur ose ngjitjen e shkallëve; 4) në kujtesë; 5) në kujdesin e përditshëm; 6) në komunikim. Këto fusha u morën në konsideratë pas konsultimit me rekomandimet respektive të *Eurostat-it* dhe OKB-së, gjithashtu, duke u bazuar edhe në Klasifikimet Ndërkombëtare të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit të Organizatës Botërore të Shëndetit (WHO). Kjo pyetje kishte si qëllim identifikimin e personave që vuajnë nga shkallë të ndryshme të aftësisë së kufizuar, specifikisht në 6 fushat e sipërpërmendura, duke u vlerësuar me 4 shkallë[97].

Mbledhja e të dhënave nga MMSR-së

232. Të dhënat kryesore qe mblidhen për personat me aftësi të kufizuara janë sipas kategorive të aftësisë së kufizuar. Treguesit e vlerësimit të aftësisë së kufizuar mblidhen nga 12 drejtoritë rajonale të shërbimit special shtetëror (SHSSH), nëpërmjet strukturave të varësisë. Organizatat jofitmiprurëse janë të përfshira në mbledhjen e të dhënave dhe MMSR-ja ka bashkëpunim për shkëmbimin e të dhënave me shoqatat. Gjatë konsultimeve për hartimin e legjislacionit dhe politikave, shkëmbimi i të dhënave është proces i vazhdueshëm.

233. Të dhënat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për personat me aftësi të kufizuara, janë të grupuara:

- Të dhëna të përgjithshme mbi moshën, gjininë, përkatësinë etnike;
- Kushtet fizike, psikologjike dhe mendore dhe llojin e aftësisë së kufizuar;
- Të dhëna familjare dhe marrëdhëniet familjare;
- Të dhëna mbi nivelin social;
- Aftësitë kryesore;
- Nevoja për trajtim të veçantë;
- Vendlindja dhe vendbanimi;
- Niveli i arsimit;
- Informacion mbi veprën penale të kryer.

Neni 32- Bashkëpunimi ndërkombëtar

234. Shqipëria ka bashkëpunuar intensivisht me agjencitë e OKB-së në fushën e aftësisë së kufizuar si me: PNUD, UNICEF, UNFPA, OBSH. PNUD ka mbështetur Shqipërinë në procesin për ratifikimin e KDPAK-së që prej vitit 2007, duke sjellë ekspertë ndërkombëtarë, ofruar ngritje kapacitetesh, veçanërisht përmes Programit në Mbështetje të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Programit të Mbështetjes së Përfshirjes Sociale. PNUD-i ka mbështetur Shqipërinë, duke vënë theksin te zbatimi i ndërhyrjeve për personat me aftësi të kufizuara. PNUD-i ka mbështetur për vite me radhë qeverinë shqiptare përmes Programit të Veprimit kundër Minave, i cili synonte të siguronte kujdesin shëndetësor, rehabilitimin dhe riintegrimin socioekonomik të të mbijetuarve të minave në rajonin verilindor të vendit.

235. UNICEF-i ka mbështetur kryesisht Shqipërinë për të analizuar situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara, identifikimin e tyre të hershëm, arsimimin gjithëpërfshirës, dhe deinstitucionalizimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, përmes pilotimit të programeve të kujdestarisë.

236. OBSH-ja ka ofruar mbështetja përmes lobimit dhe përkthimit të Klasifikimit Ndërkombëtar mbi Funksionalitetin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin për fëmijët dhe të rinjtë *"International Classification of Functioning, Disability and Health for Children and Youth" (ICF-CY)*, si një mjet i cili do të sigurojë një gjuhë të përbashkët dhe universal për shëndetin publik, klinik dhe kërkimet shkencore për të lehtësuar dokumentimin dhe matjen e aftësisë së kufizuar.

237. UNFPA-ja ka dhënë asistencë për ngritjen e kapaciteteve të SHSSH-së për të përmbushur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Programe të tjera bashkëpunimi në fushën e arsimimit të personave e aftësi të kufizuar janë realizuar me mbështetjen e organizatës *Save the Children*.

Neni 33- Zbatimi dhe monitorimi i Konventës në nivel kombëtar

238. Në Shqipëri nuk ka një mekanizëm të posaçëm të pavaruar të përcaktuar në nivel kombëtar për të monitoruar zbatimin e Konventës.

[97] Asnjë; Disi; Shumë; Nuk mundem fare.

Megjithatë, aspekte, ose dispozita materiale të saj, të përfshira në ligjin "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", monitorohen nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe Avokati i Popullit, sipas fushave të tyre të kompetencës. Më konkretisht, neni 16 i këtij ligji parashikon se: 1. Avokati i Popullit, monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 8328, datë 30.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve", të ndryshuar. 2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Monitorimi nga Avokati i Popullit

239. Avokati i Popullit, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e njohura dhe të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji "Për Avokatin e Popullit", ka në fokusin e tij të punës mbrojtjen, promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Gjatë vitit 2013 - 2014 pranë Avokatit të Popullit janë depozituar 318 ankesa nga persona me aftësi të kufizuara dhe Avokati i Popullit, në mënyrë të herëpashershme ka përcjellë rekomandimet përkatëse te autoritetet shtetërore përgjegjëse. Është hartuar raporti i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në institucionet e pushtetit qendror dhe atij lokal. Në raport janë dhënë rekomandime për: a) Hartimin e një akti nënligjor në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 7995/1995, "Për nxitjen e punësimit", për përcaktimin e rregullave, mënyrën, procedurën e derdhjes së pagës minimale në Fondin Kombëtar të Punësimit; b) Realizimin e përshtatjes së arsyeshme të ambienteve për personat me aftësi të kufizuara, në vendin e punës, duke mundësuar heqjen e barrierave dhe sigurimin e aksesit; c) Inspektorati Shtetëror i Punës, si autoriteti përgjegjës, të kontrollojë zbatimin nga punëdhënësit të dispozitave të Kodit të Punës.

240. Avokati i Popullit ka kryer inspektime në të gjitha qendrat rezidenciale të Përkujdesjes Shoqërore, qendrat ditore, ku trajtohen PAK të moshave të ndryshme. Pas problematikave të konstatuara, me qëllim plotësimin e standardeve të shërbimeve sociale, u janë dërguar rekomandime kryetarëve të bashkisë dhe Shërbimit Social Shtetëror, që janë marrë në konsideratë. Në muajin korrik 2014, Avokati i Popullit dha mendime/ sugjerime, pranë Kuvendit të Shqipërisë mbi Projektligjin për "Përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara". Ligji i miratuar nuk përfshin sugjerimet e bëra në lidhje me: a) cenimin e përfaqësimit të organizatave të personave me aftësi të kufizuara; b) konceptimin si ligj kuadër, por që nuk parashikon ndërhyrjet konkrete në legjislacionin ekzistues[98].

241. Lidhur me heqjen nga skema e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë në institucionet e përkujdesje sociale, të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe të personave që me vendim të formës së prerë të gjykatës vuajnë dënimin me heqje lirie, në muajin prill 2014, Avokati i Popullit i ka dërguar Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në Kuvendin e Shqipërisë, opinionet dhe vërejtjet lidhur me Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar.

242. Për mospërfitim të shtesës në pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, në muajin nëntor 2014, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë marrjen e masave: 1)Për dërgimin çdo muaj të listës së invalidëve të punës në Zyrën Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë, në zbatim të udhëzimit nr. 1406 datë 30.07.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit, në zbatim të VKM-së nr. 869 datë 18.06.2008 "Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit". 2) Për mospërsëritjen në të ardhmen të rasteve të tjera të ngjashme, për mospërfitimin e shtesës mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie.

243. Ministria e Financave e vlerëson iniciativën e këtij institucioni për përmirësim të akteve të sipërcituara, por duke marrë në konsideratë situatën aktuale buxhetore, rekomandimi i mësipërm do të shqyrtohet në një fazë të mëvonshme.

[98] Sipas Avokatit të Popullit.

244. Për mospërfitimin e kompensimit financiar për faturat e energjisë elektrike dhe telefonisë fikse të personave që gëzojnë statusin e të verbrit dhe atij paraplegjik e tetraplegjik, të cilët jetojnë në banesa me qira, pavarësisht se ligjërisht janë përfitues të atyre kompensimeve, i është rekomanduar Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në muajin prill të vitit 2013, nxjerrjen e udhëzimit përkatës në zbatim të nenit 11 të VKM-së nr. 404, datë 20.06.2012 “Për përcaktimin e masës së kritereve të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik për faturat e energjisë elektrike e telefonisë fikse”.

245. Është miratuar udhëzimi i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 404, datë 20.6.2012, “Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”. Në këtë udhëzim janë përfshirë si përfitues edhe personat, të cilat banojnë në banesa me qira, si dhe dokumentacioni që ata duhet të paraqesin për të marrë këtë përfitim.

246. Një nga problematikat kryesore që vijon të mbetet shqetësuese për Avokatin e Popullit, është mosgjetja e një zgjidhjeje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar në respektim të ligjit nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor” dhe vendimeve të gjykatave të apelit. Në përmbushje të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit nëpërmjet inspektimeve periodike pranë mjediseve ku janë akomoduar persona me çrregullime të shëndetit mendor, ka monitoruar në vazhdimësi respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave të kësaj kategorie, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe të kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut pranë institucioneve në fjalë. Konkretisht, i janë dërguar rekomandime Ministrit të Shëndetësisë për zbatimin e detyrimeve ligjore për përgatitjen dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë e për zbatim të disa neneve të ligjit “Për shëndetin mendor”. Një tjetër problem shqetësues që ka mbetur pa zgjidhje, është çështja e personave me sëmundje të rënda mendore, të cilët nuk përfitojnë shërbime sociale dhe shëndetësore si kategoritë e tjera të personave me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara, që banojnë në zonat e thella rurale në shumë raste nuk i përfitojnë këto shërbime[99].

247. Problem shqetësues mbetet dhe aksesi i PAK-së në drejtësi, strukturat qeveritare në nivel qendror dhe lokal, medie dhe biznes. Nga inspektimet e kryera në të gjitha qendrat e përkujdesjes sociale ku trajtohen personat me aftësi të kufizuara me diagnoza të ndryshme, del si një domosdoshmëri, ngritja e qendrave rehabilituese rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara mendore të rënda.

248. Lidhur me mospërfitim të paketës së veçantë higjieno-sanitare të personave që janë invalidë pune, Avokati i Popullit në muajin korrik 2013, u ka dërguar rekomandim, ministrit të Financave, ish-ministrit të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe ministrit të Shëndetësisë për përmirësime të ligjit “Për statusin e invalidit”, dhe ligjit “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me qëllim që një kategori e caktuar e invalidëve, sipas diagnozës së përcaktuar nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë, të përfitojnë paketën higjieno-sanitare, si shtesë në masën e pensionit të invaliditetit dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar.

249. Ministria e Shëndetësisë është shprehur parimisht dakord me nismën dhe angazhohet se do të marrë masa në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinise, e cila është struktura përgjegjëse për të reflektuar për këtë rekomandim.

250. Ministria e Financave, informon se duke konsideruar faktin se ndryshimet e lartpërmendura të bazës ligjore aktuale janë kompetencë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, i është kërkuar trajtimi i tyre, me qëllim gjetjen/dhënien e një zgjidhje të përshtatshme, brenda burimeve financiare të akorduara për atë ministri.

251. Në kuadër të projektit të Bankës Botërore “Modernizimi i asistencës sociale në Shqipëri”, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, prej vitit 2014 ka filluar procesin për reformimin e sistemit aktual të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, që përfshin edhe rishikimin e kritereve ekzistuese të vlerësimit, të përcaktimit të aftësisë së kufizuar, për

[99] Sipas Avokatit të Popullit, ende ky problem ka mbetur pa u zgjidhur.

të cilën është ngritur edhe grupi i punës së mjekëve për këtë qëllim, rishikimin e legjislacionit.

252. Për interpretët që përdoren në proceset gjyqësore, mungesën në institucionet e arsimit të lartë të interpretëve të gjuhës së shenjave shqipe, për studentët që nuk dëgjojnë, në muajin mars 2013, Avokati i Popullit ka rekomanduar[100]: a) caktimin e ekspertëve interpretë nga gjykatat, duke i zgjedhur ata ndërmjet personave që janë regjistruar në listat e caktuara për këtë qëllim; b) marrjen e masave për sigurimin e fondeve të mjaftueshme për gjykatat, për pagesat e pakryera ndaj personave interpretë të gjuhës së shenjave, të cilët thirren në cilësinë e ekspertit në procesin gjyqësor, parashikimin e fondeve në vazhdim për këtë shërbim, të ofruar nga organizata e licencuar/ akredituar për këtë qëllim.

253. Avokati i Popullit ka paraqitur rekomandime mbi ndryshime ligjore[101] për të garantuar: aksesin në procesin gjyqësor civil për personat me aftësi të kufizuara; aksesin në procesin gjyqësor dhe penal; aksesin dhe pjesëmarrjen në procedurat administrative; garantimin e shprehjes së plotë dhe të pandikuar të vullnetit të personave me aftësi të kufizuar në hartimin e një akti noterial.

254. Duke qenë se këto rekomandime kanë të bëjnë me nisma ligjore, aktualisht ato janë duke u vlerësuar në raport me prioritetet strategjik në kuadër të reformës në drejtësi. Në këtë kuadër Ministria e Drejtësisë do të iniciojë ndryshimet e nevojshme ligjore pasi të jenë përcaktuar objektivat strategjikë për ndërhyrjet ligjore. Në këtë aspekt do të vlerësohen dhe analizohen në vazhdimësi, ndërhyrjet e nevojshme ligjore, të paraqitura nga Avokati i Popullit dhe institucione të tjera përgjegjëse. Gjithashtu, AP-ja rekomandon edhe përshtatshmërinë ndërtimore në ambientet publike dhe private për të siguruar aksesin në marrjen e informacioneve dhe shërbimeve të ndryshme.

255. Avokati i Popullit i ka propozuar Kuvendit të Shqipërisë, zgjedhjen e Komisionerit të Seksionit të Përgjithshëm pranë institucionit të Avokatit të Popullit, i cili gëzon statusin e të verbrit dhe Kuvendi e ka miratuar këtë propozim.

Monitorimi nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

256. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Bazuar në këtë parashikim ligjor nuk është bërë ndonjë alokim buxheti me qëllim zbatimin dhe monitorimin e Konventës për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

257. Për periudhën 2013 - 2014 KMD-ja ka trajtuar, 34 çështje me objekt diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, nga të cilat në 9 raste ka konstatuar diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Ankesat ishin kryesisht për ofrimin e përshtatjes së arsyeshme, për ofrimin e të mirave dhe shërbimeve dhe moszbatimin e legjislacionit në lidhje me përfitimin e rimbursimit të tarifës së shkollimit në arsimin e lartë, moszbatimin e legjislacionit në lidhje me ushtrimin e së drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuara, si dhe dështimi për të zbatuar legjislacionin në arsim me synim integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollat e zakonshme. Për periudhën 2013 - 2014 KMD-ja ka trajtuar 28 çështje me objekt diskriminimi për shkak të gjendjes shëndetësore, nga të cilat në 6 raste është konstatuar diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore të personit.

258. KMD-ja ka dërguar që në vitin 2012, rekomandime për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (emërtimi aktual Ministria e Arsimit dhe Sportit), për të marrë masa për të zyrtarizuar gjuhën shqipe të shenjave. Nisma e ndërmarrë për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave shënon një hap pozitiv në drejtim të mbrojtjes nga diskriminimi, të personave me aftësi të kufizuara, jo vetëm në arsim, por në çdo aspekt të jetës. KMD-ja ka konstatuar se zbatimi i parashikimeve ligjore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara has në shumë pengesa dhe se ka një nivel të ulët të njohjes së detyrimeve ligjore nga drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore rajonale, drejtuesit e institucioneve arsimore, që kanë detyra të përcaktuara në bazë të ligjit. KMD-ja ka shqyrtuar çështje kur nga shkollat e zakonshme është refuzuar pranimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, pa bërë asnjë vlerësim të nevojave të tyre, në kundërshtim me ligjin.

259. Gjatë vitit 2013, KMD-ja ka trajtuar dy raste të personave me aftësi të kufizuara dhe

[100] Rekomandime drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

[101] Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurës Penale; Kodi i Procedurave administrative, ligji "Për noterinë".

ushtrimin prej tyre të së drejtës së votës. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka përcjellë pranë KMD-së, ankesat në të cilat trajtonte problemin e ngritur nga dy persona me aftësi të kufizuara, të cilët kishin ngritur pretendimin për diskriminim në ushtrimin e së drejtës për të votuar gjatë zgjedhjeve parlamentare të 23 qershorit 2013. Gjatë procesit zgjedhor nuk ishin marrë masat në lidhje me përshtatjen e mjediseve të qendrave të votimit për të ushtruar të drejtën e votës. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi se personave me aftësi të kufizuara nuk u ishin krijuar kushtet për të bërë të mundur votimin në mënyrë të barabartë dhe në kushte të njëjta me pjesën tjetër të votuesve, qendrat e votimit nuk ishin vendosur në katet e para të ndërtesës ku ishin qendrat e votimit dhe për shkak të mungesës së aksesit në katin e dytë të godinës ku ndodhej qendra e votimit, këta zgjedhës me aftësi të kufizuara nuk kishin ushtruar të drejtën e tyre kushtetuese për të votuar.

260. Gjatë vitit 2014, KMD-ja ka dërguar rekomandime ligjore për ndryshime në Kodin Zgjedhor, në lidhje me përmirësimin e situatës së zgjedhësve me aftësi të kufizuar. KMD ka rekomanduar që me prioritet të gjendet një zgjidhje ligjore për të garantuar të drejtën e votës për zgjedhësit që nuk dalin dot nga shtëpia për të qenë të pranishëm në qendrat e votimit. Për të garantuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara në shikim, KMD ka përgatitur kopje të ligjit kundër diskriminimit në shkrimin brail, të shpërndarë gjatë aktiviteteve ndërgjegjësuese të zhvilluara.

VENDIM
Nr. 461 , datë 27.5.2015

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, DHE PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR KËTË MINISTRI, PËR PASTRIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E KANALEVE TË UJITJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 44 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 13 e 17, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në programin buxhetor 04240 "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes", në artikullin 602, shtohet fondi 62 200 000 (gjashtëdhjetë e dy milionë e dyqind mijë) lekë, për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve të ujitjes.

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

2. Rishpërndarjen e fondeve, ndërmjet programeve të miratuara në buxhetin e vitit 2015 për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve të ujitjes, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 04240 "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes", në artikullin 602, shtohet fondi 5 000 000 (pesë milionë) lekë;

b) Në programin buxhetor 04860 "Këshillimi dhe informacioni bujqësor", shpenzimet e personelit pakësohen me 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 463, datë 27.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 34, DATË 7.1.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE DHE TRAJTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA",TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2015 PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, "Për ndër-

marrjet shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paragrafi i dytë, i pikës 15, të vendimit nr. 34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"DSHQ-ja u vë në dispozicion mjedise pune ish-presidentëve, pa pagesë. Ajo mbulon shpenzimet për shërbime sekretarie, pastrimi dhe mirëmbajtjeje mjedisi, shpenzimet për energji elektrike, ujë, telefoni fikse (përfshirë dhe internet), në masën sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.".

2. Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në buxhetin e vitin 2015 të shtohet fondi prej 15 159 165 lekë (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekësh për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, përkatësisht, vlera 1 302 000 (një milion e treqind e dy mijë) lekë në zërin "Shpenzime korente" dhe vlera 13 857 163 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë në zërin "Investime".

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2015.

4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI NR. 1

Për ish-presidentët, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare përballon këto shpenzime:

1. Për mirëmbajtjen dhe pastrimin e zyrave.

2. Për mbajtjen e personelit të nevojshëm, e konkretisht sekretare (një për secilën zyrë) dhe një punonjëse pastrimi për të gjitha zyrat.

3. Shpenzimet për energji elektrike 20 000 lekë/në muaj për zyrë, çdo shpenzim mbi këtë kuotë të mbulohen nga vetë ish personalitetet që do të përfitojnë këtë shërbim.

4. Shpenzimet për konsumin e ujit 2000 lekë në muaj për zyrë, çdo shpenzim mbi këtë kuotë të mbulohen nga vetë ish personalitetet që do të përfitojnë këtë shërbim.

5. Shpenzime për internet e shpenzimet bazë për telefoninë fikse kuota 3 000 lekë në muaj për zyrë, çdo shpenzim mbi këtë kuotë të mbulohet nga vetë ish personalitetet që do të përfitojnë këtë shërbim.

VENDIM
Nr. 465, datë 3.6.2015

PËR PAGESAT E NDIHMËS EKONOMIKE DHE ATO PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA (PAK) NË KOMUNËN SHALË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27, pika 5, e 28, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 4, dhe të pikave 3, shkronja "c", e 4 të nenit 11, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pagesat e ndihmës ekonomike dhe ato për personat me aftësi të kufizuara, në komunën Shalë, të qarkut të Shkodrës, të bëhen nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, në Shkodër, sipas listës së paraqitur nga administratori shoqëror i kësaj komune.

2. Dega e Thesarit Shkodër të kryejë pagesat për përfituesit brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike, sipas listës së dërguar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, në Shkodër.

3. Pagesat sipas pikës 1, të këtij vendimi, të mbulohen nga buxheti i vitit 2015 i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, në Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet deri në shtator 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 6/8, datë 5.6.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", Ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 38 "Furnizimet e barnave dhe shërbimeve shëndetësore", pika I "Në furnizimet e përjashtuara nga TVSH për transaksionet me interes të përgjithshëm bazuar në nenin 51 pikat "b", "c", "ç", "d", "dh" dhe "ll" të ligjit përfshihen", nënpika 1, shtohet kodi si më poshtë:

Përshkrimi	**Kodet e NKM**
Proteza artikulacionesh të implantueshme	9021 31 00 100

2. Në nenin 38 "Furnizimet e barnave dhe shërbimeve shëndetësore", pika I "Në furnizimet e përjashtuara nga TVSH për transaksionet me interes të përgjithshëm bazuar në nenin 51 pikat "b", "c", "ç", "d", "dh" dhe "ll" të ligjit përfshihen", nënpika 1, kodi tarifor "90213990100", i artikullit "stenta vaskulare", ndryshohet si më poshtë:

Përshkrimi	**Kodet e NKM**
Stenta vaskulare të implantueshme	90219090100

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

KËRKESË

Shtetasi Ragip Uligaj, i biri i Ymerit dhe i Fatimes, i datëlindjes 31.1.1931, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shpalljen të zhdukur të djalit të tij, shtetasit Agim Uligaj.

KËRKUES
Ragip Uligaj

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 588 lekë